VITI XXVII
Nr.
1131
E merkurë
29.IX.1971
ÇMIMI
0,50

Çdo krahine
duhet ti kete
krijuesit e vet

— 15 —

Polemike per
e ardhurat e
dheheqesve
e rinise dhe
Secili merr
sipas te
rdhurave te
prindeve

— 12-13 —

Edukimi i
emijes ne-
er mjet te
punes

— 22 —

Pjese nga fjala e Boshko Stankovskit

— 3 —

Amandamentet XV dhe XVI

— 5 —

HAP PERPARA

— 8 —

Flaka e vëllazërimit

ORGANI I LIDHJES SOCIALISTE TE POPULLIT PUNONJES TE MAQEDONISË

Nga mbledhja e Konferences Republikane te LSPPM

Diskutimi publik rreth amandamenteve-levizje e plote

— FJALËN HYRËSE PËR AKTIVITETIN SHOQËRORO POLITIKE TË LSPPM NË DISKUTIMIN PUBLIK E MBAJTI BOSHKO STANKOVSKI

— U APROVUA INISIJATIVA PËR ORGANIZIMIN E »KONGRESIT TË KULTURËS NË MAQEDONI«

Konferenca Republikane e LSPPM, më 27 të këtij muaji mbajti mbledhje të zgjëruar në të cilën parimisht e aprovoi projektin e amandamenteve kushtetuese të kush tetutës së RSM dhe i ftoi anë tarët e vet për të marrë pjesë në diskutimin publik me rekomandim që ai të shndërrohet në lëvizje që do t'i për fshijë të gjithë njerëzit punues dhe qytetarët. Konferenca e obligoi Këshillin Ekzekutiv të pregadisë program dhe ta ndjekë dhe orjentojë diskutimin publik.

Fjalën hyrëse për esencën politike të ndryshimeve kush tetuese dhe për karakterin e diskutimit publik e paraqiti kryetari i Konferencës Republikane të LSPPM Bosh ko Stankovski.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Konferencës Republi kane, komisioneve të saj dhe sekcioneve e kryetarëve të konferencave komunale të Lidhjes Socialiste merrnin pjesë edhe përfaqësues të or ganizatave shoqërore-politike republikane, të Kuvendit të RSM, të Këshillit Ekzeku tiv, të institucioneve shkencore e profesionale, të organeve dhe organizatave dhe të shoqatave republikane.

Konferenca republikane në këtë mbledhje e aprovoi edhe inisijativën e Shoqatës së shkrimtarëve të Maqedonisë, për organizimin e Kongresit të kulturës në Maqedoni. U vendos të formohet këshill kongresi e për kryetar njëzeri u zgjodh nënkryetari i Kryesisë të RSFJ — **Kërste Cërvenkovski.**

KAVAVA NE JUGOSLLAVI

Nënkryetari i Tanzanisë, Rashidi Kavava arriti në Beograd në vizitë katër ditë she zyrtare në vendin tonë, në bazë të ftesës së nënkryetarit të Kryesisë së RFSJ — Kërste Cërvenkovskit. Bash kë me Kavavën, në Beograd arritën edhe disa funksionarë dhe personalitete politike të Tanzanisë.

Përveç Beogradit, Kavava do të vizitojë edhe Beljen dhe Sarajevën.

Pritet se gjatë bisedimeve që gjatë qëndrimit katër ditësh do të ketë Kavava dhe Cërvenkovski me bashkëpunëtorët e tyre të shkëmbëjnë mendime rreth bashkëpunimit bilateral në mes të të dy vendeve dhe rreth çështje ve ndërkombëtare, posaçërisht rreth aktivitetit të Jugosllavisë dhe Tanzanisë në planin e politikës së mosinkuadrimit.

Duka i Luksemburgut ne Beograd

— Kryetari Tito organizoi pritje solemne për mysafirin e lartë

Duka i madh i Luksemburgut dhe dukesha pardje arritën në vizitë zyrtare në Jugosllavi, me ftesën e kryetarit të RSFJ Josip Broz Tito.

Në aeroportin »Beograd« në Surçin, mysafirët e lartë nga Luksemburgu i pritën dhe i përshëndetën nikoqirët e RSFJ Josip Broz Tito me bashkëshortën dhe personalitete tjera të larta jugosllave.

Mbëmë kryetari i RSFJ Josip Broz Tito me bashkëshorten organizoi një pritje solemne për nderë të Dukës së madh dhe të Dukeshës së madhe nga Luksemburgu. Në pritjen që u organizuan në godinën e Këshillit Ekzekutiv Federativ ishin më se 2000 vetë, ndër të cilët anëtarët e Kryesisë së RSFJ, funksionarët e Kuvendit Federativ, anëtarët e Këshillit të Federatës dhe të Këshillit Ekzekutiv Federativ, përfaqësuesit e RS të Sërbisë dhe të Kuvendit të Beogradit, si edhe një numër i madh përfaqësuesish të organizatave shoqërore dhe politike, gjeneralësh të AFJ, punëtorësh kulturalë dhe publikë të vendit tonë.

NE LUBLANE KONGRESI I ISH VULLNETAREVE SPANJOLLE

Më 25 të këtij muaji në Lubljanë filloi punën Kongresi i IV i shoqatës së ish vullnetarëve të Ushtrisë republikane spanjole nga Jugosllavia, në të cilën përveç nja 250 pjesmërrësve nga Jugosllavia marrin pjesë edhe delegacionet e luftarëve spanjollë nga Austria Bullgaria, Republika Demokratike e — Gjermanisë, Franca, Italia, Hungaria, Polonia, Spanja, BRSS dhe SHBA.

Kryesuesi i kryesisë së punës së Kongresit Velko Vllahoviq e informoi Kongresin se kryetari i Republikës — Josip Broz Tito e dekoron Shoqatën e ish vullnetarëve të Ushtrisë republikane spanjolle nga Jugosllavia me urdhërin — hero i popullit.

NGA MBLEDHJA E KONFERENCËS KANDIDUESE TË LSPPM

U anulua vertetimi i kandidateve per deputet?

Votimi për vërtetimin e kandidatëve për deputetë të Dhomës së kombeve pranë Kuvendit Federativ, do të përsëritet në mbledhjen e ardhshme.

Dje nën kryesin e Boshko Stankovskit u mbajtë mbledhja e Konferencës kandiduese të LSPPM, në të cilën u shqyrtua dhe u aprovua raporti i Komisionit zgjedhor lidhur me konsultimet e kryera për propozimin e kandidatëve të mundshëm për vendet e lira në Dhomën e kombeve, si dhe propozim lista orjentuese dhe dhënja e propozimeve të reja për kandidatë potencial.

Pas aprovimit të listës orjentuese të kandidatëve potencial, filloi votimi për vërtetimin e kandidaturës së tyre.

Në bazë të rregullores së punës ishte e nevojshme që për listën të votojnë shumica e të deleguarve-prezent në këtë mbledhje. Pas votimit përfaqsuesi i komisionit zgjedhor, lajmëroi rezultatet, duke konstatuar se kanë votuar 186 delegatë, dhe në bazë të kësaj paraqiti votat për çdo kandidat.

Me që në fillim nuk u numruan delegatët-prezent, erdhi gjer në mos pajtim në mes të rregullores së punës dhe rregullores së zgjedhjes, mbi shumicën e votave të kandidatëve, prandaj u vendos që vërtetimi i kandidatëve për deputet të anulohet dhe të përsëritet votimi në mbledhjen e ardhshme që parashihet të mbahet këto ditë.

N. EMINI

Konference per shtyp

Per pregaditjet e kongresit te trete te sindikatave te veprimtarise shoqerore

— Nga Kongresi pritet intenzifikim i marrëdhënjeve vetëqeverisëse.

Kongresi i tretë i Sindikatit në veprimtarinë shoqërore do të mbahet më 7 dhe 8 tetor të vitit 1971.

Me rastin e këtij tubimi, lidhur me pregaditjet e gjertanishme të dokumenteve të Kongresit, Këshilli republikan i Sindikatit të veprimtarisë shoqërore, organizoi Konferencë për shtyp, radio dhe televizion.

Në konferencën e cila u mbajt të hënën e kaluar, u cek rëndësia e momentit kur mbahet Kongresi dhe e marrë parasysh gjendjen ekonomike të vendit tonë, ndryshimet, kushtetutare si dhe aktivitetet e ndryshme që janë duke u ndërmarrë për realizimin e detyrave të cilat ua parashtroi Kongresi i dytë vetëqeverisësve i cili u mbajt në maj të këtij viti. Duke u bazuar në të këtë, edhe Kongresi i tretë i punëtorëve në veprimtarinë shoqërore do të angazhohet ne këtë drejtim: kah forcimi i marrëdhënieve vetëqeverisëse në veprimtarinë shoqërore, prodhuesi i drejtëpërdrejtë të jetë mbajtës i veprimtarive shoqërore, problemi i të ardhurave personale të rregullohet me të gjitha normat vetëqeverisëse të aprovuara etj.

Në këtë konferencë për shtyp, u cek se në Kongres do të dilet me disa dokumente të cilat e paraqesin veprimtarinë e gjertanishme dhe nga të cilat do të niset kah një forcim dhe intenzifikum më të shpejtë të marrëdhënjeve vetëqeverisese në veprimtarinë shoqërore, e gjithashtu, këto marrëdhënie të jenë edhe një sukses i punëtorëve të drejtëpërdrejtë.

E. Sh.

Nga metingu popullor ne Ramjan

Kosovaret luftuan per liri dhe barazi te plote

O Metingu u mbajt në Ramjan me rastin e jubileut te revolucionit dhe të ARADHËS SË PARË PARTIZANË SHQIPTARE „ZENEL HAJDINI"

● Në meting ishin të pranishëm: FADIL HOXHA, ALI SHUKRIU, MAHMUT BAKALLI, ILJAZ KURTESHI, ASLLAN FAZLIU, ILIJA VAKIQ, SINAN HASANI, BOGOLUB NEDELKOVIQ, BORO DËRMONÇIQ E TË TJERË

● Për periudhën revolucionare të kësaj aradhe dhe për periudhën e zhvillimit të vendit tonë pas çlirimit foli ASLLAN FAZLIU.

Ramjan, shtator

Në fshatin Ramjan, komuna e Vitisë, me rastin e 30 vjetorit të Revolucionit popullor dhe të 29 vjetorit të themelimit të Aradhës së parë partizane shqiptare „Zenel Haj dini", këto ditë u mbajt një meting i madh popullor, në të cilin muarën pjesë një numër i madh qytetarësh të komunave të Vitisë, Ferizajt, Gilanit, Kaçanikut dhe Kamenicës, pjestarët e njësive të mbrojtjes territoriale dhe ata të APJ.

Në meting muarën pjesë edhe Fa

Në meting muarën pjesë edhe **Fadil Hoxha**, anëtar i Byros Ekzekutive të kryesisë së LKJ, **Ali Shukriu**, sekretar i përgjithshëm i Konferencës Federative të LSPP të Jugosllavisë, **Mahmut Bakalli**, kryetar i Komitetit Krahinor të LK të Kosovës, **Iljaz Kurteshi**, kryetar i Kuvendit krahinor, **Asllan Fazliu**, kryetar i Konferencës Krahinore të LSPP të Kosovës, **Ilia Vakiq**, kryetar i Këshillit ekzekutiv krahinor, Kuvendit republikan, Bogolub Nedelkoviq, kryetar i Këshillit krahinor të Sindikatave, Boro Dërmonçiq, kryetar i Lidhjes së luftëtarëve të Kosovës e të tjerë.

Për rrugën e lavdishme të Aradhës partizane shqiptare „Zenel Haj dini", e cila para 29 vjetësh, me 27 e 28 shtator u formua ne afërsi të Ramjanit foli kryetari i Konferencës krahinore të Lidhjes socialiste të popullit punues të Kosovës, Asllan Fazliu. Ai ndër të tjera tha:

— Sot kur kremtojmë 30 vjetorin e revolucionit dhe të përvjetorit të kësaj aradhe, me nderim të plotë i kujtojmë luftëtarët e saj të rënë dhe të gjallë.

Lëvizja dhe lufta e armatosur nacional-çlirimtare në Kosovë, në periudhën prej 1941 — 1945, ka ekzistuar dhe në mënyrë progresive është zhvilluar pa u ndërprerë, edhepse ka pasur vështirësi, humbje e sakrifica. Kjo luftë është zhvilluar me të njëjta aspirata si në të gjitha viset tjera të Jugosllavisë. Në këtë luftë kanë marrë pjesë edhe pjesëtarët e të gjitha kombeve dhe kombësive. Kjo ka qenë luftë e perbashkët e tyre për të njëjtat qëllime, për liri e baraz të plotë, për një rënd të ri shoqëror, krejtësisht tjetër prej atij vjetrit: në këtë luftë, ata, të prirë prej komunistëve, janë bindur për nevojen e unitetit të tyre, për domosdoshmërinë e jetës së përbashkët të tyre, janë bindur se, vetëm të mbështetur në njëri tjetrin mund të kenë lirinë, barazinë e progresin.

MEGJITHATË, KOSOVA — VENDI MË I PAZHVILLUAR NË JUGOSLLAVI

Kosova, përkundër përpjekjeve që po bëhen për ta nxjerrë nga pra pambeturia sa i përket zhvillimit të ultë ekonomik dhe degëve të tjera të jetës, megjithatë ajo akoma është vendi më i pazhvilluar në Jugosllavi. Ekonomia e kësaj treve akoma është shumë mbrapa e poashtu edhe kultura, shëndetësia dhe standardi jetësor i qytetarëve. Akoma Kosova po ballafaqohet me një sërë problemesh, në mesin e të cilëve edhe me nevojën e sigurimit të kafshatës së gojës për një numër të madh punëtorësh të papunë. Përndryshe, Kosova është vend mjaft i pasur me pasuri të ndryshme, për shfrytëzimin e të cilave duhet investuar.

Viteve të fundit, e veçmas sivjet, në tërë Jugosllavinë po diskutohet për shpejtimin e zhvillimit të Kosovës. Andaj, siç tha Asllan Fazliu, proçeset e zhvillimit duhet të shpejtohen, e në të njejtën kohë të pengohen përtacia, mosdisiplina dhe keqpërdorimet e çfarëdo natyre qofshin ato. Kjo është në përkim të plotë edhe me amandamentet kushtetuese, të cilat u aprovuan sivjet. Në këto amandamente përcaktohet edhe trajtimi i Krahinave në Federatë, si dhe i Kosovës.

BASHKËPUNIMI ME SHQIPËRINË — NË DOBI TË DY PALËVE

Jugosllavia ka marrëdhënje të mira reciproke me shumë vende të botës, e veçanërisht me shtetet fqinje. Kohëve të fundit, një bashkëpunim të këtillë e ka filluar edhe me Shqipërinë, e veçmas në lëmën e ekonomisë, kulturës e sportit. „Kjo gjë vetëm mund të përshendetet, edhepse e dimë se nuk janë shfrytëzuar të gjitha mundësitë reciproke. Marrëdhëniet fqinjësore në mes dy vendeve, siç janë Jugosllavia dhe Shqipëria, janë në dobi të paqës dhe pavarësisë së tyre, në dobi të dy popujve të tyre", — tha në mes tjerash Asllan Fazliu.

Në fund të metingut, pjesëmarrësit i dërguan telegram krytarit Tito e mandej u shfaq një program kulturo-argëtues.

M. Emërllahu

PJESE NGA FJALA HYRESE E BOSHKO STANKOVSKIT

DISKUTIMI PUBLIK LE TE BEHET KRIJUSHMERI E NJEREZVE PUNUES

Me mbledhjen e Dhomës Republikanë të Kuvendit të RSM edhe formalisht filloi diskutimi publik rreth Projektit të amandamenteve kushtetuese të Kushtetutës së RSM. Para nesh qëndrojnë ditë krijushmërie edhe akcioni që duhet ta përvehtësojnë njerëzit punues dhe qytetarët dhe çdo gjë që është kreative në shoqërinë tonë. Duke u mbështetur në përvojat e diskutimit publik rreth amandamenteve kushtetuese të Kushtetutës së RSFJ, një heri të aplikojmë një sistem të tërë ndërmarrjesh të reja, ndryshimet e tanishme kushtetuese të shprehen dhe konfirmojnë si vepër e vetë nje rëzve punues dhe qytetarëve të të gjitha sferave të reprodukcionit shoqëror të qytetit dhe fshatit.

Observacionet dhe sondimet e para pa dyshim e vërtetojnë interesimin dhe gatshmërinë e njerëzve punues dhe qytetarëve dhe jetës së tyre shoqëroro-politike, dhe organizmit vetëqeverisës nëpër komunet dhe në republikë të mbijnë në esencën e ndryshimeve kushtetuese politike, ato të kuptohen dhe përvehtësohen dhe njëheri të japin kontributin e vet si për përmirësimin e dispozitave të propozuara në projektin e amandamenteve kushtetuese të Kushtetutës së RSM, ashtu edhe me zbulimin e atyre çështjeve dhe problemeve që do të kenë rëndësi relevante për fazën e dytë të ardhshme të ndryshimeve kushtetuese politike.

Diskutimi publik i kthyer drejt jetës dhe marredhënieve reale me komparacionin e nevojshëm të karakterit, esencës dhe dispozitave korekte të amandamenteve kushtetuese me të kaluarën dhe prezentin, do ta kryejë funkcionin e vet në atë masë në të cilën vërtetë plotësisht në mënyrë krijuese i nisi ndryshimet kushtetuese politike dhe prej këndej edhe vetë amandamentet kushtetuese. Duke luftuar për atmosferë krjetësisht demokratike dhe veçanërisht kundër kualifikimit para kohe të diskutimit dhe propozimeve konkrete, gjithkujt i është e qartë se organizatat e Lidhjes socialiste dhe përgjethësisht të gjitha strukturat shoqëroro politike dhe vetëqeverisëse njëheri do të luftojnë kundër atyre tendencave që objektivisht do të gjinden në kolizion me karakterin dhe esencën e ndryshimeve kushtetuese politike në republikë.

Boshko Stankovski, më tutje, thekosi se në diskutimin publik rreth projektit të amandamenteve kushtetuese të Kushtetutës së RSM hyjmë me një përcaktim të qartë dhe autentik. Ai theksoi se zgjidhja e çështjes nacionale dhe e marrëdhënieve socialiste vetëqeverisëse e shoqërore kanë lidhje reciproke direkte. Duke folur në këtë temë Stankovski theksoi se çështja nacionale ishte edhe mbetet pjesë imanente dhe organike e revolucionit socialist dhe e zgjatjes së tij — tani dhe në ardhmen. Pikërisht në këto baza, gjatë dy decenjeve e gjysëm të lirisë nacionale dhe sociale, populli maqedonas, klasa punëtore dhe të gjithë njerëzit punues e qytetarët

Boshko Stankovski

në afirmimin e vet nacional, në zhvillimin e forcave prodhuese, në arësim, kulturë, shkencë dhe sferat tjera të reprodukcionit shoqëror, e veçanërisht në zhvillimin e marëdhënieve vetëqeverisëse socialiste u arritën rezultate që nuk mbahen mend ndonjë herë ndër kombet sovranë të Jugosllavisë dhe të botës.

25 vjetët e kaluara, njëheri, janë edhe emancipim i gjithanshëm dhe afirmim i kombësive të Maqedonisë si subjekte të barabarta dhe faktorë konstitucionalë të RSM si shtet dhe bashkësi socialiste vetëqeverisëse demokratike. Kjo politikë e ka gje nezën e vetë në luftën Nacional-çlirimtare, dhe posaçërisht me epopenë e Ilindenit që në manifestin e famshëm të Krushevës formuloi platformën e cila në atë kohë errësire botërore e ballkanike dhe urrejtjeje nacionale i ndriçoi horizontet e reja.

Mbledhja e parë e ASNOM-it në »deklaratën e vetë për të drejtat the demokratike", përveç të drejtave melore të qytetarëve të Maqedonisë demokratike themelore, të formuluara në pikën 1 e respektivisht: „Të gjithë qytetarët e shtetit federal maqedonas janë të njejtë dhe të barabartë para ligjeve, duke mos i shikuar kombësinë e tyre, gjininë, racën dhe fenë". Në pikën 2 të së njejtës deklaratë shënon: »Pakicave nacionale të Maqedonisë u sigurohen të gjitha të drejtat e jetës së lirë nacionale".

Në kushtetutat e pasluftës, posaçërisht në kushtetutën e vitit 1963 u bënë edhe disa hapa, të cilat jo vetëm që e kompletojnë këtë politikë, por hapin edhe horizonte të reja, pothuajse presedan në histori, për të arritur deri në amandamentet e tanishme kushtetuese, të cilat me të vërtetë, duke e sankcionuar gjendjen e tanishme, njëheri, hapin horizonte të reja për barazinë e kombësive në RSM. Realizimi konseguent i politikës të inauguruar edhe me amandamentet kushtetuese është përgjegja më e mirë për ato dukuri që nuk kanë asgjë të përbashkët me interesat vitale të kombit maqedonas dhe kombësive në RSM.

Zhvillimi i Republikës Socialiste të Maqedonisë — tha Stankovski, i solli në skenën shoqërore edhe grupet etnike. Pikërisht në këtë është e natyrshme që aspektet e veçanta të shprehjes së tyre edhe si kolektivitete, bëhen kategori kushtuese.

Stankovski në lidhje me këtë the ksoi se patjetër lypset të ecim të vendosur në luftën për barazinë reale dhe faktike të të gjithë qytetarëve tanë — kombit maqedonas, kombësive dhe grupeve etnike.

Duke ju propozuar që parimisht hyrëse Stankovski tha:

Duke ju propozuar jë parimisht ta aprovoni projektin e amandamenteve kushtetuese të Kushtetutës së RSM, e bëj këtë me dhembje të thellë, se karakteri dhe esenca e ndryshimeve të tanishme kushtuese politike, sa e shprehin trendin bashkëkohore të jetës sonë dhe marëdhënieve tona reale, njëheri hapin dhe horizonte për afirmimin e mëtejshëm të interesave autentike të kombit maqedonas, kombësive dhe grupeve etnike, klasës sonë punëtore dhe njerëzve punues të të gjitha sferave të reproduksionit shoqëror, shkurt Republikës Socialiste të Maqedonisë si shtet dhe bashkësi socialiste vetëqeverisëse demokratike.

Njëheri, me këtë, nëpërmjet të mbledhjeve në organizatat lokale, Konferenca komunale dhe organet e tyre e posaçërisht në vetë organizimin e Konferencës republikane të LSPPM, në bashkëpunim të plotë me organizatat tjera shoqëroro-politike dhe shoqatat e qytetarëve, me shtypin dhe radion e televizionin me universitetin dhe institucionin shkencoro-hulumtuese, duke dhënë inisijativa dhe duke marrë pjesë direkt në organizimin edhe të mbledhjeve shkencoro-profesionale në nivel të republikës ose në komunet e veçanta ose të bashkuara, duke u nisur nga parimi — se çdo amandament është i hapur për diskutim, përmirsim apo zavendësim me tekst të ri të bëjnë çdo gjë, diskutimi publik në realitet të shëndrohet në një lëvizje të plotë që do t'i përfshijë dhe do ta përvehtsojnë të gjithë njerëzit punues dhe qytetarët.

Diskutimi publik le të bëhet krijueshmëri direkte e njerëzve punues dhe qytetarëve, le të bëhet mënyrë për zbatimin në praktikë të asaj fryme dhe esence të institucioneve të demokracisë socialiste që i inauguron projekti i amandamenteve kushtetuese të Kushtetës së RSM. Nëpërmjet të sistemit të zhvilluar të diskutimit publik në këtë mënyrë, do të krijohen format e zhvilluara të marrëveshjes dhe të formimit të pikëpamjeve të përbashkëta dhe qëndrimeve të caktuara.

I çliruar prej çdo lloj trajtimi verbalo-formalist dhe me praktikimin është edhe rrugë për pjesëmarrje direkte të njerëzve punues dhe qytetarëve në vendosjen rreth çështjes aq të rëndësishm sikur se janë amandamentet kushtetuese.

Me pjesëmarrjen në diskutimin publik njerëzit punues dhe qytetarët në të vërtetë pregatiten edhe për realizimin e amandamenteve kushtetuese dhe pothuajse në ditën e ardhme pas proklamimit të tyre formal.

Do të jetë normale në qoftë se akti për proklamimin e amandamenteve kushtetuese të Kushtetutës së RSM në Kuvendin e RSM shprehet se si verifikimi i krijueshmërisë dhe akcionit të njerëzve punues dhe qytarëve të gjithë pjesëmarrësve në diskutimin publik. Me këte nuk ka ndryshuar roli i deputetit, i cili duke u paraqitur si prezentues i interesave të vullnetit dhe mendimeve të zgjedhësve të vetë, njëheri është edhe personalitet i pavarur krijues që din ta bëjë sintezën e interesave, vullnetit dhe mendimeve në përgjithësi me tërësinë e komunës dhe Republikës Socialiste të Maqedonisë dhe RSFJ.

Diskutimi publik rreth projektit të amandamenteve të Kushtetutës së RSM, krejtësisht, si dhe në lidhje me amandamentet kushtetuese të Kushtetutës së RSFJ është edhe një mundësi më shumë për vetëshprehjen dhe vetëkonfirmimin e Lidhjes Socialiste si instrument i pazavendësueshëm dhe bazë e njerëzve punues dhe qytetarëve në vetëqeverisjen dhe krijimin e politikës në të gjitha nivelet e ekzistencës dhe marrëdhënieve në komunë dhe në republikë.

RRUGA E NJË PARTIZANI NË VALET E LUFTËS CLIRIMTARE

1. Shënime të shkurta biografike deri në prill të vitit 1941

XHEMAL BAJRAKTARI
KOLONEL I MARINËS

(5)

14. Sulmet e batalionit në Spodnje dhe Gornje Gorje

Sipas urdhërit të shtabit të brigadës, batalioni II kishte për detyrë të likuidojë forcat e armikut në Spodnje dhe Gornje Gornje. Batalioni u nda në dy pjesë:

— Pjesa më e vogël me komisarin e batalionit Lojzen në krye duheshte të sulmojë Spodnje Gornje ku kishte më pak forca të armikut;

— Pjesa më e madhe në krye me komandantin duheshte të likuidonte armikun në Gornje Gornje, ku kishte më tepër forca dhe ishte më vështirë për sulm.

Data e caktuar për sulm ishte 26. V. 1944.

Sulmi në Spodnje Gornje ishte i pregatitur mirë, porse nuk pati suksees. Si duket armiku ishte informuar dhe ishte pregatitur mirë për mbrojtje. Kur pa komesari se sulmi nuk do të kete sukses u mundua t'u afrohet bunkerëve por pa sukses; rrafshina e terenit nuk lejonte një manevrim të tillë. Më në fund komisari pruri vendim të blokojë këtë objekt dhe në këtë mënyrë të pengojë krejtësisht intervenimin eventual të këtyre forcave në drejtim të Gornje Gores. Po atë ditë nga mesi i natës komandanti sulmoi Gornje Gornje. Pasi ishin disa bukera rreth objekteve të sulmit, ishte e pamundur të afrohej sa duheshte. Grupet vullnetare u avitën bunkerave dhe i hodhën bombat mbrenda. Gjermanët, të befasuar, u detyruan të hikin nga bunkerat ku e konsideronin vehten të sigurtë, dhe të koncentrohen brenda një ndërtese të madhe ku planifikonin të japin një rezistencë të organizuar. U zhvilluan një luftë e rreptë. Pas disa ore gjermanët ishin të rrethuar prej forcave të batalionit. Ndërtesa ishte e fortifikuar. Gjermanët i mbrojnin me zjarr dyert dhe dritaret e ndërtesës. As sulmet, as bombat e grupeve vullnetare nuk shkaktuan shu më dëme. E vetmja mundësi që të dorëzohet armiku ishte të digjet ndërtesa, por për të realizuar këtë plan duhej të kishte benzinë. Gjatë natës një grup i batalionit e gjeti depon e armikut ku kishte edhe disa fuçi benzinë. Përpara dritareve dhe portës, grumbulluan do dërrasa, dru dhe degë të thata. Në atë grum bull u zbrazën fuçitë e benzinit. U bë një zjarr i tmerrshëm. Së shpejti flaka i kaploi të katër anët e ndërtesës. Ishte e pamundur të shuhet ky zjarr i tërbuar. Shumë gjermanë u vranë duke ikur. Brenda kishin ngelë dhjetë të vrarë. Kishte mjaft të plagosur, kurse të tjerët iken nga podrumi i ndërtesës. Për veç 12 pushkëve, 3 automatikë, mjaft municion, batalionit i ranë në dorë edhe gjëra ushqimore, kurse batalioni kaloi pa kurrfarë humbje. Në këtë betejë tregoi trimëri dhe zotësi zëv. Komandanti i batalionit Taganeli Miro.

15. Aksionet e batalionit në 21 dhe 24 qershor

Komunikacionin Zheleznik — Selce nga se ishte i rëndësishëm gjermanët e ruajnin me forca të mëdha. Gjatë këtij komunikacioni kishte shumë pusi dhe pozita gjermane të fortifikuara dhe të maskuaraa mirë.

Me datën 21 qershor batalioni II si pararoja e brigadës kishte për detyrë t'i likuidojë pusitë gjermane në komunikacionin Zheleznik-Selce me qëllim që të pastrojë komunikacionin nga këto pengesa dhe të çlirojë rrugën për komunikimin e forcave të Korparmatës IX. Të njëjtën detyrë e kishte edhe një batalion i brigadës së Preshernit.

Kjo detyrë luftarake ishte shumë e vështirë, sepse në atë kohë armiku ishte duke i rrethuar forcat tona. Nga zjarri i fortë që blua nin topat dhe mortajat ishte e pamundur të shkohet në drejtin të vendit Rakitovac.

Në këtë ditë vranë shokun Joshe Mihavc — minator, komandantin e brigadës Vojko Premila i cili ndodhej në Jelovicë në mprojtjen e Korparmatës. Kjo qe një humbje e madhe për lëvizjen nacional çlirimtare në Sllloveni, sepse Jozhe ish te një ndër komandantët më të zotë dhe më trim dhe ishte si legjendë e gjallë për këto vende.

Partizanët e këtyre vendeve kur muarën vesh për vdekjen e shokut Jozhe u betuan se do ta marrin hakun. Duke shkuar të zbatojnë urdhërin hasën gjatë rrugës në disa pusi gjermane. menjëherë u formuan disa grupe me mitraloza dhe bomba dhe kur armiku e diktoi këtë, kolonat partizane që vinin pas u larguan në drejtim të Zheleznikut.

Ditën e nesërme në mëngjez gjermanët e sulmuan batalionin II, i cili kishte për detyrë t'i mpronte kolonat e Korparmatës, të cilët marshonin gjatë rrugës por pa sukses. Batalioni bëri një rezistencë të fortë. Pak më vonë gjermanët sulmuan edhe disa herë por pa sukses; kolonat partizane hypnin pa pengesa në drejtim të vendit Bllagosht.

Me 24 qershor afër 150 gjermanë, aviteshin në tri kolona të veçanta forcave të brigadës. Kolona më e madhe u drejtua kah batalioni i dytë, duke gjuajtur me të gjitha armët një kohë mjaft të gjatë. Situata u bë shumë delikate për forcat e batalionit. Sipas tregimit të shokut Ibrahim, vetëm duke i falemderuar trimërisë së luftëtarëve e sidomos heroizmit të dy partizanë ve me mitraloza Stefançiqit dhe Baj tit, të cilët korrën shumë gjermanë, batalioni shpëtoi nga disfata. Pasi nuk patën sukses dhe nuk arritën qëllimin, gjermanët u detyruan të ikin nga Idria.

Ato dy kolona të tjera po ashtu kaluan keq. Forcat e tjera të brigadës i shkaktuan mjaft humbje dhe këta po ashtu ishin të detyruar të ikin.

Në këtë betejë armiku pati më se 20 të vrarë dhe shumë të plagosur. Batalioni i dytë kishte dy të vrarë dhe katër të plagosur. Ndër të vrarët ishte edhe heroi Bajti, i cili me mitralozin e vet korri shumë gjermanë.

16. Sulmi në Bashka Grapa

Pas sukseseve në betejat e kaluara në Gorenska, në relacionin Cërni Vërh — Idria, u dha rast luftetarve të batalonit të pushoj në disa ditë dhe të pregatitemi për ndeshje të reja me armikun.

Batalionit të II iu caktua për detyrë sulm në Bashka Grapa në një relacion të gjërë prej Podbordës deri në Grahova. Në këtë relacion duheshte të shkatërrohen shumë ura dhe hekurudha nëpër vende më delikate. Përveç kësaj duheshte të likuidohen postajat gjatë rrugës. Qëllimi kryesor i këtyre aksioneve ishte:

— të shkatërrohet hekurudha në vende më delikate dhe të paralizohet komunikacioni.

— Të pengohen me këto aksion dhe me aksionet e tjera diverzive forcat armike që të mos kalojnë efektivet ushtarake nga Italia në Gjermani.

Bashka Grapa kishte një rëndësi të jashtëzakonshme në realizimin e planeve pasi ndodhej në kryqëzimin e rrugëve të armikut lindje — perëndim, si dhe në lidhje me furnizimin e forcave me materialin luftarak dhe gjërat ushqimore. Prandaj edhe forcat e armikut ishin impozante: Më se 20 garnizona me 1200 e ca ushtarë dhe përgjegjës (shumica ishin Bersaliera italianë), në këtë teren relativisht të ngushtë, vërteton rëndësinë e madhe të këtij objekti për armikun. Ky teren ka formën e një lugine të ngushtë nëpër të cilin rrjedh lumi Baça. Gjatë lumit është rruga dhe bashkë me këtë shkon hekurudha. Tereni i pjerrtë në disa vende ngushtohet shumë.

Kjo betejë ka katër faza, këtu do të përshkruhen vetëm dy faza më të rëndësishme.

Sulmi i parë në Koritnica.

Detyra konkrete e batalionit II ishte likuidimi i postajës në Koritnica, me të cilën detyrë (në rast se e kryen si duhet) do të lehtësohej puna e atyre grupeve, të cilat kishin për detyrë të likuidojnë bunkera të ndryshme dhe pengesa të tjera të mprojtura me zjarrin e armikut gjatë hekurudhës.

Me 28 qershor në mbrëmje batalioni u nis nga Koritnica. Tereni ishte i vështirë. Si duket armiku dyshonte dhe kishte marrë masa të mos befasohet. Gati në çdo hap gjatë hekurudhës kishte patrulla dhe ruante çdo pikë me rëndësi.

Sulmi i parë në Koritnica, filloi nga ora 02 të natës nga të dy anët. Armikut i shkoi për dore të ndezi një shtallë. Flaka e madhe e ndriçoi terenin dhe zbuloi partizanët. Ishte e pamundur t'i afrohej objektit të sulmit. Mbrenda kësaj kohe erdhi edhe ndihma e italijanëve nga Grapova; këto forca të reja u futën në luftë dhe sulmuan batalionin nga prapa. Mbasi kaloi edhe nata batalioni nuk kishte më kurrfarë shnse të bëjë diçka dhe prandaj u tërhoq pa e kryer detyrën.

Sulmi i dytë në Koritnica.

Më 29 qershor shokun Ibrahim e thirrën në shtabin e brigadës dhe përsëri i dhanë urdhër të sulmojë edhe një herë Koritnicën Komandanti i divizionit Potoçar Stane, i cili ishte pranë iu drejtua shokut Ibrahim dhe i tha: „Ibro, nesërmbrëma përsëri do të sulmosh Koritnicën. Dua që nesër në mëngjez të më raportosh se Koritnica është e likuidu ar. Dua të më referosh se ke zënë një pushkëmitraloz". Pas pregatitjeve të duhura, menjëherë posa ra nata, batalioni u nis në drejtim të Koritnicës. Afër urës së lumit Baçi u ndëgjuan disa të krisura. Batalioni menjëherë u ndal Pararoja e sqaroi situatën: afër urës ndodhje shte një pusi italiane. Sipas urdhërit të komandantit disa vullnetarë me bomba kapërcyen lumin fshehtas dhe sulmuan pusinë italiane. Pas një kohe të shkurtër pusia italiane u likuidua Batalioni mundi të kalonte lirisht drejt objektit të sulmit, porse me shumë kujdes.

Sulmi filloi nga mesi i natës me datën 30. VI. 1944. Në fillim zjarrin e hapën mortajat, pushkët kundratankse dhe pastaj mitralozat. Më në fund hodhën bombat grupet e posaçme vullnetare. Italianët gjendeshin nëpër shtëpia, të cilët që me kohë i kishin adaptuar për mprojzita të fortifikuara, Italianët rezistuan mjaft gjatë. Përveç armëve të tjera të këmbësorisë Italianët futën në luftë edhe mortajat. Nga Grapotje. Të armatosur mirë dhe në pova gjuante një top. Pas disa orëve lufte Italianët u mblodhën në një ndërtesë të madhe dhe të fortifikuar me qëllim që të bëjnë një rezistencë të organizuar. Komandanti përfitoi nga ky rast dhe i thirri italianët të dorëzohen. Mirëpo këta në vend që të përgjigjen, filluan të shtijnë me mitraloza. Atëhere batalioni sulmoi, por pa sukses. sulmi u përsësit. Përveç pushkëve dhe automatikëve, ndëgjoheshin mitralozat, pushkët kundratankse dhe mortajat. Një grup i posaçëm brenda kësaj kohe doli fshehtas nga ana verilindore dhe e sulmoi objektin e mprojtur. Eksplodimi i bombave dhe të eksplozivit të hedhur nga dritaret, bëri shumë dëme. Menjëherë pasi u dëgjua eksplodimi, partizanët sulmuan dhe hynë në ndërtesë. Ndër të parët hyri shoku Ibrahim me grupin e tij. Italianët dhe domobranët, të cilët ishin të frikësuar menjëherë u dorëzuan dhe filluan të kërkojnë falje. I lutnin duke qarë të mos i vrasin pasi janë njerëz me familje.

Në këto sulme armiku pati 25 deri 30 të vrarë dhe më se 20 të plagosur. Ranë si rob 36 veta, prej të cilëve shumica u dorëzua. Disa iken në drejtim të Grapovës, kurse disa të tjerë ngelën të mbuluar në mbrendinë e ndërtesës gjysmë të shkatërruar. Batalionit i ranë në dorë 10 mitralozë dhe pushkomitraloza, tre mortaja, një top me 150 granata dhe shumë municion dhe material tjetër luftarak. Batalioni kishte tetë të vrarë dhe gjashtë të plagosur.

Kështu shoku Ibrahim mundi t'i raportojë komandantit të divizionit nënkolonelit Potoçar: **„Koritnicën e likuidova dhe ju prura jo një, por tre mitraloza, nji top dhe 36 ushtarë armiq që i zumë rob".** Të kënaqur nga ky sukses si komandanti i divizionit ashtu edhe komandanti i brigadës e lavdëruan Ibrajimin dhe batalionin e tij. Pastaj sipas urdhërit të shtabit të brigadës batalioni shkoi në fshatin Bukovo, në pushim të merituar. Mjerisht ky pushim nuk zgjati shumë.

(Vazhdon)

Rreth Projektit te amandamenteve kushtetuese

Amandamentet XV dhe XVI

PARA CA DITËSH, SIKUR SE DIJMË, PROJEKTI I AMANDAMENTEVE KUSHTETUESE TË KUSHTETUTËS SË RSM U SHPALL NË DISKUTIM PUBLIK, I CILI DO TË ZGJASË DERI MË 25 TETOR. DUKE DASHUR TË KONTRIBUOJMË NË KËTË DISKUTIM PUBLIK, NË KËTË NUMËR TË GAZETËS SONË PO NDALEMI NË DY AMANDAMENTE TË PROJEKTIT TË SHPALLUR NË DISKUTIM DHE NJËHERI I FTOJMË LEXUESIT TANË QË MENDIMET, PROPOZIMET DHE VËREJTJET E VETA RRETH PROJEKTIT TË AMANDAMENTEVE KUSHTETUESE T'IA DËRGOJNË REDAKSISË, RESPEKTIVISHT TA THONË MENDIMIN E VET RRETH TYRE NËPËRMJET TË FAQEVE TË GAZETËS SONË.

Po ndalemi kësaj radhe në amandamentet XV dhe XVI, duke llogaritur të domosdoshme të flasim në radhë të parë për to, jo sepse janë amandamentet e para për nga rendi në Projektin në fjalë, por se mendoj më se vërtetë aty është esenca dhe së andejmi lypset nisur.

Në amandamentin e XV kryesisht thuhet:

»Republika Socialiste e Maqedonisë është shtet sovran dhe kombëtar i popullit maqedonas dhe shtet i kombësive dhe grupeve etnike në te mbështetur në sovranitetin e popullit dhe në pushtetin dhe vetëqeverisjen e klasës punëtore dhe të gjithë njerëzve punues si dhe bashkësisë socialiste vetëqeverisëse demokratike e njerëzve punonjës dhe qytetarëve e popullit maqedonas dhe kombësive e grupeve etnike të barabarta me te.«

Në amandamentin XVI thuhet:

»Njerëzit punues populli maqedonas, kombësitë dhe grupet etnike i sendërtojnë të drejtat e tyre sovrane në Republikës socialiste të Maqedonisë, kurse në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, kur ajo është në interesin e përbashkët të njerëzve punues, kombeve dhe kombësive me marrëveshjen e republikave dhe krahinave që është përcaktuar me Kushtetutën e RSFJ.

Në Republikën Socialiste të Maqedonisë, populli maqedonas kombësitë dhe grupet etnike, njerëzit punues dhe qytetarët e përcaktojnë rregullimin shoqëroro-ekonomik dhe sistemin shoqëroro-politik të Republikës dhe sigurojnë e sendërtojnë sovranitetin, lirinë kombëtare, pavarësinë, integritetin territorial të Republikës dhe mbrojtjen popullore, vetëqeverisjen shoqërore dhe marrë dhëniet shoqëroro-politike dhe ekonomike; barabarsinë e kombësive dhe grupeve etnike; solidaritetin dhe sigurimin social të njerëzve punues dhe qytetarëve; kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, mbrojtjen e rregullimit, përcaktuar me Kushtetutën, sigurimin publik dhe vetëmbrojtjen shoqërore; liritë demokratike dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit; bashkëpunimin politik, ekonomik, kultural dhe bashkëpunim tjetër të Republikës me organet dhe organizatat e shteteve të tjera dhe me organet e organizatat ndërkombëtare si dhe kujdesin e duhur për pakicat maqedonase dhe maqedonët në botën e jashtme, në kuadrin e politikës së jashtme të përcaktuar bashkërisht dhe marrëveshje ndërkombëtare të RSFJ; krijojnë kushte për zhvillimin e barabartë të Republikës; nxisin inisijativë për zgjidhjen e çështjeve nga lëma e jetës ekonomike, shoqërore dhe kulturale, e har monizojnë zhvillimin vetëqeverisës; krijojnë kushte për sendërtimin e dretjpërdrejtë dhe më efikas të së drejtave vetëqeverisëse të njerëzve punues dhe qytetarëve krijojnë kushte për kryerjen më efikase të kontrollit shoqëror dhe vetëqeverisës dhe sendërtimin e përgjegjësisë shoqërore; kujdesohen që të sigurohet integrimi në të gjitha sferat e jetës shoqërore në Republikë në bazë të vetëqeverisjes dhe i kryejnë edhe punët tjera shoqërore me interes të përbashkët me zhvillimin politik, ekonomik dhe kultural për Republikën.«

Kjo është kryesisht përmbajtja e dy amandamenteve për të cilat duam të bëjmë fjalë në këto pak rreshta.

Nga definicioni i dhënë në amandamentin XV Republika Socialiste e Maqedonisë është shtet nacional, por të kuptohemi, ai nuk është shtet nacional në kuptimin nacionalist të fjalës, sepse menjiherë, po në këtë amandament dhe kudo më posht në amandamentet tjera, shënohet se nuk është vetëm i kombit maqedonas, por edhe i kombësive dhe grupeve etnike. Kjo do të thotë se kombësitë dhe grupet etnike trajtohen si element përbërës i shtetit dhe me barazi të plotë me kombin maqedonas.

Republika Socialiste e Maqedonisë si shtet nacional i kombit maqedonas dhe si shtet i kombësive dhe grupeve etnike, është shtet sovran, i mbështetur në sovranitetin e popullit. Ai mbështetet në sovranitetin e popullit dhe pushtetin si dhe vetëqeverisjen e klasës punëtore dhe të gjithë njerëzve punues. Natyrisht ky theksim ka qëllimin e vetë, e qëllimi i theksimit të këtillë është të thek sohet karakteri klasor i shtetit, respektivisht të theksohet ajo se ai është shtet i klasës punëtore dhe i njerëzve punues, por edhe diçka tjetër, se shteti është duke u suprimuar si i tillë dhe se garancë e këtij procesi të suprimimit të shtetit është klasa punëtore së bashku me të gjithë njerëzit punues. Thesohet se ky proces i suprimimit të shtetit zhvillohet nëpërmjet të vetëqeverisjes, e vetëqeverisja është ai parim që e shënon procesin e suprimit të shtetit duke u evituar ky me zhvillimin e demokracisë socialiste dhe me aplikimin e formave gjithnjë e më të zhvilluara të vetëqeverisjes shoqërore.

Sipas definicionit të amandamentit XV Republika Socialiste e Maqedonisë është njëheri edhe shtet nacional sovran i kombit maqedonas dhe shtet i kombësive dhe grupeve etnike në te. Ajo është edhe bashkë si socialiste demokratike vetëqeverisëse e njerëzve punues dhe qytetarëve, kombit maqedonas, dhe kombësive dhe grupeve etnike të barabarta me te.

Në amandamentin XVI caktohen në përgjithësi, por edhe në hollësi detyrat e shtetit maqedonas. Prej të gjithë kësaj del se Republika Socialiste e Maqedonisë është shtet sovran me të gjitha të drejta dhe detyrat e veta, por sikurse shihet edhe nga konteksti i vetë amandamenteve ai është njëheri edhe pjesë përbërëse e Federacionit, bashkësisë së popujve të bashkuar në bazë të vetëqeverisjes të republikave socialiste, respektivisht krahinave autonome të Kosovës dhe Vojvodinës.

Të përfundojmë: kombi maqedonas, kombësitë dhe grupet etnike ka në të drejtat e veta sovrane, ato i realizojnë në Republikën Socialiste të Maqedonisë, por kanë të drejta dhe obligime edhe të përbashkëta, ndaj RSFJ kur bëhet fjalë për interesin e përbashkët të mbarë njerëzve të Jugosllavisë, me marrëveshje paraprake të Republikave dhe krahinave si është theksuar edhe në kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

S. BILJANOVSKA

Fjala e lexuesit

Ne Kacanik ndihet nevoja per nje shtepi te kultures

Jeta kulturo-argëtuese në qytezën e Kaçanikut, kohëve të fundit, pothuajse është shuar krejtësisht. Programet muzikore që jepeshen shpesh para publikut, tani më janë rralluar, kurse banorët e Kaçanikut, si dashamirë të flaktë të muzikës, kanë mbetur pa fije argëtimi.

Padyshim, një ndër shkaqet kryesore të pasivitetit të shoqërisë „PËRPARIMI" të Kaçanikut, si na tha Rami Raka, anëtar i dalluar i shoqërisë, ishte mungesa e shtëpisë së kulturës, e cila në këtë vend ende nuk është ndërtuar e nevoja për këtë është shumë e madhe. Së pari, anëtarët e shoqërisë »PËRPARIMI« nuk kanë lokal të përshtatshëm për të bërë ushtrime, nuk kanë instrumente të mjaftueshme muzikore, nuk kanë vend për t'i ruajtur veglat që i nevojiten shoqërisë e ndihet edhe mungësa e mjeteve financiare.

Pastaj lokali ku benin përpara ushtrime anëtarët e shoqërisë „PËRPARIMI" nuk është aspak i përshtatshëm.

E si të pregadisin koncerte anëtarët e shoqërisë „PËRPARIMI", kur nuk kanë kushte për të punuar, për të qënë më aktivë dhe për ta shpejtuar pulsin e jetës argëtuese?!

Prandaj Kuvendi komunal, Konferenca e rinisë dhe Bashkësia, për arësim e kulturë e Krahinës mirë është të bëjnë diçka për ndërtimin e një shtëpie të kulturës në Kaçanik. Poqese është kjo, atëherë edhe jeta kulturo-argëtuese në Komunë do të ngjallet më tepër.

Adem HAXHIU

Kërcova pa servis të pastrimit kimik

Pse Kërçova nuk ka servis për pastrimin kimik, është çështje e cila disa herë është parashtruar si problem në disa forume në nivel të komunës. Prandaj me të drejtë thonë qytetarët se nuk është e nevojshme ndonjë përgjegje me shkrim apo me gojë, por hapjen urgjente të servisit të këtillë në qytetin tonë.

Një numër i madh qytetarësh e sidomos të vetmin kër kojnë që me çdo kusht të hapet servisi në fjalë, por sipas gjasash duket se gjer në fund të këtij viti, një servis i këtillë nuk do të hapet në qytetin tonë. Ky është një ga bim i madh. Kur e themi kë të kemi parasysh faktin se qytetet edhe më të vogla nga Kërçova, kanë servise të këti lla, kështuqë Kërçova është qyteti i vetëm që nuk posedon me një servis të këtillë.

Mendojmë se në qytetin to në lehtë mund të gjendet edhe lokal punues për pastrim kimik, larje dhe hekurosje, si dhe personeli i nevojshëm për këto punë, prandaj pohojmë se është domos doshmëri që për një kohë të shkurtër servisi në fjalë duhet të hapet.

K. KADRIU

GUSI

Në Gusi po ndërtohet stacion i ri shëndetsor

Në stacionin shëndetsor të Gusisë i cili veprimtarinë e vet e zhvillon në kuadrin e Qendrës medicinale nga Ivan gradi, pasiqë para tri vitesh u bë integrimi i tyre, punon mjeku i praktikës së përgjith shme, stomatologu, akusherja, një teknik i shëndetsisë, dy infermjere asistenti i sto matologut si dhe një nëpunës. Është ky ekip punëtorësh medicinal i cili kujdeset për mbrojtjen shëndetsore të afro 10 mijë banorëve të Gusisë me rrethinë, na tha Dr. Ruzhdi Rexhepagaj. Para integrimit të këtyre institucioneve shëndetsore, preventivës nuk i kushtohej aq kujdes, sepse i terë aktiviteti i këtyre punëtorëve zhvillohej në ambulancë. Duke falende ruar Primarius Dr. Branko Zogoviqit dhe interesimit të tij për një mbrojtje shëndetsore sa më kualitative kudo në terrenin e Qendrës medici nale nga Ivangardi mbrojtja shëndetsore është organizuar në atë mënyrë që ajo ditaditës po e kryen, ashtu siç duhet, misionin e vet. Sa për ilustrim të shërbehemi me këto fakte:

Stacioni shëndetsor i Gusi së sidomos kujdes të posaçëm i kushton preventivës së nxënësve të shkollave fillo re. Kështu pranë Shkollës fillore »Xhafer Nikoçeviq« punon dispanzeri për fëmijë si dhe mjeku i praktikës së përgjithshme dhe stomatologu të cilët në mënyrë përmanente përcjellin zhvillimin fiziko-psiqik të nxënësve. Mjekët dy herë në ditë bëjnë kontrollin e fëmijëve (nxënës ve) e sidomos luftojnë kundër sëmurjeve të dhëmbëve. Çdo nxënës është i detyruar t'i nënshtrohet kontrollit të mjekut. Nga ana tjetër ekipi i Dr. Ruzhdi Rexhepagajt për çdo javë u bën nga dy vizita punkteve shëndetsore, të cilat ekzistojnë në qendra të fshatrave të Gusisë. Ekipit të mjekëve u bashkohet edhe stomatologu. Sëmurjet zbulohen në fazën e parë të parashqitjeve të tyre si dhe ndërmirren masa të shpejta dhe efikase për evitimin e tyre. Çdo qytetar e di orarin e punës së mjekëve, prandaj edhe i nënshtrohen kontrollit të tyre.

Dy herë në muaj në këtë stacion shëndetsor vijnë mje kët specialistë si internisti ashtu edhe ginekologu. Së shpejti në këtë stacion shëndetsor do të shtohet numri i mjekëve, kështu që Ligja e ci la thot se në çdo 4 mijë bano rë duhet të kemi një mjek do të gjejë shprehjen e vet në jetën praktike.

Lokali në të cilin ka qenë i vendosur stacioni shëndetsor nuk u është përgjegjur kush teve të nevojshme për punë normale. Kjo dhe shkaqe të tjera i shtynë përgjegjsit që të ndërmarrin masa konkrete për zgjidhjen e këtij proble mi. Qendra medicinale nga Ivangardi si dhe Kuvendi i komunës së Plavës ndanë dhe siguruan mjetet e nevoj shme për ndërtimin e stacio nit të ri shëndetsor, i cili tani është në ndërtim e sipër. Ai, siç pritet, do të inaugurohet në muajin maj të vitit të ardhshëm. Do të jetë njëri ndër stacionet më modern me të gjitha lokalet e nevojshme për mbrojtje shëndetsore sa më të mirë. Përveç mjekëve të praktikës së përgjithshme, në të do të punojnë edhe mje këtë ekspertë-specialistë. Kuj des i posaçëm do t'i kushto het mbrojtjes shëndetsore të nënave lehona si dhe grave shatëzana, na deklaroi Dr. Ruzhdi Rexhepagaj.

Duhet të theksojmë se ja në të rralla ato treva, të cilat kanë një mbrojtje shëndetso re siç e ka Gusia. Për këtë shumë merita i takojnë edhe mjekut vendas — mjekut të parë të këtyre anëve — bash këbiseduesit tonë Ruzhdi Re xhepagajt, i cili gëzon besimin dhe simpatinë e më se 10 mijë banorëve të Gusisë dhe rrethinës.

M. GOJÇAJ

OHËR

Filloi levizja e njalave

Mbi liqenin e Ohrit këto ditë mbretëronte një kohë e keqe e shoqëruar me shira dhe frymë jugore. Për këtë shkak liqeni disa ditë me ra dhë qe mbuluar me valë. Kjo kushtëzoi që njalat të lëvizin dhe të nisen në »mua jin e mjaltit«.

Në Drinin e Zi peshkatarët zunë më tepër se 5.000 kg. njala. Gjuetia e njalave në këtë kohë nuk është e zakonshme.

Pritet që deri në fund të vitit të kapen afro 20.000 kg. njala.

Edhepse çmimi i njalës ësh të shumë i shtrenjtë, ajo kër kohet shumë, e një pjesë e madhe e tyre eksportohet në Gjermaninë Perëndimore.

R. P.

PODUJEVË

Ambulanca pa kulm

Ndërtesa e punktit shëndetsor në fshatin Bajçinë qe një muaj e sa qëndron gjysmake. Muret janë ngritur, kurse kulmi jo.

Sipërmarrja zejtare shërbyese Usluga« e Podujevës, të cilës i janë besuar punët, nuk është duke treguar përgjegjesi ndaj marrëveshjes me Kuvendin e komunës së Podujevës.

Sepse siç jemi informuar qysh në fillim, ndërtesa e ambulancës në Bajçinë (sipas marrëveshjes së »Uslugës« dhe Kuvendit të komunës së Podujevës) tash pothuaj ësh të dashur të jetë e gatshme për inaugurim.

Këtu nuk janë në pyetje mjetet materiale, sepse për këtë dhe ambulancën e cila duhet të ndërtohet në fshatin Majanc, nga Sekretariati për mbrojtjen shëndetsore të kra hinës janë siguruar 270.000 dinar.

Tash, kur pothuaj është ko ha që qytetarët e kësaj ane të kanë rastin të kryejnë shërbimet e tyre, ata po nevri kosen duke e parë ambulancën ende pa kulm.

Zaten, për këtë edhe kanë të drejtë, sepse nevoja për hapjen e një punkti shëndetsor në fshatin Bajçinë është ndjerë kahere, kur dihet se që më se gjashtë vjet në këtë fshat funksionon shkolla e plotë fillore e të mos e përmendim numrin e madh të banorëve të tij dhe fshatrave të afërme: Bradash, Dobërdoll, Dobratin dhe një pjesë e fshatrave Peran dhe Llaushë.

Andaj me të drejtë pyesin bajçinasit. Pse ndërmarrja »Usluga« po i çon zvarë punët?!.

Për realizimin e kontratës në mes të ndërmarrjes në fjalë dhe Kuvendit të komunës mbi ndërtimin e këtij punkti shëndetsor duhet të angazhohen maksimalisht fak torët komunalë.

Kuptohet nëse punët nuk kryhen edhe mbrenda disa di tësh, punkti do të ngelë gjysmak gjer në verën e ardhme, gjë që do të ndikojë edhe në dëmtimin e mureve nga të re shurat e ndryshme atmosferike.

Më në fund, nëse ndërmarrja »Usluga« është e zënë me punë gjetkë, kuvendi i komunës duhet të kërkojë përgjegjësi nga udhëheqsia e saj për mosrealizimin e kontratës dhe punët këtu e tutje t'ia japë ndonjë ndërmarrjeje tjetër e cila mbrenda një kohe të shkurtër do ta pregatis të për inaugurim punktin.

J. ÇITAKU

RAHOVEC

FIZIONOMIA E RE E FSHATIT MALISHEVË

Fshati Malishevë është fshat, i cili numron më se 150 shtëpi, shkollë të plotë fillore 6 shitore univerale, hotelin modern, dhe ambulancën e fshatit, në të cilën punon për çdo ditë mjeku i përgjithshëm dhe ca infermjer. Malisheva dikur qendër komuneje, tani është fshat i izoluar nga Rahoveci, fshat ky, i cili dita ditës është duke e shënuar përspektiven e vet të lulëzuar. Tani në ditët e shtatorit në këtë fshat shkrepi një gëzim, shkrepi një dritë, u hapën paralelet e ndara të gjimnazit. Gëzim i madh për banorët e Malishevës dhe rrethinës. Tani fshatarët e këtij fshati thonë: bijtë dhe bijat tona s'do të mbesin më pa shkollë, pa dije. Dëshira e banorëve të ma se 15 fshatrave është bërë realitet i vërtetë.

R. THAÇI

SHKUP

U formua klubi i vetëqeverisesve

— Në mbledhjen themeluese morën pjesë përfaqsues të 47 organizatave punuese të qytetit të Shkupit

Të hënën, me 27 shtator, në lokalet e Univerzitetit të punëtorëve, nën inisiativën e Lidhjes së sindikatave të qytetit të Shkupit, u formua Klubi i vetëqeverisësve të qytetit të Shkupit.

Në mbledhjen themeluese, në të cilën u lexua edhe referat për veprimtarinë vetëqeverisëse të Klubit në të ardhmen, u cek se në fillim ky klub, do të punojë në kuadrin e Univerzitetit të punëtorëve. Klubi i vetëqeverisësve do të merret me të gjitha problemet aktuale, me të cilat hasen vetëqeverisësit në veprimtarinë e tyre vetëqeverisëse nëpër organizatat punuese e njëkohë sisht të gjitha aksionet, do ti koordinojë edhe me të gjitha organet tjera të Kuvendit të qytetit të Shkupit dhe organizatat politiko-shoqërore.

Format dhe mënyrat e rea lizimit të detyrave të Klubit të vetëqeverisësve, do të varen nga aktualiteti i vetë problemeve, me të cilat do të merret, e veçanërisht, detyrë e Klubit do të jetë që t'i informojë vetëqeverisësit nëpër organizatat punuese për ndërrimet e ndryshme, që do të pësojnë ligjet për rregullimin e marrëdhënieve vetëqeverisëse.

Nga se interesimi i organizatave punuese ishte shumë i madh, në mbledhjen themeluese morën pjesë 47 organizata.

Klubi, një ndër aksionet e para që do t'i bëjë së shpejti, është organizimi i tribinës së tretë të vetëqeverisësve të Jugosllavisë.

E.SH.

KLINE

Llozica me ambulance te re

Llozica është fshat afro 100 shtëpi 20 km. larg Klinës. Në këtë fshat që moti është ndjerë nevoja për një ambullancë, që do t'i shërben te Llozicasve tepër për ruajtjen e shëndetit. Tani këto di të punkti në Llozicë ia filloi punës. Punkti, që u ndërtua në Llozicë është mjaft i përshtatshëm për punë në këtë lëmë. Banorët e Llozicës i gëzoi pa masë ndërtimi këtij punkti sepse tani s'u duhet të udhëtojnë më nga 20 km. për t'i vizituar mjeku. Tani në të mjeku punon çdo ditë.

Numri i pacientëve është i mjaftuar që vijnë për t'i vizituar. Së shpejti Llozica do të ketë edhe shkollën përsëkla tëshe fillore. Më këtë Llozica po pëson transformimin so cialist sikur fshatrat tjera. Në ndërtimin e ambulancës u zgjodh edhe një problem mjaft i rëndësishëm për Llozicasit dhe banorët e fshatra ve për rreth saj.

Shaqir FONIQI

STRUMICE

GARA PER BASHKESITE ME TE MIRA LOKALE

Aktiviteti i Bashkësive lokale në komunën e Strumicës është gjithnjë më i pasur dhe më masovik. Në shumë vendbanime ato janë bartëse të jetës së përgjithshme shoqërore dhe ekonomike. Rezultati i një aktiviteti të tillë është edhe pjesë marrja masovike e bashkësive lokale të kësaj komune në Garat republikane, për bashkësi lokale më të mirë në të cilën u paraqitën ma se 30. Tri bashkësi lokale fituan dhurata, ndërsa Boro Milçev nga Strumica fitoi dhuratën e veçantë. Gjithashtu 54 bashkësi lokale nga Strumica kanë dorëzuar pro grame për pjesmarrje në Garat federative të bashkësive lokale, të cilat do të mbahen në periudhën 1971-1975. Pjesëmarrja në garat e lartë përmendura dhe dhuratat e fituara në mënyrë stimulative ndikuan në punën e bashkësive lokale. Me qëllim që aktiviteti edhe më tepër të jetë i pasur dhe masovik respektivisht të vazhdojë me *një tempo të njejtë*, Këshilli koordinues për përcjelljen e aktivitetit të bashkësive lokale pranë Konferencës komunale të LSPP të Strumicës këto ditë pregatiti dhe aprovoi kriteret për zbatimin e garave komunale për bashkësi lokale më të mirë. Iniciativa e këshillit u aprovua nga të gjitha organizatat — bashkësitë lokale. Në kriteret janë paraparë aktivitete lidhur me problemet momentale aktuale nga jeta në fshat, të cilat janë: problemet komunale, rregullimi i vendbanimeve, dhe higjienës publike, bashkësitë lokale dhe zgjidhja e problemeve nga lëma e kulturës, arësimit dhe jetës sportive, zgjidhja e problemeve të mbrojtjes shëndetsore, aktiviteti në lëmën e mbrojtjes së përgjithshme popullore, zhvillimi i marrëdhënieve vetëqeverisëse në bashkësinë lokale etj.

Për bashkësi lokale më të mira Këshilli ka paraparë tri dhurata dhe nga tri dhurata për rezultate më të mira në çdo lëmë veçanërisht ose 18 dhurata (5 për vendet të para, 5 për vendet e dyta, 5 për vendet të treta). Aktiviteti dhe garat në bashkësitë lokale zgjoi interesim edhe në disa organizata punuese, të cilët përvec ndihmës, do të përcaktojnë edhe dhurata të posaçme per më të mirët.

GJAKOVE

Mbrojtja e shendetit ne rend te pare

Shërbimi i Inspekcionit sanitar të Kuvendit të komunës se Gjakovës vitin e kaluar dhe sivjet, ka fusha të gjëra veprimi duke filluar që nga sëmurjet ngjitëse, epidemike dhe higjienës së gjërave ushqimore të shkollave dhe të komunës gjer ke higjiena e rrugëve.

Nga kjo shihet se puna e Inspekcionit sanitar marrë në tërësi, është e përcaktuar në disa drejtime. Nëse marrim parasysh, që puna dhe aksionet e këtij inspekcioni kanë qenë preventivë, më që llim që numri i dënimeve të zvogëlohet sa më shumë, prapseprap gjatë vitit te ka luar dhe sivjet ka pasur shu më raste të aksioneve të ndry shme.

Prej afro 500 fletëdënimeve që i janë paraqitur gjyka tës për kundërvajtje gjatë këtij viti janë realizuar për të gjitha, ndërsa efekti finan siar i fletdenoncimeve të rea lizuara kap shumën prej 16760 dinarësh. Gjatë vitit të kaluar, me kërkesën e palë ve dhe zyrtarisht ky Inspekci on ka bërë 1235 vizita detale në objekte të ndryshme.

Pastaj edhe pastrimi i rru gëve nga ndërmarrja »Çabrati« është tejet i dobët. Mjetet transportuese, me të cilat kjo ndërmarrje i kryen punët si plotsojnë as kushtet minimale teknike e higjenike. Mi rëpo, përkundër kësaj »Çabrati« s'po i kryen punët, që i janë besuar. Ai po vonohet në pastrimin e rrugëve, e kjo gjithësesi paraqet rrezik për shëndetin e qytetarëve.

Inspekcioni sanitar i Kuvendit të komunës së Gjakovës ka qenë efikas edhe në mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve na artikujt ushqimor. Vetëm mish të freskët gjatë këtij viti janë hedhur jashtë përdorimit më se 150 kilogram, dhe kjo sasi kryesisht është gjetur tek mishshitësit privatë, të cilët për çudi disponojnë edhe me vula të falsifikuara me të cilat po i kryejnë »rolin e veterinarit«. Pos kësaj gjatë vitit janë hedhur jasht përdorimit edhe shumë gjëra tjera ushqimore efekti finansiar i të cilave kap një shumë prej 21176 dinarësh të rinj.

Në kuadrin e mbajtjes së higjienës nëpër shkolla organet e Inspekcionit sanitar ka në bërë gjithsejt 18 kontrolime përkundër asaj që në Komunën e Gjakovës ekzistojnë afro 40 objekte shkollore. Numri më i madh i ndërtesave ku janë të stacio nuara shkollat, veçanërisht nëpër fshatra, sipas konstatimeve të këtij organi s'u përgjigjen kërkesave minimale higjenike për punë.

Nga mungesa e lokalit, më simi zhvillohet nëpër turne gjatë tërë ditës, për çka nuk mund të bëhet pastrimi i mjaftueshëm i paraleleve. Nga ana tjetër nëpër paralelet ku zhvillohen mësimet ka raste kur në një bankë ulen ulen edhe 3 gjer në 4 nxënës, dhe këto banka të vjetra që gjithsesi paraqesin rrezik për deformime të ndryshme tru pore tek fëmijët.

N. MORINA

STRUGË

AKTIVITETI I ENTIT TE INKUADRIMIT

Në Entin e inkuadrimit në mënyrë permanente ndjehet taktiviteti lidhur me aftësimin profesional të punëtorëve. Këto ditë muarën fund kurset për përdorues të maqinave ndërtuese, teracerë, etj. Dëftesa për aftësimin profesional fituan 140 punëtorë të rinj, kështu që gjatë këtij viti kësosh fituan 665 punëtorë.

Tash në vijim e sipër janë kurset për metalikë, tjerrës ves, rrobaqepës e të tij.

Këto ditë do të fillojë kursi për rrobaqepës, të cilin do ta ndjekin 30 të reja. Për këtë qëlim është siguruar një ka binet i ri, i cili do të disponojë me 30 maqina për qepje, e për çka janë investuar 250.000 dinarë.

R. P.

TAKIM NE KOCANI PAS 27 VJETEVE

Ditën kur para 27 vjetëve u formua Brigada e 14 sulmuese »Dimitar Vllahov«, luftarët e gjallë të brigadës së bashku me komandantin e tyre Dimitar Mërlanovskin — Osogovskin në vendin ku janë bërë luftërat për çlirimin e Koçanit vunë kurorë, e mandej u pranuan nga kryetari i Kuvendit të komunës Kiro Danillov.

Komenti politik

HAP PERPARA

Shkëmbimi i përsa përfunduar i mendimeve jugosllavo — Sovjetike i çelë dhe i sinqertë, që u mundësoi bashkëbiseduesve që në rend të ditës t'i vejnë të gjitha çështjet, madje edhe ato më delikate lidhur me disa lëmë të mërrëdhënieve biletarale, vërtetoi edhe një herë domosdoshmërinë e bisedimeve të përhershme dhe të rregullta, në mënyrë që të mos përsëriten periudhat e vakuumeve. Këto ndalesa nuk i sjellnin dobi as Jugsllavisë as Bashkimit Sovjetik, por përkundrazi, në disa raste ishin një ndër shkaqet kryesore të grumbullimit të problemeve të hapura. Dhe këto përsëri shkaktonin meskuptime, mosbesime. Nga kërcime dhe rënie të këtilla dëm kishin të dy palët, sepse është e qartë se bashkëpunimi afatëgjatë, stabil është interes edhe i Jugosllavisë edhe i Bashkimit Sovjetik. Gjithnjë kur në marrëdhënjet reciproke situata qetësohej niste periudha e lëshimeve dhe mirëkuptimeve, kjo në mënyrë pozitive shprehej jo vetëm në pozitën bilaterale, por edhe në pozitën ndërkombëtare jugosllave dhe sovjetike. Në këte faza ose plotësisht zhdukeshin ose esencialisht zvogloheshin rezervat e shumicës së vendeve të botës ndaj qëllimeve, potezave dhe aksioneve jugosllave e më shumë të politikës sovjetike, si një ndër politikat e dy fuqive udhëheqëse në botë. E kjo gjë e bënte, krijonte platformën më konstruktive dhe më frytdhënëse edhe te njerës edhe të tjetrës qeveri në skenën ndërkombëtare.

Shqyrtimi i hapur i të gjitha atyre gjërave që gjatë katër viteve të kaluara ishin akumuluar në relacionin Jugosllavi — BRSS, kontribuoi që të vërehen edhe ato çështje ku ekziston aërsia e vështrimit, ndërsa rreth disa çështjeve të tjera qëndrimet janë afruar. Gjithashtu u tregua se ekzistojnë edhe probleme, e do të ketë edhe në të ardhmen, ku ekzistojnë dallimet. As Jugosllavia as Bashkimi Sovjetik nuk kanë hequr dorë nga parimet e tyre, si nga ato që vlejnë për politikën e tyre të brendshme ashtu edhe për politikën e jashtme. Por shqyrtimi realist i problemeve, madje edhe i atyreve më delikuate, bëri të mundshme që Tito dhe Brezhnjevit të vërtetojnë se si ndryshimet nuk guxojnë të jenë element i acarimit. Përkundrazi, kjo gjë do të shtrojë nevojën e dialogjeve të reja. Një përfundim i këtillë i bisedimeve jugosllavo-sovjetike, nuk është asgjë tjetër veç se vërtetim i parimit jugosllav sipas të cilit çdo gjë që është kontestuese, të cilës do natyre qoftë, duhet doemos dhe mund të zgjidhet ekskluzivisht me bisedime të barabarta.

Dokumenti më i ri i përbashkët jugosllavo — sovjetik në mënyrë eksplicite thekson: Respektimin e sovranitetit, integritetit dhe të barazisë, të drejtën e patëhuajsuar për metodat dhe rrugët personale të ndërtimit të socializmit, mospërzierjen në çështjet e brendshme të të tjerëve, me çfarëdo arsyeje qoftë flakje e çdo tentimi të imponimit politik, ideologjik, ekonomik ose të çfarëdo dominimi tjetër qoftë dhe dënimin e çdo agresioni.

Këto janë parime që i përmbanin edhe Deklerata e Beogradit e vitit 1955, kumtuesa e Moskës e vitit 1956 dhe kumtesa jugosllavo — sovjetike e nënshkruar në Moskë në vitin 1965, në fund të vizitës së atëhershme të Titos Bashkimit Sovjetik. Andaj, nuk është gjë e rastit, e madje nuk është as taktikë ajo që dokumenti më i ri jugosllavo — sovjetik i ka nënshkrimet e Titos dhe Brezhnjevit, e në mënyrë kategorikisht të qartë dhe pa kurrfarë përkufizimesh, tri dokumentet e mëparshme i shënojnë si bazë të përhershme të marrëdhënjeve reciproke. Secili prej këtyre dokumenteve në vehte veçanërisht deklerata e Beogradit, e shprehin në mënyrë reale politikën dhe interesat e Jugosllavisë, por edhe të Bashkimit Sovjetik. Së këtejmi ato edhe nuk mund të jenë kohore dhe nuk mund të përkufizohen më me asgjë. E kaluara ka treguar se gjerë te çfarë çregullimesh dhe vështërsish sjell çdo tentim i të thënës se parimet e aprovuara në vitin 1955, 1956, 1965, janë vjetruar. Kushtet e reja bashkëkohore në mënyrë imperative kërkojnë zbatimin e saktë të këtyre parimeve.

Konstatimit se Tito dhe Brezhnjevi kanë bërë një punë vërtetë të madhe — dhe se kjo punë do të ketë jehonë shumë të gjerë i kontribuon edhe fakti se politika e painkuadruar jugosllave dhe pozita e saj edhe një herë pa medyshje kanë treguar vitalitetin e vet. Dhe gjithë realitetin.

Jugosllavia dhe Bashkimi Sovjetik kanë vënë baza të mira për marrdhënje të mëtejme reciproke. U trasuan edhe rrugët për përparimin e bashkëpunimit në të gjitha lëmët ku ekzistojnë interesat e përbashkëta dhe mundësitë. Janë hapur dyert për kërkimin e dalljes atje ku kanë mbetur të hapura çështjet dhe pikëpamjet e ndryshme, por me marrëveshje dhe bisedime.

Tepavci arriti ne Njujork

— SHEFI I DELEGACIONIT JUGOSLLAVË DO TË FLASË TË HËNËN E ARDHSHME NË DEBATIN E PËRGJITHSHËM.

Sekretari federativ për punë të jashtme Mirko Tepavac, i cili e udhëheq delegacionin jugosllav në seancën e XXVI të Kuvendit të përgjithshëm, arriti mbrëmë në Njujork.

Shefi i delegacionit jugosllav, Mirko Tepavac, si merret vesh, do të flasë të hënën e ardhme në debatin e përgjithshëm që filloi dje.

Të enjten me 30 shtator Mirko Tepavac do të marrë pjesë në pjesën e dytë të mbledhjes konsultative të vendeve të painkuadruara në Njujork. Në këtë mbledhje do të aprovohet dokumenti ku do të paraqiten pikëpamjet e vendeve të painkuadruara lidhur me problemet vitale botërore për forcimin e OKB dhe të univerzalitetit të saj, pastaj bashkëpunimin e organizuar të vendeve të painkuadruara në planin ndërkombëtar, e veçmas në mbledhjen e tanish me të Kuvendit të përgjithshëm.

Dokumenti është hartuar në pjesën e parë të mbledhjes konsultative para një jave. Atëherë, gjithashtu, u propozua se gjer në mbledhjen e ardhshme të 27-të, të Kuvendit të përgjithshëm në vitin e ardhshëm të mbahet mbledhja e të painkuadruarve në nivelin e ministrave.

MBLEDHJA E FONDIT NDËRKOMBËTAR MONETAR

Angazhim me i madh i te zhvilluareve per zhvillimin e vendeve te pazhvilluara

Delegacioni jugosllav që po merr pjesë në mbledhjen vjetore të Fondit ndërkombëtar monetar dhe të bankës botërore për zhvillim, në krye me Janko Smolen — sekretar federativ për financa, gjermë tani kishte disa kontakte me rëndësi. Smole pat kontakt me personalitete të shquara të qeverisë amerikane dhe të forumeve financiare botërore.

Janko Smole u takua dhe zhvilloi bisedime me sekretarin për financa të kabinetit të Niksonit, Xhon Koneli, i cili, për ndryshe është komentues zyrtar i politikës ekonomike të kryetarit Nikson, dhe bashk me kryetarin, njëri nga krijuesit e kursit të ri që po quhet edhe politikë e re ekonomike e SHBA.

Si merret vesh, Koneli she Smole këmbyen mendime rreth rezultateve të gjertanishme të bashkëpunimit jugosllavo-amerikan në planin finansiar dhe përgjithsisht në planin ekonomik dhe shqyrtuan mundësitë për zgjërimin e bashkëpunimit.

Para Konelit Janko Smole zhvilloi bisedime edhe me drejtorin ekzekutiv të Fondit ndërkombëtar monetar Pjer Pol Shfajcerin me të cilin i këmbeu mendimet lidhur me gjendjen në Fondin ndërkombëtar monetar dhe problemet me të cilat momentalisht po ballafaqohet sistemi botëror i finansave dhe i tregëtisë.

Indira Gandi ne Moske

Premieri indian Indira Gandi këto ditë gjindet në vizitë tri ditore në Moskë, ku do të ketë bisedime me premierin sovjetik Kosiginin. Qëllimi i kësaj vizite, sipas mendimit të vëzhguesve në Moskë — është shkëmbimi i informatave reciproke rreth çështjeve aktuale ndërkombëtare dhe bilaterale.

Në këto kuadra Indira Gandi do t'i informojë nikoqirët e vet për situatën e tanishme me marrëdhënjet në mes të Hindisë dhe Pakistanit, e posaçërisht për gjendjen e mërgim tarëve nga Pakistani Lindor. Ky, momentalisht, është një prej preoku pimeve më të mëdha indiane, e njëheri edhe problem të cilin Hindia vtështirë mund ta zgjidhë vetë. Në Moskë nuk përjashtohet angazhimi më i gjërë i Bashkimit Sovjetik me zgjidhjen e këtij problemi.

Indira Gandi vjen në Moskë për të parën herë pas nënshkrimit të marrëveshjes Sovjetiko-Hindistiane për miqësi dhe bashkëpunim.

Marrëveshja është nënshkruar mu ajin e kaluar në NjuDelhi në situatë acarimi të plotë në marrëdhënjet në mes të Hindisë dhe Pakistanit, dhe i jep mundësi BRSS që në mënyrë më direkte dhe më gjërësisht të angazhohet në Azi. Në politikën globale sovjetike në Azi, Hindia zen vend të veçantë jo vetëm si shtet i dytë aziatik për nga madhësia, pas Kinës, por edhe si shtet i paangazhuar me një farë ndikimi mbi shumë vende aziatike që zbatojnë politikë joangazhimi. Randësia e Hindisë si partner në politikën e jashtme sovjetike arrihet edhe në driten e marrëdhënieve në mes te Moskës e Pekinit si dhe në hapjen e marrëdhënjeve në mes të Kinës dhe Amerikës.

Gromiko u takua me Shelin

— SHELI DO TA VIZITOJË MOSKËN NË MUAJIN NËNTOR

Mbrëmë në Njujork u takuan ministri i punëve të jashtme të Bashkimit Sovjetik Andrej Gromiko dhe ministri i punëve të jashtme të Republikës Federale të Gjermanisë, Valter Sheli. Ata dy orë zhvilluan bisedime rreth marrëdhënjeve bilaterale, për problemet e sigurisë evropiane dhe për çështjet tjera ndërkombëtare me interes për të dy vendet.

Pas këtij takimi një përfaqësues gjermano perëndimor, deklaroi se ministri Shel do të vizitojë Moskën në nëntor, dhe me Andrej Gromikon do të vazhdojë këmbimin e pikëpamjeve.

Mbresa udhetimi nga Shqiperia

QYTETI I NJEMIJE DRITAREVE

Kur arritëm në Fier, ishte kohë dreke. Në pan kishim të vizitojmë Azotikun e Fierit, një ndër objektet më të mëdha në këtë qytet dhe në Shqipëri, të këtij lloji. Përndryshe shokët tanë nga Shqiperia qysh më parë na kishin folur për Azotikun dhe na me padurim pritnim ta shohim për çka edhe shkuam pa ngrënë drekë.

Në hyrje të Azotikut na priti një teknolog i ri, i cili me maturinë e tij në të folur të bënte të kuptosh se është mjaft i rafinuar në këtë punë. Ai prej fillimi e deri në mbarim të vizitës tonë që i bëmë Azotikut na printe përpara dhe na jepte sqarime të nevojshme për çdo repart. Herë-herë ndonjë nga shokët tanë pyste për ndonjë gjë që e interesonte dhe ai përgjigjej pa përtuar.

Azotiku me të vërtetë ishte një vepër vigane. Në çdo vend proçeset ishin të specializuara dhe me ta udhëhiqnin teknologë të rinj nga mosha, kisha thënë moshatarë tonë ndoshta edhe më të rinj. Shumica prej tyre kishin kualifikimet përkatëse, kurse ata që nuk i kishin, ishin regjistruar në Filialën që kishte hapur USH i Tiranës për t'i plotesuar nevojat me kuadro. Për ne Filialat janë risi. Në Shqipëri ka gadi në çdo qytet, sipas nevojave. Ato i hap USH i Tiranës, për të plotësuar nevojat e vendit me kuadro të nevojshme. Kjo proçedurë shkon në këtë mënyrë: për nevojë të krahut të punës, nga njëra anë, si dhe duke mundur të përfshihen të gjithë kandidatët që duan të studjojnë në USH të Tiranës, nga ana tjetër, USH i Tiranës nëpër qendra të ndryshme, ku ndjehet nevoja për profile të një kuadri gjegjës, hap Filialën gjegjëse. Studentët që regjistrohen në Filialë krahas studimeve edhe punojnë dhe janë në marrëdhënje të rregullta pune. Para dite punojnë kurse pas dite ndjekin ligjëratat. Kur vjen koha e provimave atyre u jepet nga një muaj pushim që të mund të pregaditen. Ky pushim u paguhet sikur të kenë qenë në punë. Kështu shumica e shokëve që njoftëm në Azotik ishin studentë të Filialës dhe na thanë se janë shumë të kënaqur që mund të punojnë dhe të studjojnë menjëherë, pasi në këtë mënyrë mund të lidhet më mirë praktika me teorinë.

Për nevojat e Azotikut me rrymë elektrike, në afërsi të tij ishte ndërtuar TEC-i (termo-elektro centrali), i cili furnizonte Azotikun me korent. E vizituam edhe TEC-in. Edhe ky ishte i pajisur me mjete e vegla moderne, ku, poashtu, përgjithësisht punonin të rinj.

Ishte afruar koha kur duhej të nisemi për në Berat, kështu që u ktheva në hotel ku pritnin shokët.

Ishim diku në mes të rrugës Fier-Berat. Në shoqëri isha me shokun Vasil Dhoska. Me të, deri këtu, nuk kishim këmbyer asnjë fjalë.

— Më vjen shumë keq që do të arrijmë vonë në Berat — tha Vasili duke kthyer kokën nga unë. Pa-



Berati

Ora ishte 14 kur shkuam të drekojmë. Hotel „Turizmi" ishte në qendër të qytetit. Unë hëngra drekë me të shpejtë dhe dola të shetis pas në qytet. Fieri është një qytet i ri, me ndërtesa të reja, moderne, me rrugë të gjëra dhe të asfaltuara. Për pastërtinë të mos flasim. Ajo është në kulm në çdo qytet që të shkosh. Pastërtinë e ruan çdo qytetar në Shqipëri. Mandej, ka nxënës kujdestarë që kujdesen rregullisht për këtë, të cilët po të shohin ndonjë qytetar që hudh ndonjë send rrugëve menjëherë ia tërheq vërejtjen për çka qytetari është i detyruar të kërkojë falje dhe ta merr sendin e hudhur duke ia gjetur vendin e vet.

si unë heshta ai vazhdoi. — Do të ishte mirë të vizitonim Kombinatin e Tekstilit „Mao Ce dun". Është një kombinat modern. Aty kishi për të parë prodhime shumë të mira të tekstilit të cilat i prodhojmë ne.

Kjo që biseda e vetme që zhvilluam me Vasilin deri në hyrje të Beratit. Në të majtë të rrugës kur hyn në Berat, nga Fieri, është një ndërtesë ku shkruan KOMBINATI „MAO CE DUN". Ktheva kokën nga Vasili.

— Ky është — tha ai, duke luajtur kokën.

Autobuzi nuk dëgjonte bisedën tonë, prandaj edhe vazhdoi rrugën.

Kishim hyrë në Berat. Që në fillim vërejta se diçka, në këtë qytet, po më tërheq. Kishte diçka karakteristike, që jo vetëm mua, por edhe shokët e mij i tërhiqte. Duke u munduar të gjej atë që ishte karakteristike isha ndalur te Ura mbi lumin Osim, i cili Beratin e ndan në dy pjesë — pjesën e Vjetër të Qytetit dhe pjesën e Re.

Në të djathtë, kur hyn në Berat, gjendet pjesa e Vjetër e ngritur në një shpat mali. Shtëpitë janë të renditura afër njëra tjetrës aq sa nga larg, edhe nga vendi ku e soditja, tash unë pjesën e Vjetër të Qytetit, të duket se aty ku mbaron një pullaz, fillon një tjetër dhe kështu me radhë. Rrugët e ngushta të shtruara me kalldërm i jepnin pamjen e një qyteti që i karakterizon qytetet e tipit oriental. Mirëpo, ajo që të tërhiqte më tepër ishin dritaret. Nga ana tjetër e lumit, prej ku e soditja tash unë qytetin, të dukej se në këtë shtëpi nuk ka aspak mure, por vetëm dritare. Dhe me të vërtetë gjithë çka na binte në sy ishin — dritaret.

Pastaj prej Vasilit mora vesh se Beratin e quajnë edhe Qyteti i njëmijë dritareve. Kështu në Shqipëri kur përmendet Qyteti i njëmijë dritareve mendohet për Beratin.

Nuk vonoi shumë dhe dritat u ndezën në qytet. Poçat elektrike bënin dritë në të katër anët. Pjesa e vjetër e qytetit tash dukej më atraktive. Nga secila dritare një dritë dhe nga secila shtëpi nga shumë drita menjëherë...

Duke soditur Qytetin e njëmijë dritareve më thirri Vasili që të shetisim pak edhe në pjesën e Re të qytetit. Ajo është menjëherë në të majtë të Osumit, kur hyn nga Fieri. Edhe pjesa e re ishte e bukur, me ndërtesa të reja, me rrugë të gjëra ku ndritnin llampat e neonit dhe në këtë mënyrë sikur i bënte konkurencë pjesës së Vjetër të Qytetit, i cili mua megjithatë më dukej me simpatik.

Darkën e hëngrëm në Berat edhe pse nuk kishim planifikuar ashtu. Mirëpo e hëngrëm me dëshirë të të gjithëve, pasi të gjithë deshin ta shohin sa më gjatë atë pjesë të Qytetit ku ishin njëmijë dritare, e cila natën dukej më bukur se ditën...

Ajri BEGU

TURQI

Gjendja e jashtezakonshme vazhdon–pse?

Këto ditë Parlamenti turk për të katërtën herë do të votojë për zgjatjen e re të gjendjes së jashtzakonshme në 11 provincat kyçe në vend.

Qeveria me siguri është e vetëdishme se ky anulim i pafund i normalizimit të premtuar të jetës do të ketë jehonë mjaft negative. Nuk do të pranohet mirë as në botën e jashtme, ku ajo dëshiron të lejë përshtypje të një faktori autoritativ politik, e jo të një organi të imponuar ushtarako-policor as brenda në vend, ku paraqitet me devizën se ka për qëllim të vendosë themelet e zhvillimit të mëtutjeshëm shoqëroro-ekonomik në mënyrë që të shlyejë përshtypjen se është dorë e zgjatur e armatës.

Domethënë, ekzistojnë arësye të fuqishme kur, edhe përpos kësaj premieri Erin vendosi Parlamentit t'i paraqesë kërkesë të re për zgjatjen e gjendjes së jashtëzakonshme. Cilat janë këto?

Nënkryetari i parë i qeverisë, Sulejman Koçash, i cili përndryshe konsiderohet si njeriu i dytë në Turqi, në një deklaratë që e dha para disa muajsh në Stamboll e paralajmëroi arësyen e parë të mundshme për zgjatjen e gjendjes së jashtëzakonshme. Pasi që nënvizoi se „anarshistët komunistë më së shumti rekrutohen nga radhët e studentëve", Koçash me një dozë entusiazmi theksoi se „lufta me ta do të jetë e gjatë dhe e vështirë". „Për ne nuk është problem që të burgosim 100 — 200 studentë, veprimtaria komuniste e të cilëve tanimë është argumentuar. Në Turqi, ndërkaq, ka më shumë se 100 mijë studentë".

Padyshim, qeveria frikësohet nga turbullimet e reja studenteske, posaçërisht pas aprovimit të ndryshimeve në Kushtetutë, me të cilat u suprimuan autonomitë e deritanish me politike të universiteteve. Rinia studenteske e orientuar në të mëngjër këtë gjë me siguri nuk do ta pranojë pa reaksione. Fillimi i shpërthimit të revoltës eventuale studenteske lidhet me fillimin e vitit të ri shkollor më 1 tetor. Sipas kësaj, zgjatja e gjendjes së jashtëzakonshme përfaqëson përgjigjen qeveritare në kërcnimet e mundëshme studenteske.

Arësyeja e dytë fshehet në proceset politike të mëdha. Në këtë çast para gjyqeve ushtarake në Stamboll dhe në Ankara gjinden më tepër se 200 personë — oficerë të lartë, gazetarë, profesorë universitetesh, dhe studentë, të akuzuar se kanë dëshiruar të organizojnë komplot për „grushtshtet shtetëror në bazë komuniste". Përpos kësaj, në Ankara para gjyqit gjindet udhëheqja komplete e Partisë së Punës së Turqisë, në krye me liderin e Partisë, zonja Behixh Boran, e akuzuar se kanë dëshiruar „të realizojnë dominim të një klase mbi tjetrën". Në këtë paraqitje shembëllash nuk duhet harruar as procesin kundër anëtarëve të organizatës ilegale të Armatës nacionalçlirimtare të Turqisë.

Besohet se vendimet gjyqësore të këtyre katër proceseve politike do të jenë mjaft të rënda, kështu që nuk lehet pasdore mundësia nga protestat, sidomos në qendrat me të mëdha. Me zgjatjen e gjendjes së jashtëzakonshme sigurisht deshirohet të sigurohet nga çdo eventua litet.

Arësyeja e tretë është çështja e kurdëve. Fakti se gjendja e jashtëzakonshme vlen edhe për të dy provincat e kurdëve Dijarbekir dhe Sirit, e se ushtria atje vazhdon të bëjë bastisje dhe t'i burgosë kurdët të cilët refuzojnë të deklarohen turq, flet më së miri për madhësinë e lëvizjes nacionale të kurdëve, përkundrejt pohimeve këmbëngulëse të qeverisë se fjala është për një aksion krejtësisht të parëndësishëm. Duket se prania e mëtutjeshme e ushtrisë në këto provinca është e domosdoshme.

Duke dale nga Parisi

Ora tetë e mëngjezit. Rruga nga Parisi, prej Gar di Nord në Belgjikë. Udhëtimi i mi parë në vendin ku ka shumë sipërfaqë. Treni i gjel bërt si tërshërë e re. Konduktori i vjetër i përgjumshëm me kapele të zezë, stolisur me yje. Stacioni plot hekur dhe lëkura të murme të valixhive. Në njërin kuqlon etiketa e hotelit: oqean!

Nga e djethta ngel Sacre Koeur me bohemin monmartrian Duken edhe varrezat parisiene, por penda për një çast e mbulon me bar. St. Denis, varrezë bretërore. E shoh nga kopështet plot qershi, me lule doma tesh dhe specash. I gjelbërt si hardhuca, këtu një park kalbet në barin me koteca pulash. Rreth varrezave mbretërore kullosin lopë të zeza e të bardha. Drithi në zabel dhe hasha shi i fshatit të cilat i thërmon kalimi i trenit. Qielli i kaltërt që hidhëron miniaturistin.

Goussainville me shtëpi të vogla, të kuqe, si këndezi i hidhëruar. Du ket horizonti, fuqia kryesore e peisa zhit verior. Në largësi si pëllumbi zbardhon në patatet e lulëzuara kali: Loures.

Panxhari, tërshëra, murrela — dhe asgjë tjetër. Treni vazhdimisht ec nëpër njëfarë korite dheu. Qielli për një çast hapet, por menjëherë tër hiqet prapa në koritë, në dheun e bardhë, në patate, hardhucave.

Po, peisazhi i miniaturistëve verior rë. Pyjet me trungje të holla dhe me hije të kaltërta. Ajri është aq i pastërt sa që prej pesë metrave, në kentë, nga treni duken bretkocat në fund të saj. Kështjella të vogla në mes ka momilesh me përrua artificial. Në kodër një kullë. Chantilly. Me shirit të bardhë nën fyt rrijnë në gjelbërim si zogj. Si qenë të rinj. Oise rrjedh nëpër rërën e kuqe në zabel. Peisazhi leshatuk, i vjetër si hermelini mbretëror.

Creil. Kopështe. Kopështari që bën gogol të gëzueshëm dhe që pikturon me akuarel. Prapa kotecit, nga terri, përnjëherë doli kampanjeri me një këndez të hekurt në dorë. Peisazhi rreth Oise është aq me lagështi sa që menjëherë i ndryshket bishti. Nga lopa shumë e rëndë pikon qumësht. Që, baraka e derrave. Muri që dikur moti ka rrethuar varrezat, sot, që, nuk mbron asgjë. Prapa pyllit përsë ri qiti krye Oise. Lundrim pyjor. Lisa. Shumë shtëpi qerpiqësh. Rreth tyre bimë uji. Mashna me dyer të mëdha për të futur sanën dhe kashtën. Pyrgje të zeza me lëmyshqe. Dritarja e mansardës. Në të kufoma e anzës në ngjyrërat e flamurit flaman. Shtëpitë laramane si lopët. Peisazh i zjarrtë. Çdo shtëpi plot zjarr dhe bukë!

Compiegne. Rruga për Amiens. »Hotel du Grand Ture«. Kisha si kurorë mbretërore me brirë djallëzorë. Peisazhi i Margaritës austriane! Kultivojnë trëndafila. Të kuq, që qëndrojnë para murit të dhomës së pal yer. Zgjerohen dy elemente të këtij peisazhi: hapësira dhee kuqja e tjegullës. Në të parin vizatimi e në të dytin ngjyra e këtij trualli.

Kishezat të nxira si në vendin ku thahet mishi. Kali në kopësht. Laras ka në cung. Edhi i bardhë në hasha shin e egër. Barkat e zeza, të rënda, të kalbura, notojnë midis lopëve në livadhe, pranë kopeve, nëpër pyje. Këto në të vërtetë janë dhoma të mëdha në ujë, me të cilat drejton ndonjë mjekrrosh si Noe.

Kështjellë në maje të pyllit. I lënë shkret. Bimë të ndryshme kanë fillu ar të gjelbrojnë në dritaret e saj. Peisazh i bimëve ujore dhe i akuare listëve që kanë pikturuar miniatura: gjahu mbretëror dhe stinët e vjetit në kalendarët e vjetër, me Zodijakun, me lule në maj dhe me therjen e derrave në dhjetor.

Voyon. Katedrala më ngjyrë të ku qe të errët. E rëndë dhe e thjeshtë. E murosur thellë në tokë. Mëzati e shikon. Dy pyrgje katërkëndëshe.

Baboeuf i rasur me patate, me ha shash, me tërshërë, me këndeza.

Appily i verdhë nga drithi, i leh të nga lisat. Gjithshka është e gjel bërt dhe e lëngshtë. Në muzg këtu mijëra bretkoca krekasin. Bretkocës femër këtu stomakun e ka të butë dhe të fryrë. Era e kënetës hyn në vagon. Trualli përpin hekurudhën.

Abbecourt është kënetë e mrekullueshme. Toka lakohet nën njeriun. Shelgje për mëngjezin e loparëve. Vatteau është i kësaj aie. Piktor i të verdhës shushuritëse të luleve të kënetës. Pastorala e sotme është e pagojë dhe e shurdhët. Lopën nuk e thirr më buria. Nga miniera e thëngjillit qetas doli kisha dhe qëndron e hollë — si gatë, e bardhë me maje të mprehtë.

Chauny. Qiell, lëvrues dhe tokë. Asgjë. Dhe gjithshka! Kuajt lëvrojnë. Lopa me gjinjë deri në tokë. Postieri, qe, kërkon ndonjë nga shtëpizat e qenve.

Tergnier. Kishat si karrota. Në vend të këndezit, kryqi! Fshatarët ndërtojnë mularë kishash për mbroj tësit e bagëtisë dhe përmendore gjyshërve të vdekur. Çfarë verdhësie. Luledielli? Panxharth? Lërues lakuriq. Njerëzit, si në pikturat e Miles, i falen tokës. Në një fushë më tepër hashash se drith. Kisha si fortifikatë. Se kjo përsëri është kishë, kuptohet sipas pyrgthit, në horizont, më i vogël se lejleku. Peisazh i hatashëm. I ngjajshëm me atë të Sllavonisë, por pa lisa. Këtu rrufeja shpesh i bie kalit. Përsëri vetëm shtëpia prej tje gullash të kuqe dhe lulëkuqe. Një mëzat shikon shkallët për të hypurit të pulave në muzg.

Kisha e kuqe në shqirrë. St. Quentin. Në stacion, pikturë femre laku riqe punuar me shkumës të bardhë nëpër tjegullat e kuqe. Katedrala mbi kënetë. Pa pyrg. Tenteneja goti ke shihet nëpërmjet të shtogut të lulëzuar. Kishëzat fshatare si në Turopol. Kali kullot. Përrojet pa gumëzhitje. Artificiale. Dofarë pasqyrash të jeta, të turbullta.

Matko PEIQ

JEUNE AFRIQUE

Zonja e pare e Kilit

Si në të gjitha vendet e pazhvilluara me urbanizim të shpejtë, popullsia qytetare e Kilit, e cila në popullsinë e përgjithshme të Kilit merr pjesë me 75 për qind, jeton në kuartet e filiqta dhe viktimat e para të kushteve të këtilla të jetës janë femrat dhe fëmijët. Shoqëria e Kilit, si dhe të gjitha shoqëritë në këtë pjesë të Amerikës, bënë segregacionin e gjinive dhe shkuan deri në atë që në një vend votues të votojnë meshkujt e në tjetrin femrat. Në të shumtën e rasteve femrat i janë të nënshtruara dominimit të meshkujve.

Tença Alende e cila u bë »zonja e parë« e Kilit, pas ardhjes në pushtet të të shoqit të saj, socialistit Salvador Alende në vjeshtë të vitit 1970, është bindur se revolucioni i vërtetë në realitet fillon me emancipin e plotë të femrës. Gjatë këtij viti ajo shumë herë ka shprehur frymën e saj luftarake dhe shumica e banorëve të Kilit e konsiderojnë si femër e cila në vehte bashkon veçoritë e »zonjës, luftëtarës dhe nënës së familjes«.

»Do të dëshiroja që të gjithë banorët e Kilit të kenë punë dhe banesë dhe të mos ekzistojnë më dramat pa kulm mbi krye«, thotë ajo. Simpatike dhe e afërt, Tença Alenda është e gatshme t'i ndihmojë ba shkëshortit të saj në detyrën e rëndë te ndërtimit të socializmit në Kil. Ajo haptazi deklaron: »Ky vit do të jetë i vështirë dhe problemi strehimor do të jetë edhe më akut. Kilit i mungojnë 500 mijë shtëpi dhe është e kuptueshme se pa vështërësi ato nuk mund të ndërtohen për disa muaj.«

Si në shumë vende në të cilat situata ekonomike është e vështirë edhe në Kil, pas problemeve të tjera edhe prostitucioni është serioz, por Tença Alende mendon se »në qoftë se të gjitha femrat do të kenë punë në fabrika, në shërbimet publike, ose në ndërmarrjet publike, prostitucioni do të zvogëlohet në mënyrë të dukshme.«

Çkurorëzimi në Kil nuk ekziston, siç, për ndryshe, është rasti në shumë vende kalotike, por bashkëshortja e kryetarit shpreson se socializmi do t'ë ndryshojë këtë gjendje: »Në këtë vend ekziston një iluzion që duhet mosshkatrrimi i bashkëshortësisë gjë që është rrenë absolute, që krahas kësaj është edhe shumë i shtrenjtë. Unë jam për çkurorëzim dhe ka ardhur çasti që ai në Kil të lejohet. Kjo është mënyra që të mbrohen femrat dhe fëmijët«.

Nova Makedonija

Marreveshje shoqerore

Rreth 30 përqind të organizatave punuese në RS të Maqedonisë ende janë nën ndikimin e Ligjës federative, me të cilën u ngurrosën të ardhurat personale. Kusht për disponimin e lirë me një pjesë të të ardhurave të dedikuara për të ardhura personale është nënshkrimi i marrëveshjëve vetëqeverisëse, në bazë të marrëveshjeve të aprovuara shoqërore. Punuesit e interesuar në organizatat që janë vënë nën »akull«, me të drejt të e shtrojnë pyetjen se kur do të nënshkruhen marrëveshjet vetëqeverisëse në mënyrë që edhe të ardhurat e tyre personale të lëvizin përpjetë, sepse prej përkufizimit të tyre shpenzimet jetësore deri më sot janë shtuar në mënyrë të ndjishme.

Në qershor të këtij viti, Kuvendi i RS të Maqedonisë solli Ligjën për marrëveshjen shoqërore dhe vetëqeverisëse për bazat dhe masat e ndarjes së të ardhurave dhe të të ardhurave personale dhe për orientimin shoqëror të ndarjes së të ardhurave. Edhepse vetë titulli i kësaj ligje flet shumë, ai është vetëm një pjesë e asaj që duhet të kryhet së shpejti. Për këtë arësye, duket se kemi ngelë në gjysmë të rrugës, se nuk është bërë asgjë.

Mirëpo, në Sekretariatin republikan për punë, u bindëm se nuk është zvogëluar intensiteti për rregullimin e materjes që bie në domenin e ndarjes. Përkundrazi, ai është përforcuar, posaçërisht pas pushimeve vjetore.

Një komision tripartiak, i përbërë nga përfaqësues të Këshillit Ekzekutiv, Këshillit republikan të sindikatave dhe Odës Ekonomike, në mënyrë të shpejtuar punon mbi formulimin e modeleve dhe kritereve të marrëveshjes shoqërore në Republikë, e cila duhet t'i rregullojë parimet që do të shërbejnë si bazë për sjelljen e marrëveshjeve vetëqeverisëse. Për pjekjet e këtij komisioni ditëve të fundit janë orientuar kah gjetja e një modeli, sipas të cilit do të duhej të bëhet ndikimi shoqëror mbi ndarjen e të ardhurave.

Me marrëveshjen shoqërore, midis tjerash, duhet të sigurohet që de gët, respektivisht grupet që realizojnë të ardhura më të mëdha për ndarje për një punëtor në krahasim me të ardhurat e realizuara në ekonomi përgjithësisht, të ndajnë më shumë mjete për akumulim dhe për të ardhura personale. Me këtë rast rritja e mjeteve për akumulim do të duhej të jetë më intensive. Ajo pjesë e të ardhurave, që janë rezultat i kushteve më të volitshme të ekonomizimit do të duhet të orientohen për zgjerimin e bazës materiale të organizatës punuese.

Në këtë çast punohet për gjetjen e bazave të përbashkëta për llogaritjen e rezultatit afarist dhe masave për sigurimin e ndarjes sipëas rezultateve të punës; metodologjisë dhe kuantifikimeve suazore për aplikimin dhe krahasimin e elementeve dhe marrëdhënjeve për ndarjen e të ardhurave; lartësisë së të ardhurave personale që sigurojnë sigurinë sociale dhe stabilitetin në varësi nga shkalla e përgjithshme e produktivitetit të punës shoqërore dhe kushteve të përgjithshme në Republikë. Formulat për përcaktimin e këtyre elementeve, sipas diskutimeve të shumta teorike, tanimë janë gjetur dhe, sipas disa aplikimeve konkrete, ato janë të pranueshme për kushtet tona. Mirëpo, për një siguri më të madhe, modelet e gjetura do të kontrollohen në qindra organizata punuese dhe pas kësaj do të fillojë formulimi përfundimtar i marrëveshjes shoqërore, të cilën pastaj duhet ta aprovojnë forumet kompetente — të sindikatave, të Odës dhe të Këshillit Ekzekutiv.

Kështu qëndron puna me marrëveshjen shoqërore për rregullimin e ndarjes në Republikë, e cila pritet të aprovohet kah fundi i tetorit, poqese nuk paraqiten komplikime tjera. Ngel që, pas kësaj organizatat punuese, brenda në grupacionet e tyre të angazhohen për përpilimin e marrëveshjeve vetëqeverisëse, që, gjithsesi, është punë mjaft e ndërlikuar. Sepse, me rastin e përpilimit konkret të elementeve të marrëveshjes shoqërore, me siguri do të vijë deri në konflikte midis interesave individuale, të çdo organizate punuese, kështu që do të nevojitet një kohë e konsiderueshme për harmonizimin e tyre. Në marrëveshjen shoqërore, për shembëll, midis tjerash, do të rregullohen edhe mënyra dhe lartësia e ndarjes së mjeteve që ndikojnë indirekt mbi të ardhurat personale, siç janë kompenzimet për shfrytëzimin e veturave private, lartësia e mëditjeve e të tjera.

Për shkak të detyrës së ndërlikuar në hartimin e marrëveshjeve vetëqeverisëse të grupacioneve ndoshta ësh të gjë e dobishme që qysh tani të ndërmirret inisiativa në Odë ose në sindikatë për hartimin e marrëveshjeve vetëqeverisëse. Në këtë mënyrë parimet themelore do të përcaktoheshin qysh tani, kurse elementet do të përpunoheshin pas aprovimit të marrëveshjes shoqërore. Për këtë, gjithsesi, inisiativë duhet të japin organet vetëqeverisëse të atyre organizatave punuese, të ardhurat personale të të cilave janë të përkufizuara me ligjën federativë. Nuk mund të bëhet kurrfarë rritjeje e të ardhurave personale deri sa të nënshkruhet marrëveshja vetëqeverisëse. Kjo gjë thuhet edhe në ligjën për marrëveshjen shoqërore, ku midis tjerash thuhet se »organizatat dhe puna e bashkuar që nuk respektojnë parimet e përcaktuara në marrëveshjen shoqërore nuk mund të paguajnë të ardhura personale për një punëtor më të larta nga të pardhurat e paguara personale sipas llogarisë *përfundimtare të vitit* të mëështë e domosdoshme dhe e dobishparshëm«. Pikërisht për këtë shkak me që hartimi i marrëveshjes shoqërore dhe marrëveshjes vetëqeverisëse në Republikë të zhvillohet paralelisht.

— A do t'i rrisim të ardhurat individuale?
— S'mundemi! Ne punojmë pa humbje.

4 Jul

INKURAJIME QE OBLIGOJNE

Ata që rregullisht i përcjellin ecurinë e këmbimit tonë tregëtar me botën e jashtme shënuan se në kohë të fundit gjithnjë më shpesh me optimizëm flitet për raportin import — eksport.

I krahasuar me vitin e kaluar, importi në periudhën e kaluar shtatëmujore tregon trendin e rënies, edhepse më shumë jemi mësuar me të kundërtën. Me të vërtetë nuk është fjala për zvogëlimin e importit të përgjithshëm në krahasim me vitin e kaluar; ai në vlerë absolute edhe më tutje është i madh.

Mirëpo, inkurajon ajo që numrat tregojnë se në këtë import të zmadhuar, ka stagnim. Për të tre muajt e parë të këtij viti importi ishte më i madh për plot 45 për qind se në periudhën e njejtë të vitit të kaluar. Për të gjithë shtatë muajt e sivjemë (Janar — korrik) importi është gjith sejt për 26 për qind më i madh se në periudhën e njejtë të vitit të kaluar. Për »përmirësimin« e ndjishëm të bilancit negativ kontribuoi korriku, në të cilin importi ishte gati baras me atë të korrikut të vitit të kaluar.

Nga ana tjetër, shënimet statistikore treguan se në shtatë muajt e parë të këtij viti janë eksportuar mallra (vlerësuar në dinarë) për afro 4 për qind më tepër se në periudhën e njejtë të vitit të kaluar. Nga kjo do të mund të konkludohej se fjala ësh të për rritjen e eksportit. Mirëpo, punët marrin domethënje krejtësisht tjetër nëse përkujtohemi në devalvimin e janarit. Lehtë mund të llogaritet se fjala nuk është për rritjen e sasisë së përgjithëshme të mallrave të eksportuara, por vetëm për rritjen jo të madhe të dinarëve të fituar nga mallrat e eksportuara.

Sidoqë të jetë, rezultatet të këtilla si janë, — inkurajojnë, sepse para së gjithash e tregojnë orientimin e ekonomistëve për zvogëlimin e importit dhe për rritjen e eksportit. Para devalvimit të janarit të dinarit dhe revalvimit të më shumë monedhave të atyre vendeve ku eksporti ynë është më i madh, importi u bë më i shtrenjtë e me këtë edhe më pak rentabil për njerëzit afaristë, kurse eksporti përsëri sjell më shumë të holla se më parë.

Por, punët nuk janë aq të thjeshta dhe nuk varen ekskluzivisht nga ajo çfarë masash sjell qeveria jonë dhe çfarë qëndrimi në pajtim me këtë, do të kenë ekonomistët. Ekonomia e gjithmbarshme botërore përjeton — tronditje më të vogla ose më të mëdha, e gjithë kjo nuk mund të na kapërcejë edhe neve.

PROBLEME TË RINISE

Polemike per te ardhurat e udheheqesve te rinise

— NË SHUMË KOMUNE TË RSM ÇËSHTJA E KRYETARËVE NUK ËSHTË E ZGJIDHUR

Reogranizimi i LRM me vehte solli shumë novitete në veprimtarinë e tërësishme të kësaj organizatë politiko-shoqërore. Aq më tepër, kur dihet se me këtë hap organizativ edhe organizata muar një fizionomi të re për të cilën gjë, të gjitha forumet në mbarë Republikën ishin të angazhuar që sa më shpejt ti adaptohen rasore metodave të reja organizative të rinisë.

Tani, tri vjet pasi u ndërmuarën masat e para riorganizuese, janë duke u paraqitur disa probleme të një natyre për të cilën në të ardhmen do të bëhet fjalë edhe më gjërësisht. Gjegjësisht, një ndër qëllimet e riorganizimit, ishte që të vihet gjer tek deprofesionalizimi i disa funkcioneve të rinisë si në organizatat bazë, e gjithashtu edhe në ata më të lartat. Natyrisht, ky qëndrim i cili sjell te me vehte një të re në organizimin e te rinjve, kërkonte edhe një angazhim më të gjërë, një përpunim dhe analizë më intenzive që të vihet gjer tek realizim më i përplotë.

Mirëpo, me deprofesionalizimin e disa funkcioneve të rinisë, veçanërisht me atë të kryetarëve të konferencave komunale të rinisë, »sharra ngeci në hekur«, ose, qëllimet e riorganizimit të plotë të rinisë nuk e gjetën vendin e vet në tërë ato procese. Kështu, sipas mundësive e veçanërisht sipas qëndrimeve të ndryshme të organizatave të rinisë në RSM, çështja e udhëheqësve të rinisë dhe kryetarëve zgjidhej në mënyrë të ndryshme.

Sot, në Maqedoni egziston një numër i vogël i organizatave të rinisë në të cilat kryetarët janë të paguar për punën që bëjnë. Komunet më të mëdhaja këtë çështje e kanë rregulluar në atë mënyrë që i paguajnë kryetarët e tyre. Mirëpo, shumica e komuneve, duke mos pasur mjete te duhura, nuk japin mjete sa që janë të nevojshme për organizatën e rinisë. Kjo çështje gjatë dy viteve të fundit diskutohet nëpër shumë organizata, por nuk është ardhur në një përfundim a zgjidhje të duhur. Në këtë kanë ndikuar shumë faktorë, të cilët janë të një karakteri objektiv.

Në mbledhjen e fundit me karakter të zgjëruar të cilën mbajti e Kryesia republikane e LRM në Ohër, problemi për kryetarët e konferencave komunale të LRM dhe vendin e tyre si të paguar u kërkua që të vihet prap në rend të ditës. Nga çka u nisën në kërkesë disa anëtarët të Kryesisë? Për këtë, me të vërtetë duhet të bëhet një analizë më e gjërë.

Karakteri i veprimtarisë së organizatës së rinisë si organizatë politiko-shoqërore, me specifitetin e vet ka një platformë më të gjërë nga ajo, para riorganizimit. Organizata e rinisë në kushtet bashkëkohore, në pjesëmarrjen e saj në realizimin e detyrave të saja politiko-shoqërore dhe ekonomike, kohëve të fundit, me veprimtarinë e saj është duke e hum bur detyrën kryesore, punën në bazë, në aktivet shkollore, të fshatit e tj. Ajo nuk është si ka qenë. Baza e cila gjithmonë ka qenë preokupim i pa ndashëm, është duke e humbur atë që e ka për nevojë. Problemet në bazë nuk janë probleme të cilat traj tohen dhe e gjejnë vendin e vet në organet më të larta, të komunës e të Republikës. Kështu, në shumë ko mune u shkëput lidhja e organizatave komunale me ato të bazës. Kjo erdhi nga shkaku se të gjitha ata për udhëheqës të tyre u orientuan që të angazhojnë joprofesionalistë, vullnetarë. Kjo gjë nuk mundi të japë atë që duhet të arrihet në organizatë.

Propozimet të cilat u dhanë në mbledhjen e cila u mbajtë në Ohër, shpienin nga ajo, që çështja e funkcionarëve profesional në krye të Konferencave komunale të vihet në rend të ditës. Me zgjidhjen e këtij problemi a do të zgjidhen problemet e rinisë, me të vërtetë nuk mund të jepet përgjegje.

E. SH.

STANDARDI I TE RINJVE SOT

SECILI MERR SIPAS TE ARDHURAVE TE PRINDEVE

Muajve të fundit, forumet tona më të larta shoqëroro-politike i analizuan problemet e të rinjëve te ne, vlerësuan situatën momentale shoqërore të gjeneratave të reja në kuadrin e situatës momentale politike dhe shoqërore në vend.

Mirëpo, siç duket çështja kompleksive e standardit të të rinjve nuk është analizuar siç duhet. Gjendja ekonomike e të rinjve, marrëdhënjet që kanë karakter vital në lidhje me diferencimin social, janë çështje shume delikate. Mirëpo (mu për këte arësye) do të jetë tepër e nevojshme që edhe siperfaqësisht të analizohet një situatë e këtillë.

Problemi siç theksuam, është shu më kompleksiv. Secili riorientim i rëndomtë dhe i paargumentuar lidhur me çështjet e lartëpërmendura mund të sjellë pasoja të këqija politike, sepse ky problem është shu më delikat. Ky është shkaku, që më shtyri këte çështje ta shqyrtoj bashkë me të rinjtë, më afërsisht. Nga biseda me ta, nënkuptohet duke i respektuar dëshirat dhe problemet e tyre prozoike-ideale, por me rezerve, për disa qëllime të cilat sipas mendimit tim janë rezultat i pregaditjeve të pamjaftueshme ideo-politike të tyre.

Të rinjtë tanë, zakonisht gjatë kohës se shkollimit — prej shkollimit fillor e gjer te shkollimi me i lartë ,nuk fitojnë sa duhet për jetën e tyre. Kjo më tepër vlen për ata nxënës dhe studentë, për të cilët nuk ekzistojnë mundësi për t'u inkuadruar. Studentet e provincës të shumtën marrin kredi ose burse, ndërsa më rrallë edhe ate gjatë sezonës së pushimeve ose rregullisht janë të inkuadruar. Mirëpo, më se e ditur është se asnjë student nuk mund ta kryeje studimin, nëse kredinë ose bursën e ka të vetmin burim për eksiztencë. Do të thotë, se buxheti i prindëve të shumtën e herëve është burim i sigurimit material të të rinjve — studen tëve nxënësve.

Edhepse çështja e standardit të rinisë puntore — prodhuesve, do të jetë lëndë për shqyrtim të posaçëm, tani d ot'iu prezentohen të rinjt, duke na i treguar mundësitë e ytre materiale.

Fillojmë me pyetjen themelore: si janë mundesitë materiale të një të riu të sotëm te ne?

Fehmi Komolli, gjimnazist, thotë se ne muaj i shpenzon nga 2—3 mijë dinarë të vjetër. edhe ate pse është fëmija më i madh i prindërve te tyre. Pos tjerash, ai tregon se në familjen e tij janë gjashtë anëtarë, të cilët presin prej rrogave të prindërve të tyre, të cilat së bashku bëjnë afro 250 mijë dinarë, ndersa prej kësaj shume 20 mijë dinarë për çdo muaj i ndajne për taimet komunale, dhjetë mijë dinarë të vjetër për fëmijët dhe të tjerat për furnizimin e familjes. Sipas kësaj Fehmiu as qe mund të shpenzoje më shumë.

Stojanka Risteva, barnatoriste e re në barnatoren „1 Maj". Ajo sigurisht nuk merr të holla nga prindërit e saj, por përkundrazi, u jep nga dyzet — pesëdhjetë mijë dinarë në muaj, përshkak se babai është punotor në N. N. „Mavrovo" me të ardhura mujore minimale, nëna është nikoqire, ndërsa për tri fë-

Portreti i nje te riu

Osman Gashi-inxhinjer i diplomuar i xehtarise

Këto ditë, në Prishtinë, u takuam me djaloshin modest dhe të sjellshëm Osman Gashin, nga fshati Dobërdol, i cili gjendet nja tetë kilometra në veri të komunës së Podujevës.

Osmani lindi më 1945 në një familje të varfur fshatare.

Për zgjuarinë dhe zellin e tij për punë dij qysh në fëmijni — nga shkolla fillore, kur isha bashkë me të.

Me që nuk e kisha parë për një kohë të gjatë, prania e tij këto ditë në kryeqendrën e Kosovës më gëzon shumë.

U takova me Osmanin rastësisht.

— Isha në fakultetin ekonomik të Prishtinës — më tha ai — dhe dua të regjistrohem në të. U habita me këto fjalë të tij, kur dija se ky djalosh gjer më tani ishte duke studjuar pranë Fakultetit të xehtarisë në Tuzë.

— Pse në Fakultetin ekonomik? . . . e pyeta me befasi.

— Sepse. para tre muajve diplomova pranë Fakultetit të xehtarisë në Tuzëll, kurse qe katër muaj jam në marrëdhënje pune, por kohën e lirë nuk mund ta kalojë kot — më tha ai — e dua të studjojë privatisht ekonominë.

Aty për aty më lindi ideja që të shkruaj për të.

— Të lutem — më tha Osmani — të kam shok të shkollës, andaj nuk kisha dashur që të shkruash për mua.

Pas disa orvatjesh kundërshtimi, mezi pranoj ky djalosh i thjeshtë nga pamja, por fort i dashur dhe

lëshova . . .

— Pastaj?! — e pyeta.

— Pas një muaji e sa pauze, vazhdova të njëjtin fakultet në Tuzëll.

Shkova atje, meqë kishte më shumë studentë nga Kosova, gjë kjo e cila më dukej si ndihmesë në një ambient dhe reth të rinj shoqëror.

— Ç'të shtyri ta zgjedhish mu këtë shkollë të mesme dhe fakultet? — e pyeta.

— Qysh në fillore i adhuroja lëndët, të cilat bënin fjalë mbi pasuritë natyrore dhe zbulimin e tyre.

Osman Gashi, Ing. i diplomuar i xehtarisë — para muajsh pranë Fakultetit të xehtarisë në Tuzëll, i kreu të gjitha provimet në afatin rekord. Qe studenti i katërt për nga suksesi në gjeneratën e tij.

Poashtu është Inxhinjeri i dytë shqiptar që diplomoi gjer më tani pranë fakultetit në Tuzëll. — Para nja dy viteve diplomoi Hasan Bala, nga Peja, i pari shqiptar pranë këtij fakulteti — tha [illegible]gani.

Bisede me kryetarin e KK R se Gjakoves, shokun Afrim Deva:

Rinia e komunes sone problemet ka per t'i zgjuar ne saje te punes dhe

ngazhimit te vet sa me te madh...

KKLR së qytetit të Gjakovës numëron më se 12000 anëtarë. Cilat janë problemet e saja, si është jeta kulturo zbavitëse, sa është e inkuadruar në organet vetqeverisese, cilat janë rezultatet e punës së saj gjer më tani, planet për të ardhmen e KKLR, lidhur me këto, biseduam me shokun Afrim Deva, kryetar i KKLR.

Që në fillim të bisedes sonë, shoku Afrim, a mund t'na thoni se sa është e inkuadruar në organet vetqeverisë se rinia e sotme e Komunës?

Mendoj se paralel me arësimimin e brezit të ri dhe me kualifikimin e tij i riu i ditëve të sotme nuk është i inkuadruar aq sa duhet në organet vetqeverisëse e kjo jo nga se i riu ynë i shmanget përgjegjisive të ndryshme, por nga fakti se me rininë nuk është duke u punuar aq sa duhet. Megjithëkëtë dita më më ditë të rinjtë janë duke u inkuadruar në organet vetqeverisëse dhe kjo në për masa të gjera dhe në dimensione shu më më të mëdha se gjer më tani. E ky inkuadrim është duke e justifikuar nisiativën, të rinjtë janë aktivis të dhe me pedantëri e kryejnë dety rën dhe rolin e tyre në organet e vetqeverisjes. Kjo ka ndikuar gjer dikund që kohëve të fundit të rinjtë të tjenë pjesëtarë të këshillave të ndryshme...

Aksioni »Drini i bardhë — bregde ti vonë mori fund. Sipas jush cilat janë sukcese[illegible] këtij aksioni dhe e ka pë[illegible] sërish viteve të tjera?

N[illegible]ndët, rinia ka [illegible]rinin që i është dhënë dhe këtë e ka treguar me punë të vetmohueshme. Aty, në aksion, është bërë një punë e mirë e plus kësaj rinia është ngritur në mënyrë ideore, ka fituar shprehi pune dhe janë njohur mes vetë. Në të ardhmen e kemi ndërmend që sërish të organizojmë brigada vullnetarësh të të rinjve të cilët kanë për të pu nuar në gjelbrime të ndryshme. E se sa ka pasur sukses nisiativa ynë tregon fakti se vitin e ardhëm në Kosovë ka për t'u ndërmarrë një aksion tjetër krahinor. Të rinjtë e Krahinës janë fyrmëzuar nga rinia e Komunës sonë e cila e para ndërmori një gjë të tillë.

Rinia punëtore e Komunës në ç'gjendje gjendet dhe a ka nga të rinjtë punëtorë që presin të inkuadro hen anise i kanë kualifikimet përka tëse? Dhe cila profile të profesioneve që kanë punëtorët nuk po gjejnë vend pune?

Me përjashtim të fabrikës së kon feksionit dhe trikotazhit »Napredak« gadi në të gjitha kolektivet tjera pu nuese gjendja nuk qëndron mirë. Kolektivet stipendojnë nxënës kurse kur ata i kyejnë shkollimet ngelin pa punë, ndonëse pos »Napredakut« asnjera ndërmarrje nuk i pranon të gjithë ata për të cilët ka shpenzuar. Nga kjo dukuri më së shumti po pësojnë ata nxënës të rinj të cilët kanë të kryer shkollën e mesme eko nomike dhe ata që kanë kryer shkollen e nxënësve në ekonomi. Vertetë, shiheshin shumë të rinj të shetit nin kot, por kjo skenë e pamirë, tanimë, sikur ka filluar të zhduket pak ngase një numë të madh të rinjsh i ka inkuadruar në gjiun e vet Kombinati i pambukut »Emin Dura ku« dhe 500 sish janë duke u specializuar në Gjakovë, Nish dhe në Ita li për fabrikën e re të elektromotora ve e që është repart i »Ei« të Nishit. Megjithëkëtë akoma ka nga ata që presin për t'u inkuadruar...

Tani, shoku Afrim na thoni diç lidhur me jetën kulturo-zbavitëse të rinjve gjakovarë — ku dhe si e ka lojnë kohën?

Para së gjithash, ma merr mendja se të rinjt shumë pak stimulohen moralisht dhe materialisht. Kur them këtë, kam parasysh preokupimet e tyre. Në qytetin e Gjakovës ek ziston vetëm një kinosallë dhe Shtëpia e teatrit amator ku herë-herë çfaqen drama të rralla dhe filma, por që adhuruesit e artit të shtatë nuk munden t'u përballojnë kushteve të këqija në të cilat zhvillohet pu na. Kinomaja e vetme e qytetit nuk gjason në kinema të ditëve tona: verës bën vapë e padurueshme, kur se dimrit të ftohtë. Biblioteka e vet me e qytetit sikur është strukur në një kënd të lulishtes dhe qëndron si e »tkurrur«, në një lokal fare të papërshtatshem. Klubi letrar i qytetit dhe gazeta e Grupit letrar të Shko llës së lartë pedagogjike thuase kanë rënë në gjumë »dimror«. Rinia, shkurt, nuk ka se nga ta kalojë kohën e lirë. Për çudi, një qytet siç është Gjakova prej më se 30000 bano rësh, nuk ka akoma një lokal, për rininë e vet. Të riut gjer më tani nuk i ka mbetur tjetër vend dëfrimi pos në hotel dhe kafene të ndryshme të cilat janë shumuar si kërpurdha pas shiut. Por, edhe këtë çështje KKLR e ka shikuar në mënyrë serioze, pran dë në mbledhjen e parë që kemi për ta mbajtur së shpejti, kemi për ta aprovuar statusin e Universitetit të rinisë së qytetit ku mendoj se talen tët e rinj kanë për të treguar aftësi të e veta. Mbajmë shpresë që edhe Shtëpia e kulturës ka për t'u ndërtuar dhe edhe ky problem ka për t'u zgjidhur. Megjithëkëtë, në këtë drejtim kemi ndërmarrë një hap i cili, mendoj se, vlen të përmendet: në bashkunim me profesorët e eduka tës fizike të shkollave dhe në marrëveshje me Kombinatin bujqësor »Erenik« të Gjakovës, një numër i madh të rinjsh kanë për të punuar në vjelljen e rrushit. Nga ky aksion kemi për t'marrë ca të holla bukur të mëdha të cilat mendojmë t'i shfry tëzojmë për mëkambjen e Shoqërisë malore të qytetit. Nga kjo, mund të them, në fund, se rinia e Komunës sonë problemet të shumtën e rasteve i zgjedh në saje të punës dhe të angazhimit të vet sa më të madh. Këtë e ilustrojnë faktet dhe puna e të rinj ve në aksionin »Drini i Bardhë — bregdeti ynë«, formimi i Universite ti të të rinjve, puna në »Erenik« etj...; — na tha në fund të bisedës shoku Afrim Deva, kryetar i KKLR së Gjakovës.

Mehmet BOBI

i afërtë për çdokend.

Sot kemi shumë njerëz shkollarë edhe nga radhët e shqiptarëve.

Kuptohet, për të gjithë as që mund të shkruhet. Por, për Osman Gashin, është nevojshme të shkruhet. Ky djalosh me flokë kaçurrela, që e shihni edhe në fotografi, në shikimin e parë nuk të mbushë mendjen se ka kryer ndonjë shkollë të mesme, e lene më fakultetin, edhe atë njërin nga ata të vështirët.

Por, mu kjo bën që Osmani të jetë i dashur nga bashkëvendasit e tij dhe të gjithë shokët.

— Vetëm me punë mund të realizohen ambicjet e njeriut në jetë — tha ai.

— Ç'shkollë të mesme keni kryer?

— Pasi pata kryer shkollën fillo re pranë asaj „Momçillo Popoviq" në fshatin Kërpimeh duke kaluar nga më se 10 kilometra në ditë në relacionin shtëpi — shkollë dhe anasjelltas, më 1960 u regjistrova në Shkollën e mesme të xehtarisë në Mitrovicë të Kosovës, të cilën e pata kryer shkëlqyeshëm.

Pasi nuk qëndroja mirë ekonomikisht në familje, u detyrova të inkuadrohem në punë. Punova nja dy vjet pranë Minjerës në Novo Bërdë. Pasi punonte edhe vëllau i madh në arësim, së bashku ndikuam bukur mirë në përmirsimin e standardit jetësor në familje.

Në vitin shkollor 1966/67 vendosa të vazhdojë studimet. Pasi u regjistrova në Fakultetin e xehtarisë në Beograd dhe vijova mësimet nja një muaj, më pat vdekur nëna. Kjo punë ra dhe më nxori nga takti. Më humbi zelli për mësim dhe e — Une jam bere „Lebep" e pas një viti studimesh erdhën edhe disa të rinj nga Llapi. Tani aty mësojnë nga 20 sish.

Myhredin Ajvazi, Adullah Bekteshi dhe Latif Shaipi, madje janë në prak të diplomimit. Përveç kësaj këta tre studentë janë të daliuar. Që të tre janë nga fshatrat e ndryshme të Llapit — përfundoi Osmani.

Siç muarëm vesh nga inxhinjeri ri, Latif Shaipit i kanë thënë në fakultet qysh tani, se kur të diplomojë është i nevojshëm të mbetet si asistent aty.

— Ku po punon? — e pyeta.

— Jam inkuadruar para katër muajsh pranë Repartit të Bashkësisë së thëngjillit në Obiliq.

Nga kjo bashkësi kam marrë bur sën, andaj do tia kthejë borsin me nderë — tha Osmani.

— A ke ndonjë preokupim apo dëshirë momentale?

— Që të sigurohet një banesë shoqërore, pasi që jam duke banuar në një private dhe jo të përshtatshme — në Prishtinë.

— Synimet tuaja të mëtejshme?

— Përpos që do të studjoj me korespondecë ekonominë pranë Fakultetit ekonomik në Prishtinë, shpresoj se pas një apo dy viteve, Këshilli i punëtorëve të Bashkësisë së thëngjillit në Obiliq do të më bëjë të mundshme të vazhdoj shka llën e tretë të studimeve.

Kjo është dëshire e imja e flakët — tha Osmani modest.

U ndava me zemër krenare — mal nga qy inxhinjer i ri shqiptar.

Aq më kënaqësi ndjeva, meqë është nga treva ime — Llapi.

Jakup ÇITAKU

mijet tjera, rroga e babait nuk i arrin as për shkollimin e tyre, në se nuk e ndihmon edhe ajo buxhetin familjar. Shumën tjetër, rreth shtatëdhjetë mijë dinarë (e cila shu më ngadonjëherë zvogëlohet në pesë-gjashtedhjetë mijë dinarë) e kom penzon — për martesë. Vetë pranoi se për shteti të lira me djaloshin e saj nuk shpenzon më shumë se pesë-gjashtë mijë dinarë në muaj, ndërsa më tepër shpenzon për ta pasuruar garderobën.

Ferit Musaj, student i medicinës, tregon se prej prindërve të tij, të cilët janë punëtorë fizikë, në fillim të muajit merr nga pesë-gjashtë mijë dinarë.

Për atë, këto të holla janë shumë pak. Atij i nevojten më tepër. Të shumtën e herave nuk i shpenzon edhe ato të holla. Më vonë me shumën e kompenzuar furnizohet me ndonjë veshmbathje të vogël si: këpucë, çorape ose ndonjë këmishë etj.

Afërdita Mula, nxënëse, prindërit e të cilës janë të inkuadruar në arësim me të ardhura mujore rreth katërqindmijë dinarë dhe për vajzën e tyre të vetme për çdo muaj ndajnë nga njëzetmijë dinarë. Afërdita nuk e llogarit se kjo është një shumë e madhe, edhepse mund të kalojë edhe me më pak.

Nga shqyrtimi i sipërm mund të konstatojmë se ekzistojnë ndryshime të mëdha në gjendjen ekono mike të të rinjve tanë. E qartë është se nuk mund të kenë të gjithë të njejtin standard, siç nuk është i njejtë edhe i prindërve, me të ardhura të ndryshme mujore.

N. SPAHIU

Me te miret ne vitin 1971

Gazeta britanike për muzikë »Me lodi mejker« për çdo vjet në këtë kohë e publikon rang — listën e më të mirëve në pop — muzikë. Me këtë rast rangohen më të mirët në Britani dhe më të mirët në botë.

Ne do t'i cekim vetëm fituesit.

Për këngëtar më të mirë në Britani është shpallur Rod Stjuard. Për më të mirin në botë — Nil Jang.

Në konkurencën për femra fituan Sendi Deni (më e mira në Britani) dhe Hhoni Miçel (më e mira në konkurencën ndërkombëtare).



Për bandë më të mirë muzikorë u shpall »Krozbi, Stil, Nesh dhe Jang«, për instrumentalist më të mirë Erik Klepton, për zbulime të vitit bandat muzikore »Mountain« dhe »Osibisa«.

Në fund, për disqe më të mira në vitin 1971 u shpallën nga albumet »Pas etheve të arta« të Nil Jang-ut, kurse nga singël-disqet »Zoti im i dashur« i Xhorxh Harison-it.

Krusivi yne

Deri kur gjimnazi pa drejtor?

Vajt, viti i kaluar shkollor e tani filloi i riu, e në gjimnazin „Zef Luush Marku" të Shkupit (në normalen e dikurshme) nuk u zgjodh ende drejtori i ri edhe përkundër dy konkurseve të shpalliura, me që në fillim të vitit të kaluar shkollor nga posti i drejtorit u largua profesori dhe drejtori shumëvjeçar i këtij institucioni arësimor, shoku Qemajl Musliu, të cilit për punën që kreu iu shpreh mirënjohja nga faktorët arësimor të qytetit dhe nga vetë profesorët dhe arësimtarët e këtij gjimnazi.

Pas një vizite të rastit që i bëmë gjimnazit „Zef Lush Marku" të Shkupit, atë ditë kur pat filluar viti shkollor, në koridor e takova ush truesin e detyrës së drejtorit Rexhep Bajramin, i cili për shkak të punëve të shumta që kishte mozi pranoi që të më japë ca shënime të shkurtëra, duke u arësyetuar se kishte bukur punë dhe se ishte i zënë shumë me pregatitjet lidhur me fillimin e vitit shkollor. Pas marrjes së shënimeve e pyeta edhe si qendron çështja zgjedhjes së drejtorit të këtij gjimnazi, ku u mbush një vit i tërë e shkolla është ende pa drejtor. Ai na tha se janë shpallur dy konkurse gjatë vitit të kaluar shkollor, por edhe përkundër kandidatëve që kishin konkuruar për këte post të zbrazët — kolektivi nuk ishte në gjendje që ta zgjedhë ate për arësye se ishte i ndarë në dy grupe që assesi nuk pajtoheshin që ndonjeri prej kandidatëve që kishin konkuruar (e ka pasur edhe nga gjiri i këtij kolektivi) ta zejë këtë post. Çka është edhe më e çuditshme të gjithë kandidatët që konkuruan i plotësonin kushtet e konkursit, por profesorët e arësimtarët nuk u dakorduan për asnjërin prej këtyre kandidatëve që konkuruan në dy konkurset e para. Këto ditë është formuar komisioni i tretë që të shpallë konkursin tjetër, por-droj, thotë ushtruesi i detyrës së drejtorit se në se edhe kësaj here nuk intervonojnë kompetentët e arësimit të Kuvendit të qytetit të Shkupit — sërish ky institucion arësimor do të mbetët pa drejtor. E një institucion shkollor, siç është gjimnazi „Zef Lush Marku" i Shkupit që është e vetmja shkollë, e plotë, e shkallës së dytë në gjuhën shqipe të mbetet edhe sivjet pa drejtor, është një lëshim i madh dhe një mëkat që nuk falet, pasi siç po flitet nëpër kuloare, se kjo vatër arësimore me shkuarjen e drejtorit, ka zënë të marrë teposhtëzën dhe se duhet që dikush në këte rast të intervenojë që t'ia kthejë renomenë e dikurshme që e kishte normalja.

Nuk duhet të lejohet që profesorët dhe arësimtarët të ndarë në dy fronte të pengojnë që këtë post ta zejë dikush që patjetër (sidomos) tani pas gjendjes së pamirë, të krijuar në këtë gjimnaz, që është mjaft i rëndësishëm i domosdosshëm nëse nuk duam që edhe sivjet të përsëriten mosuksesi i vitit të kaluar shkollor, kur u deklarua se gjimnazi „Zef Lush Marku" ishte ndër shkollat më të dobëta të mesme të qytetit të Shkupit.

Duhet të shpresojmë se nuk do të përsëriten „faktet" e dy konkurseve të mëparshme edhe këte të tretin, se tanimë është kohë e fundit që në gjimnazin „Zef Lush Marku" të plotësohet ky vend pune, dhe veprimtaria e shkollës të marrë kahjen e së mbarës.

Të presim se çdo të bëhet në konkursin e tretë, që do të shpallet këto ditë të cilin shpresojmë se do të paraqiten mjaft kandidatë.

SHKUPI 71 — MANIFESTIM GRANDIOZ

— Do të ekzekutohen 24 melodi në dy interpretime. — Janë angazhuar këngëtarët, kompozitorët dhe aranzherët më njohur maqedonas e jugosllavë. — Në pauzën e finales shou i grupit »Mango xheri. — Marrin pjesë 9 debytantë

Më datën 11, 12 e 13 nëndor, do të mbahet Festivali i katërt me radhë i muzikës zbavitëse në trollin e Maqedonisë — **Shkupi 71.** Ky manifestim (më i madhi kësodore në Republikë), kësaj radhe karakterizohet me ambicjet e mëdha në popullarizimin e melosit maqedonas, si dhe me aspiratat drejt një hovi sa më të madh të kulturës maqedonase.

Në terminin që u përmend më lart, në Sallën univerzale të Shkupit, do të mblidhen interpretuesit më eminentë të muzikës zbavitëse nga Republika dhe nga mbarë vendi. Në mesin e tyre gjinden 39 solistë voka lë dhe 10 ansamble vokale e volake-instrumentale, që do të shoqërojë Orkestra e madhe e festivalit, që — në këtë mënyrë — të marrin pjesë në garat për tri meloditë më të suksesshme të këtij festivali.

Siç na tha drejtori i Festivalit, **Gjoko Georgiev,** me qëllim që të bëhet i mundshëm një depërtim dhe një plasman sa më i mirë i muzikës zbavitëse të Maqedonisë në mbarë vendin tonë, pastaj që solistëve — mysafirë t'u lehtësohet interpretimi, ndërsa edhe festivali në përgjithësi të bëhet më i afërm për auditoriumin e gjërë jugosllav, sivjet, për herë të parë, është bërë një ndryshim i madh: të gjithë mysafirët — interpretues do të këndojnë në gjuhën e tyre amëtare, njërin verzion të të 24 melodive të zgjedhura. Verzioni tjetër të cilin e interpretojnë këngëtarët nga RS e Maqedonisë, do të jetë në gjuhën maqedone.

Meriton të përshëndetet tendenca e festivalit të sivjemë që të angazhojë, sa më tepër që të jetë e mundur, këngëtarë të rinj që marrin pjesë për herë të parë në festival. Zatën, sipas mendimit tim, një rrugë të tillë do të duhej ta ndiqnin të gjitha festivalet kësodore ngase, festivalit, ata jo vetëm që i japin risi, por në mesin e tyre mund të gjenden këngëtarë që në të ardhmen, do t'i kontribuojnë shumë krijimtarisë në këtë lëmë. Përndryshe, muzika zbavitëse karakterizohet me një dinamizëm të rrallë dhe kërkon risi në çdo hap. Ndoshta qëllimi i festivaleve do të duhej të ishte, pos melodive të reja në të cilat pasqyrohet melosi i një treve të caktuar, edhe lansimi i këngëtarëve të rinj.

Nga ana tjetër, në këtë manifestim grandioz që do të zgjasë tri netë, në të cilin 24 meloditë e zgjedhura nga ana e Komisionit të festivalit SHKUPI 71 do të këndohen në dy verzione, do të marrë pjesë, si u tha më lart, elita e këngëtarëve të muzikës zbavitëse nga Maqedonia dhe nga mbarë Jugosllavia. Ata që nuk do të jenë të pranishëm me këtë rast, mund të njehësohen në gishta: Vice Vukov, Tereza Kesovija, Gabi Novak, Misho Kovaç, Nada Knezheviq... Edhe ata janë ftuar të marrin pjesë në festival, mirëpo ngase kanë lidhur aranzhmane, të cilat për puthen me kohën kur mbahet festivali, apo për arësye të tjera, nuk janë në gjendje të bashkëpunojnë kësaj radhe. Por, mungesa e tyre, s'do të ndjehet aq tepër, pasi këtu janë Arseni, Kruno, Josipa, Boba, »Ata e ato«, »4M« Zoran Georgiev, Lupka, Radojka, Shverko, Korni Grupa, Daniella Pancetoviq, Nina Spirova, Dragan Mijalkovski, »Pro Arte«, Hërvoje Hegedushiq...

Me orkestrën e madhe të festivalit, do të dirigjojnë, gjithashtu, dy mysafirë dhe dy dirigjentë nikoqirë. Gjer më tani, për këtë punë janë pa raparë Dragan Gjakonovski, Milenko Prohaska dhe Aleksandar Xhambazov. Së shpejti do të dihet edhe diri gjenti i katërt.

Duhet përmendur se janë bërë bi sedime me pop-grupin e njohur botë ror »Mango xheri«. Ky grup duhet të marrë pjesë me një shou të vetin në pushimin midis dy pjesëve të programit ,natën kur mbahet finalja e festivalit. Do të jetë ky një atrakcion i mirë dhe festivalit do t'i japë një notë edhe më solemne.

Më në fund, të themi, se, sipas të gjitha gjasave, ky festival është duke u organizuar për bukuri; T'u urojmë sukses në punën e tyre të gjithë pjesëmarësve dhe organizatorëve!

Jusuf GËRVALLA



Mexhit Osmani »Olio«

Takime te paharrueshme

Çdo krahine duhet t'i kete krijuesit e vet

Takimi me kompozitorin e mirë njohur shqiptar **Tonin Rrotën**, me rastin e vizitës që i bënë nxënësit e Shkollës së arësimit të përgjithshëm të Peshkopisë dhe anëtarë të Estradës profesioniste të këtij qyteti të Shqipërisë Gjimnazit „Zdravko Çoçkovski" të Dibrës, më rri parasysh dhe më ka mbetur i paharrue shëm. Modestia e këtij kompozitori gjatë bisedës spontane që bënin mbi zhvillimin e artit muzikor shqiptar, si sot më kujtohet. Ky kompozitor shqiptar është autor i një sërë veprash muzikore të llojeve të ndryshme.

— Në ç'vend punoni? — e pyetëm shokun Tonin.

— Ka dhjetë vjet që gjindem në Peshkopi. Gjatë këtyre dhjetë vjetëve vazhdimisht jam marrë dhe mi rrem me përpunimin e folklorit di bran. Ky folklor më duket se është shumë i pasur, i pastër dhe i freskët. Andaj, veprimtaria ime si kompozitor, tani për tani dosido mbështetet në motivet e Dibrës, pasi këtu jetoj. Përndryshe, më parë kam punuar edhe në vise të tjera të atdheut tonë.

Unë kam punuar dhe punoj suita, rapsodi, këngë të stilit popullor, këngë të përpunuara dhe të tjera. Për veprimtarinë që kam bërë unë, jam anëtar i Lidhjes së artistëve dhe shkrimtarëve të Shqipërisë dhe Lidhja më ka dekoruar **me urdhërin e punës „Naim Frashëri"**, për aktivitet, krijimtari të mirë dhe të palodhur. Ndër punimet e mija mund të përmend: **„Suita vokale numër 1", „Rapsodi dibrane për kor dhe orkestar"**, këngët **„Hej. more hej!" „Jepma mollën", „Hiqe mollën", „Ve tull kunora", „O bjeshkë ndëgjoni"** e tj. Të gjitha këto, kam përshtypjen se janë pritur mjaft mirë nga publiku.

— Dicka për krijimtarinë muzikore shqiptare dhe për krijuesit e saj?

— Krijimtaria muzikore shqiptare është në një nivel mjaft të lartë artistik dhe shkon krahas me zhvillimin e të gjitha arteve tjera të na. Kemi një numër shumë të madh ve prash të njohura në këtë drejtim, të cilat janë në gjendje kurdoherë ta prezentojnë begatinë muzikore të shqiptarëve. Kompozitorët tanë janë punëtorë të palodhshëm të artit dhe çdo herë sjellin freski në të dhe krijojnë vepra të reja. Unë mund t'i përmend disa emra kompozitrësh që meritojnë respekt të posaçëm si bile fjala **Tish Daia, Çesk Zadeja, Tonin Harapi, Limoz Dizdari, Nikolla Zaraqi, Pjetër Gaçi,, Risto Kono e tj.** Këta janë vetëm disa emra që i shërbejnë me përkushtim zhvillimit të muzikës sonë. Përndryshe, ka edhe shumë të tjerë që janë të njohur e që kesaj radhe nuk ua përmendëm emrin.

Ajo që është më kryesore, kontribut i kompozitorëve tanë në lëmi në e zhvillimit të muzikës është mjaft i madh dhe në fushën e saj për çdo ditë po dalin edhe talentë të rinj, të cilët po zgjojnë interesim të posaçëm. Ndërkaq, unë jam i mendimit se çdo krahinë apo rreth, duhet të ketë kompozitorët, muziktarët, solitët, ansamblet, orkes trën, motivet e veta, sikundër që duhet t'i ketë edhe krijuesit tjerë të artit. **Mos të bëhet buka me miellin e huaj,** por çdo krahinë t'i ketë talentët e vet, krijuesit e vet, pra edhe kompozitorët e vët. Po, sepse çdo krahinë ka edhe begatit e veta, si bie fjala edhe folklorin e vet, të cilin duhet të ketë kush ta përpunojë, kush ta zhvillojë... Ai që ka jetuar dhe jeton në një krahinë, në një vend, ai që ka punuar dhe punon në një krahinë, ai më së miri do të jetë në gjendje ta njoh atë vend, ai më së miri do të di të këndojë, të krijojë për të. Andaj thash edhe më parë se çdo krahinë duhet t'i ketë krijuesit e vet, e në këtë mënyrë edhe masa do të jetë më e afërt me krijimet e tyre, më thellë do ta shijojë ëmbëlsinë e tyre... Te namasa është e mishëruar me gjithë atë që i kushtohet asaj, me krijimtarinë artistike të të gjitha llojeve. Ajo është vlerësuese e denjë e të mbërrimeve tona, thot kompozitori.

Ja, këto ishin disa nga fjalët e kompozitorit Tonin Rrota, i cili për kundër pushimit mjeksor për shka qe të shëndetit, asokohe gjindej së bashku me anëtarët e Estradës profesioniste të Peshkopisë në Dibër. Kishte ardhur së bashku me ta që ta përcjell punën e tyre njëkohësisht që ta vizitojë edhe vendin tonë. Përndryshe, pjesa më e madhe e repertorit të Estradës, ishin puni me të këtij kompozitori të palodhshëm, i cili duket se nuk kursen asgjë, vetëm e vetëm që t'i kontribuojë popullit të vet.

Përshtypje të këtillë fitova në takimin e parë më të, i cili më ka mbetur i paharrueshëm.

Mehmet EMËRLLAHU

Kenge per diellin e dashurise ne blerim

Zjarri, me zjarr fiket kur bie n'blerim,
Kënga, me këngë rritet, n'buzë t'agimit.
Unë diellit do t' ia ujisë rrezet e kallura!
Zallit, peshkun do t' ia vjedh nga goja —
Kur dielli t'shkojë n'takim me blerimin,
Blerimi s'do të vyshket prej zjarmie...

Bajonetat e ngulura n'rrasën e krahërorit —
E kanë ngjyrën e luledielllit n'mbrëmje.
Rrugët e ka zërë gjumi, nën gjurmat e harruara,
Endacakët i kan ngrehur çadrat e grisura n'harresë!
Blerimi është duke u stolisur, për takimin e parë,
Dhëndrri armatoset për dyluftim me vdekjen...

Nëse t'bie rruga, t'kalosh kah rruga pa emër,
Trikot në derën që e ka emrin e blerimit.
Unë, me thupra t'florinjta do të thuri kurorë,
Gjishtat do t'i gardhoj n'dritaret e shikimit,
Mos i trazoni dashnorët n'takimin e ditës,
Xhelozia e ka emrin e vdekjes n'lindje!

Kur ta takoni lulen pa emër e ngjyrë —
Kërkojani rrënjët në fushën e mbjellur me eshtra,
Mos u habitni për gjymtyrët pa tanësi —
Tanësia ka mbetur pa gjymtyrë prej dashurie!
Dielli kur është n'takim me blerimin,
Mëngjezet jan përherë t'praruara...

Vashat shterpa, lahem me premtimet e dashnorve,
Ç'do mbrëmje palohen me duvakun e kuq të ditës,
Nën freskinë e ujëvareve e shuajnë zjarrin n'krahëro
Mos u habitni, pse vasha vashës ia shtrydh gjijt.
Gishtat e ledhatimit kanë marrë erën e tokës,
Duart e cunguara e kan harruar përqafimin.

Nëse fytyrat e kanë ngjyrën e hekurit,
N'kërthizat e shtatzënave ndryshken plumbat!
Djepi i foshnjes është varur për zorrët e babës,
Tamblit, n'gjitë e shterura t'lehonave —
I vjen erë gjaku, e mish t'krimbur!
Ç'do bark nëne, lind një varr t'hapur.

Të djeshmes, sotit, au thur nga një këngë,
Ditën e nesërme, vallë si ia pagëzojnë?
Shtatë ditët e javës kanë mbetur pa emër,
Lindjet dhe vdekjet shënohen në ditët e vitit!
Dashuria e diellit n'blerimin e parë —
Do të mbetet legjendë e shekullit plot varre.

Kjo xhungëll e shpresave t'pa shteg — me shteg!?
Njeriut t'ngjyrosur ia rriti mjekrrën shtatë pëllëmbë,
Trupin e lakuriqsuar prej granatave n'eksplodim —
E mbulojnë me qimet e thinjura, të djegura n'flakë,
Këngën për dashurinë e diellit n'blerim —
E shkruaj kur njeriu është duke shetitur nëpër Hënë.

Kur t'kalosh rrugës me etje n'buzë —
Mos kërko n'qiell ré, që sjellin shi...
Strehoje shpirtin nën helmetin e kufomës së gjallë,
Ai qiell është i mbushur me »B — 52«
Dashuria e diellit n'blerimin e parë —
Është më e madhe se raketa »Tokë — qiell«

Bukën e mykur n'strajcën e dëshirave,
N'endërr e përtypin nofullat e drynuara t'fëmijëve.
Uria endet nëpër tytat e syve t'gozhduara.
Nëse kalon brijë sofrës t'pa shtruar —
Bën shartimin plastik t'lëkurave, që fjelnë mbi therra!
Mos u habitni për ndryshimin e formës së njeriut.

Unë e di se klithjet e mia në këte këngë,
E kan fatin t'vdesin në heshtje.
Por unë, përsëri e di, se heshtjet do të zgjohen...
Vëlla poet nga ato beteja —
Kënga e yte e shkruar me ngjyrë gjaku,
Diellit dhe blerimit do t'i thurë kurorë bashkimi.

Kjo mbrëmje që më çoi n'tokën që digjet,
Dhe kënga për kufomat që s'kanë varre!
Një minut heshtje, vdes me vdekjen —
Lahem me gjakun që rrjedh si rrëke.
Dashurinë e diellit n'blerimin e parë —
E ruajmë si legjendë, edhe këtu ndër ne.
Korrik — Shtator 1971.

Mustafa LAÇI

KUMANOVE

Arësimtarët — autostopere

Fshati Rramanli gjindet shtatë — tetë kilometra larg Kumanovës, në anën e djathtë të autostradës »Vëllazërim — bashkim«, në drejtim të Shkupit. Ky është një nga fshatrat më të mëdha të komunës. Në të ekziston shkollë e plotë tetëvjeçare.

Arësimtarët e shkollës fillore »Kirili dhe Metodi« të fshatit Rramanli, kanë hallet dhe problemet e tyre me të cilat ballafaqohon vite me radhë.

Të gjithë arësimtarët, drejtori dhe sekretari i kësaj, shkolle me përjashtim të vogël, janë nga Kumanova. Më se njëzet e pesë të këtillë, çdo ditë enden në relacionin Kumanovë — Rramanli dhe anasjell tas, secili i lënë të gjendet ashtu siç di dhe mundet që me kohë të arrijë në vendin e punës...

Dhe viti shkollor filloi. Dhe orëve të mëngjezit grupe të vogla ose më të mëdha arësimtarësh, duke i kopjuar autostoperët e shumtë, e ngrehin gishtin e tyre të madh, si shenjë lutjeje, para automjeteve që kalojnë në autostradë që t'i çojnë gjer në Rramanli. Ca nga ta janë fatmirë, kurse tjerët...

Por tani, gjer sa koha është e mirë, pa shira dhe baltë gjer në Rramanli mund të udhëtohet edhe me biçikleta, besa edhe në këmbë.

Fshati Rramanli gjindet pranë autostradës.

Para gjashtë muajve në të dy anët e rrugës magistrale ishin vendosur stacione për autobusat. Në to ekzistojnë edhe tabllo me orar për arritjen dhe nisjen e autobusave lokalë, por mallë është të shohish që ndojnë shofer të »gabojë« e të ndalet. Ndoshta shoferët edhe kanë të drejtë, sepse në këto stacione mundet të ndalen vetëm autobusat lokalë Kumanovë — Shkup dhe anasjelltas, kurse ata mbushen me udhë tarë për në Shkup, respektivisht për Kumanovë. Madje, edhe në vetë stacionin e autobusave në Kumanovë biletshitësit nuk japin bileta për këtë fshat.

Sifoqoftë, arësimtarët e shkollës së Rramanlisë edhe mëtutje mbeten të gjenden ashtu siç munden dhe dinë, dhe... shpresojnë. Por shpresa e tyre lirisht mund të krahasohet me vargun e» Kangës së Hasimës«: »Prit me ditë, prit me vjet pushka Lilës s'po kërset...«

Vetëvetiu shtrohet pyetja — pse janë caktuar stacionet në autostradë, kur në to kurrë nuk ndalen autobusat? Vërtetë nuk dihet se çfarë politike zbaton Ndërmarrja autotransportive »Jug — turist« nga Kumanova, që nuk lëshon autobusë lokalë për në Rramanli dhe Agino Sello, edhepse çmimet e transportimit i ka rritur »gjer në qiell«, për më se 200%.

Nga ana tjetër për këtë, problem, sigurisht, duhet të interesohen edhe faktorët arësimorë të komunës, sepse, arësimtarët e shkollës së Rramanlisë gjenden në një situatë të vështirë dhe u nevojitet edhe ndihma e faktorëve të tjerë, madje edhe vetë ndihma e bashkësisë lokale dhe organizatave shoqëroropolitike të fshatit që duhet të insistojnë të zgjidhet ky problem.

Arësimtarët Milaim Latifi, Etem Jashari, Isuf Isufi etj., thonë se janë të detyrar të gjejnë banesë në fshat, kurse të gjithë në qytet i kanë familjet e veta.

Kështu ata do t'u nënshtrohen shpenzimeve të mëdha. Për zgjedhjen e këtij problemi mundësi ka, por mungon inisiativa.

A. OSMANI



Kumanova

Struge: U ndane mjetet per shkollim

Kredi per te gj.the

Që të zbatohet një politikë e drejtë kadrovike, në ndarjen e mjeteve për shkollim të nxënësve dhe studentëve, Bashkësia themelore e arësimit të Strugës, me kohë bëri kërkesë pranë organizatave punuese të territorit të komunës së Strugës që të paraqesin për nevojat e tyre kadrovike. Për këtë arësye, gjatë ndarjes së kredive për shkollim, prioritet kishin profilet e nevojshme, për zhvillimin ekonomik të komunës së Strugës.

Mjetet e përgjithshme, me të cilat disponon Bashkësia themelore e arësimit të kësaj, sivjet kapin një shumë prej 256.000.000 dinarësh të vjetër.

Duhet të theksojmë se, në këtë vit, sikurse edhe më parë, BTHA e Strugës, ka bërë përpjekje të veçan të për të siguruar mjete më të mëdha që të bëjë të mundësishme, të marrë parasysh numrin e kërkesave të paraqitura.

Përpjekjet e këtilla të BTHA, mun dësuan që sivjet ajo të disponojë me një masë mjaft të madhe mjetesh dhe kështu, të mos refuzojë asnjë kërkesë.

Duke u bazuar në normativat republikane për ndarjen e kredive u lejohen kredi atyre, nota mesatare e të cilëve në klasën e fundit të shkollës së mesme, të jetë 3 (tre) dhe se të ardhurat personale për anëtarë të familjes, të mos e kalojnë masën prej 35-40.000 dinarësh; këto ditë Këshilli ekzekutiv i BTHA të Strugës, në mbledhjen e rregullt, i shqyrtoi kërkesat e paraqitura nga nxënësit dhe studentët dhe u ndau kredi të gjithëve që i plotësonin kushtet e konkursit. Kështu prej 122 kërkesave, pozitivisht u vlerësuan 97 (kërkesat e të gjithë kandidatëve që i plotësonin kushtet) të atilla, që bëjnë të mundshme të përfshihen kandidatë të çdo profili social: bujqë, punëtorë e të tjerë.

Prej kandidatëve të paraqitur afro 50% janë nxënës dhe studentë shqiptarë. Sivjet është karakteristikë se shumica e tyre janë orientuar nga fakultetet e shkencave natyrore dhe në medicinë, kurse më parë ata orientoheshin nga Akademia pedagogjike, fakulteti fillozofik juridik e të tjerë.

Në këtë mbledhje, Këshilli ekzekutiv i BTHA, vendosi të shpall konkurks për ndarjen e 19 bursave dhe të 20 ndihmave për kandidatë të interesuar për të studjuar në fakultetet e ndërtimtarisë, arqitekturës, elektromaqinerisë, tehnologjisë, medicinës e të tjerë..

Kreditë ndahen në një shumë prej 30-38.000 dinarë të vjetër, bursat prej 30-40.000 dinarë kurse ndihmat prej 15.000—20.000 dinarë të vjetër.

Neki HANI

KAÇANIK

Dy shkolla te me-sme pa konvikt

Në Kaçanik punojnë dy shkolla të mesme në të cilat mësojnë afro 600 nxënës. Nxënësit e këtyre dy shkollave kanë mjaft vështërsi nga se u mungon konvikti. Në mungesë të tij nxënësit e janë të detyruar që për çdo ditë të kalojnë nga disa dhjet kilometra rrugës në këmbë për të arritur në shkollë dhe anasjelltas. Udhëtimi i gjatë dhe për çdo ditë po e bën të veten, duke ushtruar ndikim në shëndetin e tyre dhe në mësim. Shumë nxënës të fshatrave më të largta të kësaj komune si dhe nxënësit e komuneve tjera, të cilët po mësojnë në gjimnaz ose në shkollën për kualifikimin e punëtorëve, duke mos mundur t'i përballojnë udhëtimit të gjatë, janë vendosur nëpër shtëpi private.

S'do mend se një gjë e këtillë do të ndikojë negativisht tek këta nxënës. Pra, duke u nisur nga kjo atëherë del se shkollat e mesme, njëherit edhe Kuvendi i komunës, duhet të angazhohen për zgjidhjen e këtij problemi, e ky do të zgjidhej me hapjen e një konvikti për nxënës. Nuk është problem vetëm fjetja e nxënsve, ata kanë mjaft probleme edhe për ushqim.

PËR NXËNËSIT E VARFËR LIBRA GRATIS

Shkolla fillore „Emin Duraku" në Kaçanik tani vjet me radhë i pajis me tekste shkollore nxënsit e varfër. Këtë traditë kjo shkollë nuk e ndërpreu edhe këtij viti shkollor. Të gjithë nxënësve të varfër i bleu tekstet shkollore. Këtë gjest të shkollës fillore „Emin Duraku" e përshëndetën nxënësit e kësaj shkolle dhe prindërit e tyre.

EDHE TRI SHKOLLA TË PLOTA FILLORE NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

Rrjeti shkollor në komunën e Kaçanikut për çdo vjet po vjen duke u zgjeruar, Gjatë vitit të kaluar shkollor në këtë komunë u hapën klasa të reja pranë shumë shkollave të kësaj komune.

Edhe gjatë këtij viti shkollor u bë zgjerimi i tyre. Pranë shkollës së fshatit Gllobočicë, Dubravë dhe Biçec, ku vitin e kaluar punoi klasa e shtatë, këto ditë filloi punën edhe klasa e tetë. Me fjalë të tjera, shkolla e Gllobočicës, Dubravës dhe Biçecit u shndërruan në shkolla të plota fillore. Një gjë e tillë i gëzoi pa masë nxënësit dhe nxënëset e fshatit Gllobočicë. Siç mësuam nga përgjegjësit e këtyre tri shkollave, mësimet po i vijojnë të gjithë nxënësit të cilët më parë kanë kryer klasën e shtatë.

Nazif HASANI

Nga pervoja ne aresim:

PËRPILIMI I ORARIT TË PUNËS

Në shkollat tona, në një masë bukur të madhe, i tërë suksesi varet nga shkoqitja e planprogramit dhe nga përpilimi i drejtë i orarit të mësimeve, që në fillim të vitit shkollor. Planprogramin arësimtarët mund ta bëjnë gjatë verës, i cili do të dalë i përsosur nëse ata punojnë me kujdes, por përpilimi i orarit të punës lypset bërë mu para fillimit të vitit shkollor, gjegjësisht pasi të sigurohet kuadri mësimor dhe të bëhet ndarja e lëndëve të mësimit, e klasëve dhe e kujdestarisë. Shpeshherë në shkollat tona nuk fillon mësimi i rregullt gjer vonë në shtator, mu për shkak të përpilimit të orarit të punës, e kjo është dobësi, në e parë, e drejtorisë së shkollës, pastaj e keshillit të arësimtarëve të klasave madje dhe e tërë bashkësisë punuese, sepse për përpilimin e orarit të punës angazhojnë vetëm një person, madje edhe pa përvojë të duhur në arësim. Në të vertetë, përpilimin e orarit të punës lypset besuar një grupi arësimtarësh të vjetër, respektivisht me përvojë në arësim, e kurrsesi vetëm një personit. Ngjan që gjatë përpilimit të orarit përfillet më shumë interesi personal i personalit mësimor dhe jo ai i nxënësve dhe i shkollës, madje dhe nuk respektohen kurrfarë normash pedagogjike. Kështu, fjala vjen në qendrat e mëdha ku japin mësim punëtorët arësimorë me honorarë, apo studentë, për t'jau rregulluar orarin, sipas qejfit të tyre, prishet i tërë rregulli në shkollë.

Zakonisht, përpilimi i orarit të punës në shkollat tona u besohet arësimtarëve të matematikës, të cilëve bukur shumë u mungojnë njohuritë e përgjithshme pedagogjike — nuk mendoj në lëndën e tyre, por në lëndët tjera, andaj mendoj se atyre duhet dhënë ndihmë edhe ca arësimtarë tjerë nga lëndët tjera dhe, kështu., grupisht të përpilohet orari i punës.

Gjersa punoja në Shkollën fillore »Vëllazërimi« në Cermjan, gjatë vitit shkollor 1958/59 në fillim të vitit shkollor, pasi nuk ranë në paj tim arësimtarët rreth përpilimit të orarit, u vendos që tetë arësimtarët bashkarisht të përpilojnë atë duke vënë kokrra misri, druri, fasuli, e gjëra tjera në hokat e shabllonit të vizatuar, i cili, përpilim ishte i papërshtatshëm, madje dhe nuk përkonte me normat pedagogjike, sepse ngjau që të grumbullohen shumë orë gjatë ditës, e kështu u abstrahua fuqia psiqike e fizike e nxënësve. Ditëve të hena dhe të shtuna u ngarkuan fëmijët me shumë orë dhe me lëndë të rënda. Pasi doli e paefekt kjo mënyrë e përpilimit të orarit, drejtori caktoi grupin prej tre arësimtarësh dhe, kështu, u përpilua orari me sukses, por kjo zhagitje e përpilimit të orarit iu kushtoi shumë nxënësve, nga se mbetën pa mësim të rregullt disa ditë. Një praktikë e tillë është zbatuar gjer vonë në disa shkolla tona, prandaj këtë lypset flakur si antipedagogjike. Pra orarin duhet ta përpilojë një grup i caktuar nga kolektivi punues apo nga drejtoria, i cili gjatë punës duhet të ketë parasysh këto komponente:

1) Kushtet specifike të shkollës në pikëpamje të kuadrit, lokalit dhe numrit të nxënësve,

2) Fondin e orëve të secilit arësimtar,

3) Cilat lëndë janë më të rënda për nxënës, respektivisht të gjendet koha gjegjëse kur lypset mbajtur orët nga këto lëndë,

4) Të mos grumbullohen gjatë një dite shumë orë mësimi nga lëndët prej të cilave jepen shumë detyra shtëpie apo bëhen hartime të shpeshta.

5) Mos të mbesë interval kohe shumë i gjatë midis orëve nga një lëndë, respektivisht mos të mbahet një orë të hënën e ora tjetër të shtunën.

6) Mos të mbahen dy orë ngjitur nga një lëndë në shkollën fillore, përpos nga lënda e artit figurativ dhe nga edukata e përgjithshme teknike.

7) Në rend të parë të përfillet interesi i nxënësve, pastaj i mirëvajtjes së punës në shkollë dhe, së fundit, të vijë interesi i vetë personalit të punës.

8) Duhet pasur kujdës që orari e përpiluar mos të përmbajë elemente jomodestie, e kështu të bëhet shkaktar i mosmarrëveshjeve midis arësimtarëve,

9) Që mos të ndërrohet shpesh orari i punës,

10) Lypset pasur kujdes në fuqinë psiqike asimilueke të nxënësve,

11) Nëse zhvillohet mësimi nëpër kabinete, mos të ngjajë që të mbesë ndonjë klasë pa pasur ku të mbajë mësimin,

12) Nëse ekzistojnë kabinetet ku lypset përdorë episkopi, diaskopi etj., duhet planifikuar që të bëhet shfrytëzimi si duhet.

13) Nëse shkolla ka televizor, të caktohet koha kur mund të shfrytëzohen emisionet shkollore,

14) Të caktohen kujdestarët e klasëve, duke u mbështetur në shumë rrethana, e jo vetëm në parimin që secili arësimtar duhet angazhuar me një klasë, sepse prej kujdestarit të klasës, me të madhe, varet edhe suksesi i tërë klasës.

Në grupin, i cili do të përpilojë orarin e punës, s'duhet të ketë ndikim askush, por ai duhet të respektojë dhe t'u përmbahet parimeve të cekura, kurse në anën tjetër të konsultohet me drejtorin, psikologun dhe zënvendësdrejtorin, në mënyrë që orari i punës të jetë sa më i përshtatshëm, si për nxënës ashtu edhe për arësimtarë. Duke u mbështetur në ketë që u tha dhe edhe në shumë parime tjera, të cilat ja imponon ambienti secilës shkollë, orari i punës duhet të jetë i gatshëm mu në ditën kur të fillojë viti shkollor.

Prof. Gjon BIBLEKAJ

Jozyrtarisht

Tirazhi, shija, shundi...

Titulli i këtij shënimi gazetaresk, premton shumë më tepër se sa mund të them unë, ta zëmë, për shijen. Bën, edhe për tirazhin. Shija i takon shqyrtimit të estetit, kurse tirazhi atij të sociologut, e unë nuk jam as njëri as tjetri. Mirëpo. nëse nuk keqkuptohemi, të them ashtu, jo zurtarisht, mua më duket se tirazhin, shumë gazeta tona, këtu në Jugosllavi, e arrijnë duke kultivuar shundin. Nuk e kam fjalën për gazetat zyrtare, ato më kryesoret, të cilat janë organe të Lidhjes socialiste. Aty, natyrisht, duhet të ketë, dhe ka kritere të posaçme, për të cilat këtu as nuk kemi ndërmend të bëjmë fjalë, as që do të ishte e nevojshme.

Fjala është për dhjeta e dhjeta gazeta të përkohëshme, më mirë revista të ilustruara, të cilat, duke e kultivuar këtë SHUND, sadopak e bastardhojnë edhe shijen e lexuesit. Ato e përvetësojnë lexuesin me gjëra të lehta e të pa farë domëthënjeje, për aq më tepër edhe me „senzacione" gazetareske, e trillime të tilla që, pos hutesës, nuk sjellin asgjëkafshë të dobishme. Mjafton të shikosh nëpër kiosqet e gazetave tona, gjithë ata tituj e gjithë ata ngjyrëra revistash të ilustruara, e të fitosh përshtypje se gjendesh në ndonjë vend të perendimit të egër, para ndonjë kiosku ku shiten »prodhimet pornografike«. Pornografia në gazetat tona është bërë modë e rëndomtë, madje aqë shumë na është bërë e rëndomtë, sa nuk i bie kujt ndërmend as të diskutojë qasur me këtë dokuri shu më negative, me këtë fenomen që dizorienton rininë, që ftoh dhe humb shijen ndaj të bukurit.

Ata që shënimin tim e lexojnë gjer këtu, do të ndahen prej tij me përshtypje se, unë, personalisht (thashë: jozyrtarisht), jam kundër shtypit të lirë, shtypit pa qenzurë, shtypit, t'i themi qytetar, shtypit joshtetëror, atij që nuk shkruan vetëm për „interesat" e qeverisë, do të mendojnë se jam kundër shtypit që, në „kontinuitetin" e tij, përmbledh qindra tituj. Përkundrazi, mua nuk me pëlqen fare (jozyrtarisht) ajo zgjidhje që kanë disa shtete socialiste (shumica prej tyre) të cilat botojnë fare pak gazeta dhe revista, besa edhe ato që i kanë, i „pregatisin" me aq pak materiale të ndërduarta, dmth. me aq pak „kuantitet", por, kjo, përsëri është çështje e tyre, e, (edhe po të ishte e jona), me siguri nuk do të ishim në gjendje ta bindim vehten dha ta arësyetojmë mendimin tonë qasur me mendimin që kanë ato lidhur me shtypin. Madhje unë nuk mund të flas as për ata dhjetra e dhjetra tituj revistash të ilustruara jugosllave, sepse jam shumë e papërgatitur për diçka të tillë, por nëse në këtë shënim më duhet t'i them mendimet e mia, atëherë më duhet ta pohoj përshtypjen e shumëkujt se, shtypi, ynë kualitativisht është mbi kriterin evropjan, sepse ai rrallëherë është subjektiv, rrallëherë anon kah ky subjektivizëm. por e thotë të vërtetën, besa, edhe atëherë kur ajo është pak a shumë „e papërshtatshme" të thuhet.

Mirëpo...

Mirëpo: shundi! Ta marrim, psh, televizionin dhe disa »emisione« të tij siç janë „Kuizi", i cili, parreshtur, që kur është „paraqitur" — sulmohet nga kritika dhe satirizohet nga humurostët. Aq „pika" të pashije ka aty, aqë poshtërime u bëhen pjesëmarrësve, aqë sjellje arrogante të Miqës (Oliveri është antipod i tij shembull për sjellje, por ç't'i bësh kur edhe ai nuk mund të tregohet në një „shund" të tillë), pastaj ajo mënyra e „shpërblimit" të pjesëmarrësve, ajo llotari... thuase krejt populli yne duhet të presë e të shpresojë në llotari. Nuk dij se çfarë mëson një redaksi e tillë, nuk dij sa edukon, sa komunikon, sa...

Besoj se, materjali argëtues dhe shundi duhet të dallohen dendur mes tyre dhe nëse kjo nuk bëhet, atëherë, me siguri, redaksitë e revistave tona nuk kanë besim në shijen e lexuesit, atëherë, me siguri, ajo shije në vend se të „kultivohet" vjen e bastardhohet gjithnjë e më shumë. Njeriut nganjëherë i teket të vjellë kur sheh gjithë farë fotografish pornografike, neveritet prej lloj lloj deklaratash të lexuesve, çuditët nga „senzacionet" e trilluara, i duket se vendi ynë është ndonjë Teksas kur lexon gjëresisht mbi vrasjet e përdhunimet e përditshme, të cilave u jepet aq vend e publicitet, thuase janë gjëra që ushqejnë njeriun, njeriu humb besimin në seriozitet kur sheh se si redaksitë u përgjigjen letrave të lexuesve, pastaj ato „horoskope" e përgjegje „vjesh", përgjegje grafologësh mbi karakterin e njeriut, që mua shpesh, ma merr mendja, mund të jenë edhe të kobshme për lexuesin.

Ta përmendi edhe njëherë, në fund, fakun se shtypi ynë është mbi nivelin europjan. Këtë gjykim nuk e trilloj, por e kam lexuar dhe, e kanë rilexuar disa herë. Ndoshta kjo edhe më shtyri ta shkruaj këtë shënim gazetaresk, por sa dhe si do të ishte e mundur të rritet edhe më ky kualitet, sikur shtypi ynë, me nivel europjan, t'i eliminonte disa „imtësira" që i bën vetëm e vetëm për t'iu rritur tirazhi, që i bën vetëm e vetëm për lëvërdi materiale. sa do të ishte rritur kualiteti i tij, sikur, duke mohuar këtë lëvërdi ta eliminoje shundin evident e kështu ta kultivojë edhe shijen e lexuesit tonë.

Bahrije BERISHA

GJITHESIA PËR TURISTET

— ÇFARË MENDONTE PERSPEKTIVËN E TURIZMIT NË GJITHËSI ORGANIZATORI I PROGRAMIT AMERIKAN PËR PËRVEHTËSIMIN E GJITHËSISË DHE ISH KONSTRUKTORI I PROJEKTEVE TË RAKETAVE TË HITLERIT

Qysh në fillim të bisedës Braun përkujton në fakt'n se „njerëzit që merren me raketat" që më shumë se 40 vjet njerëzit flasin për „udhëtimin në gjithësi". Por, sot, vetëm një grusht njerëzisht ka mundur të udhëtojë në gjithësi. Një klub, i cili formalisht nuk ekziston „klubi i udhëtarëve të bujqësisë" do të ishte më ekskluzive në botë nëse do të formohet. Kështu qëndrojnë punët sot. Po në të ardhm[illegible]

[illegible]un thotë se »eksiston mundësia se në fund të këtij shekulli në botë do të ketë disa mijera njerëzish të kualifikuar që mund të jenë anëtarë të këtij klubi..." Sot anëtarësimi në këtë klub nuk mund të mendohet, por nëse dikush mendon të bëhet anëtarë i këtij klubi duhet në radhë të parë të jetë fizikisht i aftë, e në radhë të dytë të ketë pas vehtes ushtrime të gjata dhe të komplikuara. Sot, këta njerëz quhen »kosmonaut«, »astronaut" simbas asaj se janë rusë apo amerikanë. Por, në të ardhmen „udhëtarë i gjithësisë" mund të jetë gjithkush, ndërsa emra të këtillë mund të bajnë vetëm anëtarë të ekipazhit. Ndryshimi ndërmjet këtyre të dyve do të jetë aq sa edhe ndryshimi ndërmjet pilotit dhe udhëtarit të aeroplanit. „Ajo që ka ngjarë në avijacion, do të ngjajë edhe në fluturimet e gjithësisë" thotë Braun. **A punohet në këtë drejtim?**

„Anijet e gjithësisë për udhëtarë të tipit „Ferry" të cilat do t'i transportojnë udhëtarët deri në stacionet e satelitëve tani më konstruktohen. Ato janë pjesë përbërëse e programit amerikan, që pason pas programit „Apolo". Sot këto anie ndodhen në fazën e parë, ose në fazën studjuese". Si do të duken këto anije?

„Do të jenë shumë të ndryshme. Në radhë të parë do të mund të përdoren vetëm një herë, prandaj edhe do të jenë shumë më mirë. Teknika e fluturimit të tyre do t'i ngjajë teknikës së fluturimeve të aeroplanave, që do të thotë se në to do të mund të fluturojnë udhëtarë të zakonshëm, deri në stacionet e gjithësisë dhe prap, ose deri në stacionet e gjithësisë e pastaj në shtëpi".

— A do t'i ngjajnë në dukje aeroplanëve konvencional?

Po do të kenë krah që do t'u ndihmojnë për lëshimin e tyre në tokë dhe për fluturimin si aeroplanat e sotëm. Do të kenë kabina të mbyllura hermetikisht edhe aparate për kondenzimin e atmosferës, kështu që fluturimi do të jetë i këndshëm. Udhëtarët nuk do të mbajnë maska ose tesha për gjithësi. Çdo t'thotë kjo? Se numri i njerëzve që do të jenë të aftë për flu, turim do të jetë shumë i madh".

„Po kjo nuk do të jetë lirë?"

„Në 10 vitet e para të fluturimit në gjithësi, amerikanëve u ka kushtuar 1000 dollarë lansimi i çdo kilogrami në gjithësi. Kjo situatë vazhdon, pse? Nuk punohet për atë se konstruimi i raketave të cilat lansojnë anije kosmike është i shtrenjtë, por fjala është se mbas asaj qëndrojnë hulumtime të mëdha teknike. Çdo raketë e këtillë është e aftë të përdoret vetëm një herë, ndërsa më vonë me të gjithë pjesët e saj të shtrenjta ajo nuk vlenë më. „Ferry" i gjithësisë nuk mund të përdoret shumë herë. Mendoni çdo do të kish ndodhur me aviacionin nëse çdo aeroplan do të mund të përdorej vetëm një herë, e pastaj të bidhet! Sot shpenzohen rreth 1000 deri në 2000 dollarë për lansimin e një kilogrami të nevojshëm në gjithësi. Te këto anije kosmike çmimi do të ishte 20 herë më i vogël".

— Cili do të jetë qëllimi bazë i këtyre fluturueseve dhe si do të duken ato?

„Ato do të kenë përdorim të gjithanshëm. Në radhë të parë do të mundësohet përdorimin e laboratorive normale dhe aparatave të tjerë shkencoro-hulumtues në gjithësi. Ne, sot, për hulumtime shkencore përdorim, kryesisht, aparate dhe instrumente të automatizuara të cilat janë të shtrenjta pikërisht pse duhet të funkcionojnë automatikisht. Çmimi i tyre është prej 20 mijë deri në 60 mijë në kilogram, shërbejnë për matjen të cilat mund të kryhen në prej laboratoriumi dhe kështu të kushtojnë shumë më lirë. Shikoni, unë mendoj se është më lirë në gjithësi të dërgohen njeriu dhe instrumentat, e jo automati dhe instrumentat. Në radhë të dytë, si duket, është e sigurtë se fluturueset e këtilla do të përdoren ndërmisione individuale. Kjo do të thotë se me ndihmën e tyre do të mund të kryhen detyra individuale, P. sh. astronomët zbulojnë ndonjë paraqitje afatëshkurtër astronomike dhe dëshirojnë ta studjojnë mirë. Në këtë rast do të përdorej një fluturese e këtillë e cila do të mundesonte që të qëndrojnë në gjithësi dhe ta shikojnë së afërmi këtë. Në vehte mund të marrin instrumente, dihet edhe teleskopin."

— Si do të jetë dimenzioni i këtyre fluturueseve?

„Sipas planeve dhe projekteve të deritashme, dimenzionet nuk janë të vogla. Për shembëll, pesha e barës së dobishme do të arrijë deri në 25 ton. E gjithë kjo do të vendoset në një komorë që do të ketë vellim prej dhjetra mijë metra kub. E kjo është e mjaftueshme që të vendosen 12 udhëtarë, duke mos e llogaritur ekipazhin që do të gjendet në kabinin e vet. Është interesante se shpejtësia me të cilën fluturuesit do të zbresin në Tokë do të arrijë vetëm 180 milja në orë, e kjo është pak më shpejt se sa shpejtësia e aeroplanëve **„Boing"**.

— A është e tepërt nëse ju pyesim se a do të kishit dashur ju të fluturoni si udhëtarë?

„Përgjegja është e qartë, sepse unë besoj se anijet e këtilla do të lëshohen në përdorim qysh para këtij shekulli. Sot kam 58 vjet dhe së shpejti do të bëhem gjysh, por nuk shoh arsye pse gjyshërit nuk mund të fluturojnë në gjithësi. Nëse jam i shëndoshë, besoj se do të shkoj në një fluturim të këtillë, sigurisht nëse nuk nisem në një fluturim tjetër... Në botën tjetër".

Ju mendoni se fluturimet në gjithësi në një të ardhme të shpejtë do të jenë dicka e zakonshme, në atë masë sa edhe në to do të marrin pjesë njerëzit e zakonshëm, të flasim për turizmin në gjithësi?..."

„Nënkuptohet se fluturimi në gjithësi do të jetë gjithnjë ndryshe prej ati në Tokë. Por, deri sa mendojmë për të ardhmen duhet pak të shkojmë edhe pas shpine. Duhet të mbajmë llogari se shumë vende të planetës tonë kanë qenë të arritura vetëm për më trimat dhe më të fortit, deri sa situatën nuk e ndërroj krejtësisht zhvillimi teknik. Unë si fëmije lexoja i habitur për shkretëtirën e madhe Amundsen dhe për vdekjen tragjike të kapetanit Skot, ndërsa para pak kohësh si burrë 50 vjeçar isha në Polin e jugut! Me konfor të plotë!. Dikur në Saharë udhëtonin vetëm devet. Sot mund të udhëtoni me aeroplan..."

— Çka i shtyn njerëzit të udhëtojnë në gjithësi!

„Në radhë të parë, nxitja njerëzore që quhet kurreshtje, mandej nevoja e njeriut, nevoja e pazotnueshme, për lëvizje-uthëtimes. Njeriu është kafshë e cila nuk mund të qëndrojë në një vend. Në botën e ardhme, që do të jetë me më shumë banorë, kjo nevojë do të rritet...".



FJALË KRYQ

HORIZONTALISHT: 1. Dama e jonë e muzikës popullore, Llukiq — shkrimtari i jonë, Frashëri, 2. Lloj pëlhure — germë e greqishtes — agjencia gazetare ruse, 3. Dëshirë e madhe (turq.) — ministri i punëve të jashtëme i Indonezisë, Adam, 4. Sahati — vend historik në ShBA — shkova, 5. Përëmër — figurë stilistike — njësi sipërfaqesh, 6. Shkrimtari rus, Erenburg — lloj muze, 7. Kreatorja e ndjerë franceze e modës, Shanell — papagalli — emër mashkulli dalmatin, 8. Valle maqedone — vendlindja e Odiseut — zë, tingull, 9. Emri i Kareninës — shkresë zyrtare — kohë, 10. Tabak — qytet univerzitar në Angli.

VERTIKALISHT: 1. Monedha italiane — fotografia kishtare, 2. Toka (lat.) — sahati, 3. Shtet i vogël në Francë, 4. Emri i kangëtares zëzake, Ficxherald — thirje telefonike — flori, 5. Fortesë, 6. Bardh (turq.) — shenjë komunikacioni për automjetet e Meskovcit — sulm, 7. Simboli kimik i niklit — mos (lokal) — shkresa zyrtare, 8. Aktresha e njohur franceze, Zhana, 9. Aktresha e jonë e parë filmi, Rina — mbret i lashtë judë — simboli kimik i molibdenit, 10. Shtet në Afrikë — emri i Çajupit, 11. Moreuz në mes të Danimarkës dhe Norvegjisë, 12. Regjisori i njohur italian, Vitorio de — shahisti i jonë, Bora, 13. Opera e Bizeut dhe e Puçinit.

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT TË NUMRIT TË KALUAR:

HORIZONTALISHT: 1. Kasu — Bari, 2. Kan — Spa — ika, 3. Salep — Kosta, 4. Ole — jaran — iap, 5. Ni — Metanol — ke, 6. Sar — Raf, 7. Toto — Moll — Done, 8. Ale — Kallas — Tas, 9. Ella — Rab — Mor, 10. Allas — Avis.

UNE JAM POET

Unë jam poet
Thurr vargje me lezet
(Të gjitha nga librat e lexuara me gazep).

Po më thoni — i panjohur poet?!
Sa e sa letra kam harxhuar
Me sa e sa njerëz jam këshilluar
Dhe vargjet në dyzen i kam shtruar.

Pashë bukën, më thirr poet!
Bukur më tingllon kjo fjalë vetë
E meritoj këtë epitet
Se poezinë e kam shyhret.

Mos u frikso — më thirr poet!
Kam kryer shumë mejtep
E tani shkruaj me shkronja të mëdha
Mjerisht — më duken krejt si
n'arabisht.

Me plot bindje më thirr poet!
Kam diapazone që s'është mahi
E njoh Beatriqen, Afërditën dhe Ofelië
E Tagora, Jesenini, as në thembër
s'mund të më mbrrijnë.

Pa kurrfarë dyshimi m'thirr poet!
Kam gjuhë fshatare — universitet,
Përshkruaj kolorin, ambientin
E sa për foklorin, jam folklorist vetë.

Duhet pasur sy e mushkëri
Që të shkruash për dashuri
Duhet pasur ndjenjë e fuqi
Që dielin ta ndashë në dysh

Me pendë të mprehtë — si në mahi
Si sollomon me të tmerrshëm brinj
Lexuesit zemrën t'ia shposh
E jo me fjalë bosh
Që u vjen era groshë.

Si duket, ti, po dyshon në vlerën time
si poet:
Vargje kam, plot një xhep
E kur ato më harxhohen
Unë aspak s'vonohem:
Shkoj në restaurant ose në buffet
E poezia me rrjedh për lezet.
Para thua? Por, ato më vijnë vetë?

Ti, o kritiki nderuar,
I respektuar,
I uruar:
Ke pendë të mprehtë
Madheshtor — maestro botëror.
Prej teje varesha, tani të kam mik
Sa objektiv ishte i yti kamxhik,
Duhej vetëm pak myreqep
Dy fjalë të tua më bënë poet.
Po të falem o i madh kritik
Që më pagëzove me këtë emër jetik.

Unë jam poet
Thur vargje me lezet
(Të gjitha nga librat e lexuara me
gazep).

PREKË — MOS MË PREK

HUMOR







PA fjalë



Qemal Haxhihasani

REZULTATET E KËRKIMEVE TË CIKLIT TË KRESHNIKËVE PAS CLIRIMIT

(2)

Shkumbini asht kufini i fundit të shtektimit dinamik të ciklit, i përhapjes së elementeve të tij me anë të marrëdhanjeve të fqinjësisë. Por ne mund të përfshijmë në nji trevë të veçantë dhe lokalitetet që gjinden këndej dhe andej këtij lumi, të popullzuar nga elementi kosovar i emigruar. Kjo trevë përmbledh katunde të rrethit të Durrësit, Kavajës, Peqinit, Elbasanit, Lushnjës, Fierit. Brezi i vjetër i këtyre njisive kosovare, bashkë me traditat e vendit të origjinës së tyre, ruan akoma edhe këngët e kreshnikëve, të cilat sjellin tiparet karakteristike të repertorit të Kosovës.

Hulumtimet e kujdesshme të pasurisë në çdo zonë, çëmtimi me vemendje i elementeve të shpërndara të ciklit, kanë nxjerrë në dritë nji varg subjektesh e variantesh të panjohura më parë. Është zgjanuar kështu me një mënyrë të konsiderueshme numri i subjekteve, i motiveve i personazheve me gjestet e tipareve të tyne, i toponimeve, e elementeve etnografike, artistike, etj.; janë mbledhur materiale që hjedhin dritë mbi gjenezën, karakterin blegtoral, përbamjen dhe specifikën nacionale të ciklit; janë bërë inçizime, që lejojnë studimin e vijës melodike: janë marrë njohtime për rapsodët, lahutat dhe për shumë çështje të tjera, që japin mundësi sot për nji vështrim poliedrik të problemit dhe për nje studim të thellë të tij.

Zgjerimi e reportorit të temave të ciklit me subjekte të reja, që shkojnë që nga origjina e forcës së heronjve, nga luftimet për mbrojtjen e vendit dhe ndërmarrjet aventuriere në Krajli, Talir, Anadoll e gjetiu, deri te mbyllja e kreshnikëve në shpellë, duhet të shihet si një rezultat shumë i rëndësishëm i arritur në fushën e kërkimeve tona gjatë periudhës së pasçlirimit. Trungi i këtyne subjekteve hedh dritë mbi një realitet epik mesjatar, zbulon aspekte nga zhvillimi historik i popullit tonë dhe i popujve të tjerë të Ballkanit në përiudhën bizantine në etapën e fundit që mbyll periudhën para pushtimit turk. Në vija të përgjithëshme i takojnë këso saj periudhe subjektet që paraqesn indërmarrjet e protagonistëve të këtij cikli kundër kundërshtarëve të tyne të fuqishëm, — krajlit të Senjës, të Kotorrit, të Zadrës, të Primores, të Talirit të Bagdatit e tj., — të cilët të kujtojnë me ambientin e tyne, me kullat shtatë katëshe, ku ruhen thesare dhe mistere të ndryshme, me bodrumet e burgjet nën ujë, me avllitë dhe kanalet rrethuese etj., jetën e feudalëve mesjetarë. Në atmosferën e këtyne ndërmarrjeve ndihen reflekse të lëvizjeve fshatare kundër rentës feudale të shekujve XII—XV, për të cilat flasin kronikët e kohës, — Kantakuzeni, Laoniku, Kritobulli. Të kësaj periudhe mund të quhen rreziqet e bajlozëve, harapëve e harambashëve, të cilët kërcnojnë vendin nga deti e nga toka; përpjekjet dhe luftimet që zhvillohen për pushtimin e bjeshkëve, ku kullosin grigje me bagëti të panumërta, inisiativat për rrëmbimin vajzave a nuseve të palëve kundërshtarë, duelet, për të treguar epërsinë fizike kundrejt kundërshtarit etj. Tematikën ekzistuese kërkimet e fundit e kanë pasunuar me një varg variantash si ato të luftave me harapët e bajlozët (Çika e plakut të motshën Harap Harambashi, variantet e ndryshme të »Gjergj Elez Alisë«), Muji e Kraleviq Marku Omeri i ri e Ganiqe Galani, Halili e Çobanbashe Radi, Bani i Zatvorit, Deli Musta, Kralash Kapedani, Milosh Grebeni, Bane Seberlia, Mejdani i Mujit, Lule Franga Daija e Osman Dugajxhija, Gjetobashë Muji, e Peçi Vojvoda, Huso Kraposhniki, variantet e martesave të Halilit, Mujit, Ali Bajraktarit, Zukut, Plakut Qefanaqë etj.

Ashtu si materijalet e maparshme edhe materialet e reja përmbajnë në nji masë shumë të gjanë elëmente të jetës blegtorale. Që nga origjina e protagonistëve deri te gjestet e avanturat e tyne ndihet kudo fryma e nji ambienti pastoral, e nji jete që pasqyron me nota shumë të natyrshme tipare të fiseve tona veriore, bartës të këtyne kanëve. Ambienti bujqësor nuk bie në sy pothuajse fare në kangët e këtij cikli. Jo vetëm kaq, por ai shënon edhe nji ter minus ad quem për jetën e ciklit. Në një variantë të mbledhur kohët e fundit nga malësorët e Bregut të Matit, kur u inoponohet heronjve të ciklit një jetë e tillë, — kur detyrohen, „të shkrinjë shpatat për t'i këthye në plugje par mendash", — atëherë merr fund dhe funksioni i tyre si kreshnikë. Materialet e mbledhuna nxjerrin në dritë gjithmonë e ma shumë tiparet nacionale të personazheve, karakterin patriarkal të marrëdhënieve të tyne familjare, konceptet e jetës fisnore, vërtytet morale: mbajtjen e fjalës, besën, urtinë, guximin, burrëninë e sa e sa elemente të tjera, që mishënojnë portretin fizikomoral të malësorit tonë. Në fushën e të dhënave gjeografike, roponimeve të njohuna u shtohen elemente të reja: emna vendesh, grykash lugjesh, bjeshkësh etj., që lokalizohen brenda territorit të malësive tona të Veriut.

Për tiparet nacionale të ciklit dëshmon në nji mënyrë të fuqishme sfondi mitiologjik. Heronjtë tanë pajisjen me fuqi mbinjerëzore, ndihmohen me gjestet e tyne fantastike, mbrohen në situata të rrezikshme etj., nga zanat, orët, shtojzavallet, të cilat janë figuraautoktone ilire, që rrojnë me një forcë të veçantë akoma edhe sot në psikologjinë dhe botëkuptimin e malësorit të krahinave tona veriore.

Të shumta janë subjektet që sjellin paraleli zma motivesh, rrethana të përbashkëta të zhvillimit të aksionit, madje teknikë të përbashkët, në ndërtimin artistik, në mjetet poetike, në emnat e personazheve, në toponime etj, me eposin heroik të sllavëve të Jugut. Përcaktimi i rretha nave historike që kanë kushtëzuar lindjen e këtyre paralizmave, studimi i origjinës, zhvillimit, ndikimeve reciproke të epikës heroike shqiptare dhe të eposit sllav, në dritën e nji analize shkencore do të jepte një kontribut të rëndësishëm për zgjidhjen e këtij problemi me kaq interes për folklorin ballkanik.

Në subjektet e mledhura, ashtu si edhe në materialet e botuara, ka motive, elemente artistike, deri formula e shprehje gjuhësore, që pasqyrojnë pika kontakti me eposet mesjetare të Perëndimit (kangët e gjesteve frenge, Cidin e spanjollëve, Nibelungët e gjermanëve etj.), me poemën epike bizantine Digenis Akritis. Elemente të shkëputuna të kujtojnë poemat e mëdha të Rilindjës: „Orlando Furioso", „Gerusaleme liberata" etj. Në një variantë nga Krasniqja gjejmë nji skenë të afërt me përcjelljen që i ban V. Teli Burganteni nëpër liqenin e Firvaldshtetit, qëndrimi i përgjumur i kreshnikëve në shpellën e Bjesnkëvet të diellit, është i ngjashëm me atë të Frederik Baruarosës së sagës gjermane në shpellën e malit Unterzberg etj.

Periudha turke ka hedhur shtresën e vet mbi përmbajtjen dhe mbi formën e jashtme të ciklit. Materialet e mledhura nga krahinat verilindore (Krasniqja, Gashi, Kosova) sjellin një varg personazhesh, toponimesh dhe elementesh të tjera, të krijuara nën ndikimin e pushtimit turk. Të tilla janë p. sh. kangët: Ali Anadolli, Sulltan Sulejmani e Krajli i Bagdatit, Çupërli Veziri, Kazi Murat Agë, Hazreti Aliju, toponimet Bagdat Shah, Jemen Stamboll, termat, shprehjet dhe formulat e ritit islamik: Sabah, adbes, shahadet, ramazan; titujt: aga, vej, bajraktar; dizdar bylykbash; emrat e personazheve, që dalin pothuajse rregullisht me trajtën onomastike turke: Ferhat Pasha, Emin Aga, Hasan Aga, Mustafa Boshnjaku, Ali Bajraktari, Halil, Hysen, Mehmet, Imer, Dezdar, Aga etj. Nga një vështrim i jashtëm këto elemente do të flitnin për një ndikim të thellë të jetës kulturale dhe politike të pushtuesit. Por, nën dritën e një analize më të kujdesshme, do të shihen se, me përjashtim të ndonji subjekti që sjell elemente nga jeta dhe kultura e ciklit, personazhet e tij, gjestet dhe motivet themelore, ruajnë përgjithësisht nji fond të pastër, të partizuar nga këto ndikime. Elementet e botës islamike kanë mbetur në sipërfaqe. Tej tyne rrojnë ndjenja, dëshira, zakone, mënyra jetese, që i përkasin nji bote me spesifikë originale autoktone. Edhe kur gjendet ndonjë subjekt me skena nga jeta e perandorisë turke, siç ndodh në rastin e këngës së Ali Anadollit, nuk mpleksen rrethana politike të tilla, që të idealizojnë forcën e pushtuesit a t'i fusin herojtë e, kangës në shërbim të tij. Në asnji variantë të ciklit të kreshnikëve nuk haset një vartësi politike e personazheve nga pushteti shtetëror otoman, në asnji prej këtyne rapsodive nuk shohin gjeste që të synojnë në forcimin e këtij pushteti. Ato pak subjekte që venë në kontakt direkt heronjtë e ciklit me mbretin e Stambollit, — Muji tu Mbreti etj., — tregojnë me nji mjeshtri artistike shumë të hollë konsideratën e masave për kreshnikët, të cilët janë vigaj që i kallin datën sulltanit, dhe përçmimin për figurën e mbretit të Stambolit, i cili asht nji xhuxh-maxhuxh, që nuk di ku të futet, kur ndjen prezencën e kreshnikëve, ose që tërhiqet rrëshanë me futet, kur ndjen prezencën e kreshnikëve, ose që tërhiqet rrëshanë me gjithë post, vetëm pse ngatrrohet gand për kamcani të tirqve të tyre.

Paralelisht me kërkimet në terren janë ndërmarrë edhe përpjekje për studimin e probleme ve themelore të ciklit tonë të kreshnikëve. Prof. Dh. S. Shuteriqi në leksionet e mbajtura në Institutin Pedagogjik më 1947—48 ka dhanë nji kontribut për një vlerësim shkencor të ciklit; shoku Z. Sako në kursin e folklorit pranë Univerzitetit Shtetëror të Tiranës ka hedhur teza interesante për origjinën dhe periodizimin e tij, siç është ajo e reflektimit të luftës së bashkësive fshatare kundër sunduesve feudalë në periudhën midis shekujve XII—XV. Një studim me vlerë në këtë periudhë e ka dhënë albanologu i mirënjohur gjerman, Prof. M. Lamberc, — Die Volksepik der Albaner — Der Zyklus von Mujo und Halil, — botuar për herë të parë më 1954—55, në revistën e Univerziteti „Karl Marx" të Laipcigut dhe ribotuar në një vëllim më vete më 1957. Punues të brendshëm të Institutit të folklorit punojnë prej disa vjetësh për zbërthimin e problemeve delikate të origjinës, lokalizmit historik e gjeografik, bazës ideoartistike të ciklit, specifikës nacionale, ndikimeve reciproke shqiptare, sllave etj.

Kërkimet për ciklin e kreshnikëve në terren do të vazhdojnë edhe në të ardhmen. Ekspeditat e mëparshme kanë pasë një karakter krye sisht eksplorativ; të zbullojnë zonat e shtrirjes gjeografike të ciklit dhe subjektet e tij. Tash e tutje do të zhvillohen ekspedita në zona të caktuara për të ndjekur dhe thelluar probleme të veçanta, si p. sh. variantet në bazë të nji subjekti, motive, personazhe, të dhëna gjeografike të caktuara.

(Fund)

ZOTNIJA, PLAKU E JAHUDIJA

Shenoi: Jakup ÇITAKU

Ish kanë ni herë ni zotni. I kish pasë tana t'mirat bollak. Mall sa t'du esh. Zotnija i kish pasë dy djem. I madhi nja gjashtëmdhet vjeç, i vogli nja dymbëdhetë. Odën e kish pasë diçka pos tanve. N'tâ gjith kishe me pa veq musafir zotni, akrangja t'zotnisë.

Ni ditë zotnisë i erdhën dy dosllarë për drekë. U qiti me hangër mirë e ma mirë, demek deri qaty bahet. Mas dreke, musafirt deshtën mu çue me shkue se veq ishin ardhë për krye dite me ba pak muhabet me zotnin e mu kthye n'shpija t'veta. Kur i pa zotnija qi nime po donë mu çue, ju tha: pej meje izë nuk kini për mu çue, mirë se u ka pru zoti, e për qef tem duhet me nejtë sante krejt, n'dashi mus me e prishë.

Kshtu u nalën me bujtë dy zotnitë musafir. Ja nisën apet llafit e muhabetit, kah s'hinë e kah s'duelen. Kur erdh vakti i darks, zotnija ju tha djemve me shkue e me pru bukën. Veq sa duelën djemt prej ode n'xhezëmti, e nien ni za t'trashë te dyert e aborrit. Po thrret dikush — Oooo, i zoti shpisë, oooo, i zoti shpisë, oooo, i zoti shpisë edhe po ju mshon dyerve me diçka: taaak, taaak, taaak.

Ngau djali i vogël, e çeli kamxhikun e dyerve, kur qe ni plak me ni krroqe n'dorë. — Kush je ti o, dost-e veti djali plakun. — Une bre bir ni plak i largët, m'ka nxanë nata e nuk di kah me ia majtë e ja msyna qityne dyerve, nashta m'bani konak sonte, e nestra heret tfilloj meniherë për ku jam msy. Djali kur e pa at jetik plak, e nieu çka e qysh tha, ja çeli kamxhikun e tha: — hajde, hajde mixhok se kemi odë, e kemi ven boll.

— Sonte i kemi edhe dy musafir tjerë- dosllarë t'babs. — Haj u rritsh e paq nafakë bre djal i mirë koke — i tha plaku djalit t'zotnisë. Djali prike, plaku shkojke mas tij. Kur u afruen te bera e od's, djali veq ja çeli derën e i tha: hin mixhok, hin. Qatherë veq sa ish kanë kthye tërvesa qi e kish pas pru djali i madh i zotnisë. — Selamalejkym e afjetolla more burra — ju tha plaku zotnive qi veq sa ishin ungjë n'tërvesë. Zotnija ish msue me pa fukare qpesh te dyert e tij tue lypë, e menoi qi edhe ky ash qasi fukareje po djali nuk ka dijtë me e përzanë.

U mrrol kogja fort zotnija, e kqyri pak ni herë si nër vetlla për s'ungjti e si vetmeveti kadale tha: — Eu, çja nxorre bisht more plak!

Plaku e nieu mirë, po nuk kish hesap mu idhnue e mu çue se s'kish tash kah me je majtë n'at terr t'madh qi nuk u doke gja, besa edhe ish kanë shum sabërli e i tha veti kadale vetmevetei — kadal plak, kadal mus u idhno pej gjithkuj, se nashta edhe ktij i ban vaki nejse për hernejse e përpiqe për mue, s'dihet qysh ja sjell allahi punt kurkuj.

Zotnija masi e pa qi u ba tash, hini plaku n'odë, i vike edhe pak marre pej musafirve, dosllarëve t'tij e i tha plakut mu ungjë me hangër bukë.

U ungj plaku n'tërvesë, besa hangër edhe shumë bile, qi zotnisë taman ju mush menja se asht ni fukare i kputun e i untë çka bani plaku tue hangër shumë. Mirpo plaku ish kanë lodhë pej udhe, se nuk ish ashtu qysh menojke zotnija se asht fukare. Zotnija kujtojke qi ky masi asht plak, nuk nien sagllamë, edhe ish mushë pej inatit të djalit t'qi ja pruni mrena plakun, e apet i shkoj goja e tha: — ja ke nxierr bisht qi erdhe more plak. Zotnija tha kadale me za t'vogël, po plaku e nieu mirë. Plaku apet nuk bani za veq i tha veti: — sabër plak, sabër, se sabri e ka selametin.

Mas darke nejtën çka nejtën e ranë me fjetë. T'nestret plaku u çue veq sa ja dha ferku i sabahit, nuk nejti për kaftjall, i la musafirt n'gjum e tfilloi bash qashtu i tha djalit t'zotnisë te dyertë pramë. — Kurr nuk kam me ja harrue zotnisë qata qi mtha dy herë. „Ja ke nxierr bisht..." thejke plaku vetmevet kah shkojke udhs. Plaku ish kanë shumë i meçum edhe majke men shumë qi tej qaty mun bahet me majtë men gat.

Mas nja ni vjeti zotnisë i bjen puna me shkue me gjith grue n'shehër.

E bani kalin gati ni ditë, e qiti t'shoqen n'kali e vet e kapi kalin për freni e ngrihke e prike drejt për shehër. Kali i mirë, grueja e mirë, zotnija burrë i mirë e i hieshëm sa t'duesh, xhadja tu mushke menja po ban dritë pej tyne kah shkojshin. T'bamit me hi n'shehër, skej xhadje ish nalë ni nieri i veshun mirë, i kish qitë duert n'shkekë e rrike. Ai ish kanë ni jahudi i qati shehri, e ish kanë dalë n'xhade me ymyd qi bjen nejkush nej kali t'mirë n'pazar për me shitë. Jahudija kur e pa zotninë tue ardhë, meniherë i shkuen syt n'kali t'tij. Mirpo, nuk e besojke se e shet zotnija kalin kurqysh. Qysh me shitë zotnija kalin, jahudija e dike mirë qi ky nuk asht miftijaqë për kurgja sen n'dyjat. Kur u afrue zotnija nja dhetë hapa ngat jahudisë tue shkue xhades, jahudisë i shkuen sytë edhe te grueja e zotnisë. Ajo ish kanë femën qi nuk ban përte sajna. U menue tash me e tredhtue me ja marë edhe gruen edhe kalin. Grueja nrrue ish ba llam, veq vetojke. Ish ngreh n'kali qi t'kajke me pa. Jahudija u menue qpejt vetmeveti, e kur u afrue karshi tij zotnija me kali e me grue i tha: — A pe shet qit kali o zotni? — Paj e kam për qefi, e nuk muj bre jahudi — i tha zotnija.

Grues i shkoi buza n'gaz pak e jahudija ju truk përmas. Nale pak kalin o zotni — i tha jahudija, tue shkue nja tre hapa anash sebet grueje. Zotnija e nali kalin. Jahudija i tha se po ta paguej mirë veq shitma se mu ka lidhë maraku n'qit kali e m'jet zhig deri t'des. Grueja pa ditë ni grimë sherri i tha kadale burrit-shitja o nieri se i kemi edhe dy tier. Jahudija e nieu pak gruen, u gzue po ma shum u tutke qi po zhdryp grueja pej pali e nuk po munet me e ba ata qi e menojke vetmeveti...

— Paj n'ma pagofsh kogja si mirë, masi tu ka tekë po ta shes-i tha zotnija jahudisë. — Se po ma man qishtu qysh asht? — e veti jahudija zotninë. Zotnija i kish metë te rrypat e shala edhe i tha jahudisë: — Qyshtu qysh asht, qysh pesheh vet me t'tana (pa menue hiq për grue) po ta jepi për 60 lira.

— Jahudija u tutke qi po ftohet puna, e ma fort e kqyrke gruen se kalin e zotnisë e tha bama pra përhajr! Zotnija ja xgati dorën tue i thanë masi ja muer paret — sa kime ka, qaq ja pafsh hajrin. Jahudija u gzue qi e tredhtoi.

Zotnija i shtini lirat n'kuletë e i tha jahudisë veq masi tu ba marak se une nuk jam ngusht për pare. Tash me ja dhanë kalin jahudisë, zotnija i tha grues me zhdrypë. Grueja veq sa livriti pak, jahudija tha jaaa... na e bam qishtu qysh asht me gjith grue. Zotnija po, zotnija jo, jahudija po, bre s'ban, bre ban, bre s'ban edhe metën tue u shty. — Po me se men ta shes une gruen?! — i tha jahudisë zotnija. — E di qi nuk ma kishe shitë kurr, po tash e kemi ba qishtu edhe s'ka fjalë ma nej — i tha zotnisë jahudija.

Bre ban, bre s'ban, u shtyn ni cop here e nuk mujtën mu marë vesh kurqysh.

Grueja veq u dridhke n'kali pej tute mus po rehen. U shtynë, e u shtynë po masi e panë qi nuk po muj meren vesh, e sosën me shkue te kadija me ja degërdisë kit punë. Zotnija e kapi kalin për freni, jahudija shkojke anash e ja qatisën te kadija n'shehër. Kur shkuen e hinë mrena, kadija i veti. — Çka kini qi jeni ardhë? Jahudija foli i pari: — Une e zateta qit zotni me qit grue n'kali pak pa hi n'shehër. E nala e i thash: sa po ma shet qit kali qishtu qysh asht? bum-rrum, bum-rrum, u goditum për 60 lira.

Grueja atherë ish n'kali hypun. Ky dojke me e zhdryp gruen pej kall, e une i thash se e bam me gjith grue edhe m'bjen me marë edhe gruen, — tha jahudija.

Une po, zotnija jo, une po, zotnija jo, erdhum te ti zotni kadi me na e da qit punë qysh bjen. — A o kanë qishtu? — e veti kadija zotninë me gjith grupe.

— O kanë veq na kemi menue veq për kali me rrypa e shalë — thanë zotnija e grueja e tij. — Eeee, tjetër asht ajo punë ju çka kini menue, e tjetër asht ajo qysh bjen qikjo punë — tha kadija. — Po me sa men ja shes une gruen?! — i tha zotnija kadisë. — E ke folë, drejtsija ja ep, edhe ti duhet me ja dhanë, çka me ba tash masi i bjen i bjen edhe s'ka fjalë aty — i tha kadija zotnisë. Kshtu jahudija ja muer kalin edhe gruen zotnisë nat sabahle.

Zotnija met pa kali, pa grue, pa ftyrë edhe krye ungjt ja nisi po enet nëpër shehër, se ju doke qi tanë dyjeja pe dinë qka i bani veki. U mërzitke dej qaty muj bahet, veq qi nuk kajke hala. — Ani tash kur te marin vesh, tanë keshin me mue — i thojke vetit zotnija tue u siell posht e përpiet shehrit i mrrolun e si terzija pa pej. Ai plaku qi ish kanë n'konak t'zotnisë para ni vjet si gan e pa e tha athue a asht qaj zotnija qi bujta vjet n'konak tij kur m'pat nxanë nata?! — tha vetmeveti plaku. Kur ju afrue pak për anash e ngjofti mirë zotninë. Kur e pa kaq shum mërzitshum ju afrue e i tha: — O dost, a po m'kall xon çka kije qi po mërzitesh kaq fort — e veti plaku. Po me tu pasë mytë xhemitë n'deti nuk duhet mu mërizitë kaq fort. — Po bre ok mue m'ka kanë edhe ma keq — i tha zotnija plakut. Mu ka ma ra sod me sodën. Kur i kallxoi fill e për pe plakut zotnija, plaku u ...tue e tha: ti paske rreshitë qi nuk je kujtue hiq çka po flet, veq mus u mërzit se mixha sod n'koftë gjall ka me ta nxierr gruen edhe kalin pej jahudije. — Jo kjo ka marë fun — i tha zotnija plakut.

— Kur t'thom une po, po — i tha plaku zotnisë. Veq kallxom ku e ka shpinë jahudija — i tha s'mrami plaku zotnisë. Zotnis e erdh pak gjak. — Jo, n'mujsh me ma nxierr veq gruen sod, se mas sodi edhe me ma dhanë jahudija vet s'ka çka m'vyen, se m'shkon ftyra, une po ti jap me t'hallall 100 lira — i tha zotnija plakut, po nuk pe ngjeh hiq qi ky asht ai plaku i konakut të vjetit.

E vetën dikan edhe e muerën vesh se jahudija ish n'dugajë. Shkuen plaku e zotnija te dugaja e jahudisë. Ai i kish pasë tri dugajë. E treta ish kanë dugajë ku jahudija shitke mish. Kqyrën n'tparën s'ka, kqyrën n't'dytën dugajë, s'ka, nuk asht jahudija. Kur shkuen n't'tretën e panë për xhami kah shet mish. Plaku i tha zotnisë mus me hi ai mrena se jahudija e njeh ata, e tani nuk munet me e tredhtue. Zotnija u skejue diku e plaku hini mrena. N'xhepi kish nja 50 lira. Teshat nuk i kish t'mira plaku. N'dugajë kish plot kofsha t'mishit t'gjave, mushkni, veq mish, e ni ren vierrun ish veq krena t'gjave.

Plaku ja nisi e po i kqyrë krenat. Jahudija shitke mish. E kish ungjë kryet e prejke sa mujke, as nuk kish ren me kqyr kush po hin e kush po del. Masi u kujtue pak plaku i tha jahudisë. — Sa pe man kryet?!... Jahudija kur e pa plakun, le ji nuk menoi çka veti po nuk menoi as qi ka pare bile edhe i thaplakut: kry maj li-ra, a ai i hitke 2 lira, po i tha veq sa me e hiek qafe. Plaku i nxuerr 10 lira e ja dhajahudisë. Jahudija u serit, qysh po bahet budallë ky plak e pe paguen 10 lira ni krye t'gjasë. E kapi ni krye e ja qiti plakut mi tezgë. — Jo, unë e bleva kryet tan — i tha plaku jahudisë, se nuk jam budallë me pague 10 lira kryet e gjave masi nuk ban ma shumë se dy.

Aty qilluen edhe do gjin e masi e tfilloi kshtu plaku fjalën e vet, edhe ata ja banë ispatlluk se qashtu bjen qysh tha plaku. Mirpo jahudija hanke-fre e nuk dojke me hi anej hiq se qysh e çka e veti plaku, po e lutke me e marë kryet për dy lira tash, qysh e shitke, se e pa çka bani mirë.

Plaku veqse kryet e jahudisë e dojke masi e bani pazar. Jahudija u munue me e largue plaku tue i thanë: — meri lirat tua e hiqmu prej dugaje, po plaku apet si apet nuk ju çkoqke, veqse kryet e tij ja lypke. — Une bre burr e bleva kryet tan e dhe mus t'xgasim ma nej-i tha plaku jahudisë nër sy atyne gjine qi qilluen n'dugajë. Masi nuk mujtën mu marë vesh, jahudija e msheli dugajën edhe shkoi me plakun te kadija me ja u da kit mesele qysh bjen hajqi.

Zotnija kur e pa plakun se po shkojnë te kadija me jahudinë, ju gzue zemra, po nuk e dike qi bahet diçka për ta mirë ma. Ai ju shkoi-ke për anash deri qi shkuen plaku e jahudija me hi mrena. Plak e jahudija hinë mrena te kadija e zotnija erdh e po ngon n'xhezëmti te dera e kadisë. Zemra veq po i rreh si leprit pej tute e pej gzimit. — Fol plak, çka je ardhë? — i tha ma s'pari kadija. Plaku i kallxoi ren kadisë qysh o shkue, o hi n'dugajë t'jahudisë e i ka thanë: — Sa pe man kryet? e jahudija i ka thanë — ra. — Ja dhash 10 lira e i thash se une e bleva kryet tan, po jahidija nuk deshti me nie për kit punë e erdhum te ti me na kallxue — tha plaku.

— A o kanë qishtu? — pe vetë kadija jahudinë. Jahudija nuk mujti me thanë s'o kanë se n'dugajë pat edhe gjin tjerë qi mujshin me ba ispatë.

— Po, qishtu o kanë tha jahudija, — veq unë kam menue për krye t'gjasë e jo për krye tem. Kryet tem qysh e shes me pare-tha jahudija.

— Eh, ti jahudi ja paske shit kryet tan palkut edhe tash s'kije çka ban veq kqyr e meru vesh qysh t'munesh me ta — i tha ma s'mrami kadija.

— Kape jahudinë për veshi e dilni përjashta — i tha plakut kadija.

Plaku e kapi jahudinë për veshi e duelën n'xhezëmti. Aty pritke zotnija. Kur e pa plakun qysh e ngrihke për veshi jahudinë, zotnija u serit edhe keshi pej gzimit. Plaku e çoj para zotnije qashtu për veshi e u nalën. Jahudija i tha plakut çka t'duesh kije pej meje veq falme kryet. — Shko bjerja gruen me gjith kali qiti zotnije qi ja more sot n'sabah e po ta fali kryet — i tha plaku jahudisë. Jahudija shkoi e ja pruni kalin me gjith grue zotnisë. Zotnija u gzue shum edhe kur bani mu da me plakun i nxuer do lira me ja dhanë. U gzue edhe grueja shumë. Kah hallashtisen, plaku i tha tjetër herë mus ja nxirr bisht. — Po besa po m'bjen n'men kur je kanë vjet n'konak tem ni natë, veq bama hallall e kur t'duesh bujrun hajde si n'shpi tane derën çel e hije-i tha zotnija plakut. Kurr s'kam me ta harrue ktahën se ma zdr... ftyrën me soden — tha zotnija. — Metë janë çka janë, se malli nuk asht kurgja-i tha plaku zotnis ma s'mrami. U hallashtisën edhe u dinë. Zotnija shkoj te shpija me grue e me kali qysh o nisë për shehër.

Trergoi HALIL REVUCI,
fshati Bajcinë — Podjevë

EDUKIM NEPERMJET TE PUNES

Pjesëmarrja e fëmijës në punët e familjes duhet të fillojë sa më herët me punë të lehta, ndërsa më vonë të kalojë gradualisht në detyra më të rënda. Ngarkimi sistematik i fëmijës në detyrat e shtëpisë, sjell rezultate të dukshme. Në radhë të parë, nëpërmjet të shërbimit zhvillohet humanizmi te fëmija. Ndjenja e përgjegjësisë zhvillohet pikërisht në ato punët e vogla në familje. Në se nëna ia beson vajzës rregullimin dhe pastërinë e dhomës, ajo do ta ndjejë vehten më me përgjegjësi dhe punën do ta kryejë më e kënaqur.

Gjatë edukimit të fëmijës në familje dhe angazhimin e tij në punët e shtëpisë, duhet të keni parasysh:

— Kur vajzës ose djalit i ngarkoj më ndonjë detyrë, është më mirë në fillim t'i flitet për rëndësinë e punës, kështu që ai të angazhohet vetë, e të mos kuptojë si urdhën.

— Te fëmija ndikon këndështëm ndërrimi i punëve.

— Prindët duhet të kenë parasysh moshën e fëmijës kur ia ngarkojnë detyrën.

— Janë të shumëllojshme punët në shtëpi, të cilat mund t'i kryejnë fëmijët me sukses: t'i ndihmojë nënës ose gjyshes në kuzhinë (t'i qëroj patatet, mollat etj.), ta shtrojë tavolinin t'i fëshij pluhurat, t'i uisi lulet, të kujdeset për librat dhe për mirëmbajtjen e tyre, t'i ushqejë kafshët e shtëpisë dhe të përgjigjet për to, t'i pastrojë dhe t'i hekurosë teshat e vëezërve dhe motrave më të vogla, t'i ndihmojë të sëmurëve (t'ua ziejë çajin, t'ua sjellë barërat, etj.).

Gjatë angazhimit të fëmijës në punët e shtëpisë, te fëmija zhvillohet edhe aftësia për organizimin e punës. Nëse ndaj fëmijës tregohet besim, atëherë ai bëhet i pavarur në punë. Gjatë kryerjes së detyrave të ndryshme në shtëpi fëmija fillon që të ndjejë dashuri për punën dhe fillon të formojë njëfarë qëndrimi të drejtë ndaj punës.

Formimi i shprehisë së punës qysh në familje më vonë ndikon shumë te fëmija edhe në suksesin e tij në shkollë dhe në jetën në përgjithësi.

JU FLET MJEKU

Femija dhembjet ne stomak

Fëmijët shpesh ankohen se u dhemb barku. Është e njohur se organet e tretjes te fëmijët janë shumë të ndishëm, kështu që edhe gabimi më i vogël në ushqim manifestohet. Sa më i vogël që të jetë fëmija aq më vështirë edhe reziston ndaj grubullimit ngaj gaznove myzorë. Por edhe sëmurjet që nuk kanë lidhje me organet e tretjes mund të shkaktojnë dhembjen e stomakut. Kjo ngjet në anginën e gjelbëzuar, në sëmundjen e gripit, ndezjes së mushkërive, reumatizmit etj. Fëmija nevrik vazhdimisht ankohet për dhembje në stomak, kur është i lodhur ose i shqetësuar. Edhe frika shkakton të njejtën dhembje. Karakteristike është dhembja e zorrës së verbët, e cila paraqitet në anën e djathtë, të stomakut, poashtu kërthizës dhe ka si pasojë vjelljen dhe ethet. Ndonjëherë kjo dhemje mund të paraqitet edhe në të gjithë stomakun, kështu që prindi nuk e din se për çka bëhet fjalë. Prandaj, për çdo dhemje në stomak duhet të konsultohet mjekut, në mënyrë që të mos humbet po aq mund për përcaktimin e diagnozës.

Edhe skrajat janë shpesh shkaktarë të dhembjes së stomakut. Prej tyre fëmija është nevrik, i dobët i zbehtë. Për këtë është e nevojshme të bëhen analizat dhe në qoftë se gjenden parazitë të këtillë atëherë duhet të mjekohen të gjithë anëtarët e familjes.

Edke puçrra në stomak dhe në zorrën dymbëdhjetë të gishtore e cila paraqitet më rrallë të fëmijët mund të jetë shkaktar për dhembje të forta në stomak. Shenja e parë e kësaj sëmurje është dhembja që paraqitet përmbi kërthizë, zakonisht në stomak të zbrazët dhe natën. Porsa fëmija të hajë diçka, atëherë dhembja i lehtësohet, dalja jasht nuk është e rregullt. Dhembja mund të paraqitet edhe pas ushqimit kur stomaku është plot. Ja disa këshilla: çdo ankesë të fëmijë se i dhemb stomaku duhet ta kuptoni seriozisht, por nuk duhet të reagoni me panikë. Deri sa të arrije mjekut nuk duhet ti jepni asnjë bar prej farmacisë së shtëpisë. Ushqimi i shumëllojshëm dhe i rregullt, që i përgjigjet moshës së fëmijës është masa më e mirë për pengimin e sëmurjeve të stomakut.

FËMIJET PËR ETERIT DHE MESHKUJT

Ja disa përgjegje të fëmijëve të cilëve u është bërë pyetja: »kush është ati«?

— At është njeriu i cili çdo fjali e fillon me fjalët: »kur kam qenë në moshën tënde...«

— Im at është njeri i mre kullueshëm, ai është zotnues i familjes dhe i televizorit.

— Ati është njeriu që më merr në krah dhe më përqa fon fort kur trembem nga çka.

Psikologu suedez, doktor Jashme, ka studiuar se çfarë mendojnë vajzat në moshën 5 deri më 12 vjeçare, për meshkujt. Vajza 5 vjeçare:

— Kur të martohem më vo në për babën, çdo ditë do të hamë për drekë pire prej patatesh.

— Vajza gjashtë vjeçare:

— Kurë të bëhem nënë do të kem 7 fëmijë dhe 100 kuklla.

— Vajza 12 vjeçare:

— Nuk ka randësi se si do të duket burri imë, e randësi shme është, që të ketë kalë.

NGA MODA

DY MODELE PER SHKOLLE



Edhe kësaj radhe po japim dy modele për nxënës. Në njerën prej tyre po paraqeshim një bluzë të shkurtër e cila mund t'u shërbejë nxënësve të klasave të fillores (por mund ta mbajnë edhe me të rriturit). Bluza mund te bëhet prej pulinit të zi dhe mund ta gjeni lehtë në të gjitha shitoret tona. Është e shkurtër dhe përthekohet për para. Si stoli mund t'i shërbejnë tegelat dhe xhepat. Është pa jakë, me qëllim që t'i shërbejë nxënësit si uniformë shkolle dhe të vishet me bluze ose këmishë.

Modeli i dytë u kushtohet vajzave të shkollës së mesme, po edhe kjo shërben si grykse. Mund të kombinohet me jakë të bardhë ose jo sipas dëshirës. Mund të bëhet përpara me kopsa, ose jo simbas dëshirës. Ky fustan mund të bëhet me palë të madhe përpara që mundë son lëvizje më të lehtë të nxënëses. Mangët përfundojnë me manxheta. Edhe ky fustan mund të bëhet prej puplini te zi ose blu, sipas dëshirës.

Safije Sahiti

RADIO SHKUPI

Radio Shkupi në valë të mesme 198,8; 202,2 dhe 202,4 metra si dhe në ultra valë të shkurtëra 98,9; 94,1; 94,7 dhe 99,7 megahercë.

E MËRKURË (29. IX. 1971)

13.00 Aviza me lajmërimin
13.01 LAJMET
13.05 Nga melosi burimor shqiptar
13.20 Këshilla për bujqit
13.25 Muzikë serioze: »Muzikë pianoje«
13.40 Emisioni shkollor: Nj. natyre e shoq. »T'u njohim me emra të shkencës«
13.55 Melodia e ditës
14.00 Aktualitetet e ditës
14.10 Familja dhe edukata: familja me më shumë fëmijë
14.15 Përshëndetje dhe urime
14.29 Mbyllja e programit

E ENJTE (30. IX. 1971)

13.00 Aviza me lajmërimin
13.01 LAJME
13.05 Muzikë pop. shqipe: 15 minuta me zërin e Fatbardha Agos
13.20 Këshilla për bujqit
13.25 Muzikë zbavitëse: »Ju argëtojnë orkestra vokale-instrumentale«
13.40 Kronika ekonomike: »Zhvillimi i Panairit Ndërkombëtar të Zagrebit gjatë decenieve
13.55 Melodia e ditës
14.00 Aktualitete të ditës
14.10 Tëma aktuale
14.15 Gruaja në shtëpi dhe shoqëri (emisioni javor për gruan)
14.29 Mbyllja e programit

RADIO GOSTIVARI

E MËRKURË (29. IX. 1971)

15.00 Shpallja e programit
15.02 Melodia e javës dhe kokteli zbavitës muzikor
15.30 Ditari i radios në gjuhën shqipe
15.40 Muzikë popullore shqipe (përshëndetje dhe urime)
16.00 Ditari i radios në gjuhën maqedonishte
16.10 Muzikë popullore maqedonase (përshëndetje dhe urime)
16.40 Muzikë popullore shqipe
17.00 Aktualitete në gjuhën shqipe
17.10 Muzikë zbavitëse dhe reklamat e radios
17.25 »Pesë minuta me...«
17.30 Aktualitete në gjuhën maqedonishte
17.50 Dhjetë minuta me këngëtarët që inçizuan disqe të reja në RTB dhe »Jugoton«
18.00 Mbyllja e programit

E ENJTE (30. IX. 1971)

15.00 Shpallja e programit
15.02 Melodia e javës dhe kokteli zbavitës muzikor
15.30 Kronika e komunav etona në gjuhën shqipe
15.40 Muzikë popullore shqipe (përshëndetje dhe urime)
16.00 Kronika e komunave tona në gjuhën maqedonishte
16.10 Muzikë popullore maqedonase (përshëndetje dhe urime
16.30 Të reja dhe aktualitete dite në gjuhën turqishte
16.40 Muzikë popullore turke (përshëndetje dhe urime)
17.00 Emision për fshatin në gjuhën shqipe
17.10 Muzikë zbavitëse dhe reklamat e radios
17.25 »Pesë minuta me...«
17.30 Emision për fshatin në gjuhën maqedonishte
17.40 Muzikë zbavitëse dhe reklamat e radios
17.25 »Pesë minuta me...«
17.30 Emision për fshatin në gjuhën maqedonishte
17.40 Muzikë zbavitëse dhe reklamat e radios
17.50 Nga disqet e reja të »Jugotonit«
18.00 Mbyllja e programit

RADIO TETOVA

E MËRKURË (29. IX. 1971)

14.30 Shpallja e programit dhe melodia e javës
14.35 Këngë popullore maqedonase me duete
15.00 PEP
15.30 Kohë e rezervuar
15.45 Të reja dhe aktualitete
16.00 Përshëndetje dhe urime
17.00 Emision në gjuhën shqipe
17.45 Emision në gjuhën turqishte
18.30 Mbyllja e programit

E ENJTE (30. IX. 1971)

14.30 Shpallja e programit dhe melodia e javës
14.35 Këngë e valle popullore majedonase
15.00 PEP
15.30 Kohë e rezervuar
15.45 Tetova dje, sot, nesër
16.00 Përshëndetje dhe urime
17.00 Super-top-tetë
17.30 Buket folkloristik
18.00 Pop – globusi
18.30 Mbyllja e programit

RADIO KUMANOVA

E MËRKURË (29. IX. 1971)

15.30 Shpallja e programit dhe melodia e javës
16.00 Të reja dhe aktualitete të tjera, lajmërime dhe radio reklama
16.30 Të reja dhe aktualitete në gjuhën turqishte
16.45 Xhez muzikë
17.00 »Edukata dhe kultura«, emision nga lëmia e pedagogjisë
17.10 Të reja nga diskoteka e jonë
17.30 Këshillat e mjekut
17.35 Këngë popullore maqedonase
18.00 Nga puna e organizatave punuese
18.05 Muzikë nga vendet e ndryshme
18.30 Mbyllja e programit

E ENJTE (30. IX. 1971)

15.30 Shpallja e programit dhe melodia e javës
15.35 Sot në qytetin tonë
16.00 Të reja dhe aktualitete tjera, lajmërime dhe radio reklama
16.30 Të reja dhe aktualitete në gjuhën shqipe
16.45 Interpretojnë grupet vokalo-instrumentale
17.00 Temë për të cilën flitet
17.05 Përshëndetje dhe urime të dëgjuesve tanë
18.00 Prindërit dhe fëmijët
18.05 Këngë popullore shqipe, turke dhe jevge
18.30 Mbyllja e programit

RADIO DIBRA

E MËRKURË (29. IX. 1971)

15.30 Shpallja e programit dhe melodia e javës
15.35 Muzikë popullore maqedonase
16.00 Pasqyra informative e komunës (shqip dhe maqedonisht), lajmërime dhe radio-reklama
16.15 Përshëndetje dhe urime
16.25 Nga e kaluara e jonë e lavdishme
16.45 Radio univerziteti
17.00 Mbyllja e programit

E ENJTE (30. IX. 1971)

15.30 Shpallja e programit dhe melodia e javës
15.35 Muzikë popullore shqipe
16.00 Pasqyra informative e komunës në gjuhën shqipe dhe maqedonishte
16.15 Muzike popullore turke
16.30 Mjeku ju këshillon
16.45 Pak muzikë dhe pak teknikë
17.00 Mbyllja e programit

O STRUGA

E MËRKURË (29. IX. 1971)

17.02 Ditari i radios
17.15 Reklamat e radios
17.25 Emisioni »Femra në shoqëri dhe familje«
17.30 Muzikë popullore shqipe
18.00 Mbyllja e programit

E ENJTE (30. IX. 1971)

17.02 Ditari i radios
17.15 Përshëndetje dhe urime
17.45 Muzikë zbavitëse
18.00 Mbyllja e programit

DARVIL

TRIESTE

PIAZZA S. ANTONIO NJOVO 4, I. SPRAT

SERVISET „DARVIL“ NE JUGOSLLAVI

1. BEOGRAD, Bogdan Paviq, orëndreqës, Cetinska 12-a
2. BEOGRAD, Boris Vitonovski, orëndreqës, Vasina No. 14
3. BEOGRADI, I RI, Vladislava Radojkoviq, orëndreqës, Oml. brigada 4
4. BIHAÇ, Meho Haxhiq, orëndreqës, M. Tito 17
5. BREZHICE, Josip Boçak, orëndreqës, Vodnikova 1
6. CELJE, Viktor Leçnik, orëndreqës, Ashkerçeva 3
7. DOBOJ, Didiç — Jusiç, dyqan për orë.
8. ILIRSKA BISTRICA, Franc Novak orëndreqës, Stritarjeva 25
9. KARLLOVAC, Josip Çukina, orëndreqës dhe argjentar, Llolla Ribar 41
10. KRAPINË, Mirko Malariq, orëndreqës, Marshall Tito 18
11. KOPAR, Vencesllav Shtimec, orëndreqës, Çevljarska 32
12. KRANJ, dyqan për orë KOKRA, Kranj
13. KOPRIVNICË, Pavle Pekoviq, orëndreqës, TRG BRAT. i Jedinstva 2
14. LUBLANË, Centromerkur, Trubarjeva 1
15. LUBLANË, Ivan Medved, orëndreqës, Pokopalishka 3 — Moste
16. LUBLANË, Stanko Kajfezh, orëndreqës, Linhartova, 3
17. LUBLANË, Sllavko Shercer, orëndreqës, Trubarjeva 48
18. LUBOSHKI, Blago Çotiq, orëndreqës, B. Dideriqeva 36
19. MARIBOR, dyqan për orë HRONOMETAR, Partizanska 16
20. MARIBOR, Dyqan për orë URA Korshka 14
21. MARIBOR, dyqan për orë, MATICA, Gosposka 15
22. MARIBOR, Josip Grabner, orëndreqës Rozinova 15
23. MOSTAR, Josip Buljan, orëndreqës, A. Buça No. 7
24. MURSKA SOBOTA, URARSTVO — Murska Subota
25. POSTOJNA, — UDARNA POSTOJNA
26. PULA, Branko Maliç, orëndreqës, Narodni TRG 4
27. RAVNE, Vladimir Brumen, orëndreqës, Prevalje
28. RIEKË, Ivan Mejak, orëndreqës, Zhabica 6
29. SARAEVË, ARGJENTAR, Saraevë
30. SARAEVË, Fadil Alihoxhiq, dyqan për orë Gazi Husref — begova 25
31. SHKUP, HRONOMETAR, dyqan për orë,
32. SLAV. BROD, Alejz Bognar, orëndreqës
33. SPLIT, Mihovil Mërkushiç, orëndreqës, Dobriq 5
34. SPLIT, Anton Polajzher, Dobriq, 11
35. SPLIT, Tehniçar Gorishka 6
36. SUBOTICË, AURO-METAL, servis orësh, Car Llazar 2
37. SISAK, Anton Smeh, orëndreqës, M. Tito 7
38. SHABAC, Branislav J. Markoviq, orëndreqës, Karagjor. 17
38. SHIBENIK, Ante Kushtera, orëndreqës, 7 Omiliqa No. 5
40. TITOGRAD, Boshko Mijoviq, orëndreqës Steva Kraljeviq, 1
41. VARAZHDIN, Bozhe Plavec, dyqan për orë, Kaçiqeva 1
42. VELENJE, Viktor Ças, orëndreqës, Koroshka Cesta 4
43. ZEMUN, Zoran Hajdukoviq, Veselin Maslesha 2
44. ZARË, Shime Çutina, orëndreqës, Zhrtava fashizma 9
45. ZARË, Hofman Vllade, orëndreqës, D. Tucoviq, 4
46. ZAGREB, Kooperativa për orë SAT, Ilica 8
47. ZENICË, VI. Lupca Enver, dyqan për orë 29 Novembar 3
48. ZRENJANIN, dyqan për orë »Omikron«.

BIZHUTERIA BOTERORE

DARWIL

Flaka e vëllazërimit

Drejtori i NGB »Nova Makedonija« Ante Popovski Kryeredak-tor e redaktor përgjegjës Lutfi Rusi. Redakton — Kolegiumi i Redaksisë. Redaksia dhe administrata NGB »Nova Makedonija«Nj P »Flaka e vëllazërimit« Bulevar JNA 86 — Shkup. Fahu postal 510. Gazeta del të dielën të mërkuren dhe të premtën. Parapagim: për një vit 70.00 din. Për gjashtë muaj 35.00 din. Për tre muaj 17.50 din. Për një muaj 6.00 din. Përjashta shtetit dy fish. Numri i llogarisë rrjedhëse 401-1-14. Tel. 31-861.